



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 86/2021 regjistër (JR)
Datë 30.12.2021

Nr. 56 i vendimit
Datë 12.11.2024

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 12.11.2024, ditën e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretar Gjyqësor Kevin Kovaçica, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, nr. 86/2021, datë 30.12.2021, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit, znj. Saemira Hila, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 473, datë 05.11.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; nenet 62 dhe 63 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 473, datë 05.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Saemira Hila, ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Për shkak të funksionit, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Saemira Hila (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse, prej të cilave rezultoi si më poshtë.

2.1. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *Ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasurinë;*
- *Ka mosdeklarim të pasurisë;*
- *Ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

2.3. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i

rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, Komisioni kreu procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë duke marrë vendimin nr. 473, datë 05.11.2021.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, me vendimin nr. 473, datë 05.11.2021, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Saemira Hila, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “c” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, bazuar në konkluzionet për kriterin e vlerësimit të pasurisë, si më poshtë¹.

- *Lidhur me investimin në depozita në vitin 2005, subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me burimet e krijimit të depozitave, duke rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar krijimin e tyre në shumën prej (-) 1.392.870 lekësh, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.*

- *Lidhur me pasurinë “apartament” me sipërfaqe 112,1 m² e ndodhur në {***}, Tiranë:*
i) për pagesën e kështit të parë prej 25.000 eurosh në datën 17.12.2010, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën periodike të interesave të vitit 2010 për pagesën e kështit me burim nga depozita bankare në Bankën Raiffeisen, pasi nga hetimi rezultoi se subjekti nuk ka përdorur depozitën si burim për pagesën e kështit të parë. Gjithashtu, subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën prej (-) 4.225.563 lekësh, për të justifikuar pagesën e kështit të parë, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016;
ii) për pagesën e kështit të dytë në shumën prej 20.000 eurosh në datën 11.02.2011, subjekti, gjithashtu, ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën periodike të interesave të vitit 2011, në lidhje me burimin depozitë bankare në “Raiffeisen Bank” për blerjen e apartamentit, pasi nga hetimi rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e një viti më parë gjendje të kësaj depozite, të tërhequr në vitin 2010, që të mund të përbënte burim krijimi për pagesën e kështit të dytë në datën 11.02.2011. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën prej (-) 2.783.173 lekësh, për të justifikuar pagesën e kështit të dytë, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

- *Lidhur me pasurinë “autoveturë”, marka “Mercedes-Benz”, blerë në datën 05.07.2010, subjekti nuk ka kryer deklarimin e kësaj pasurie në deklaratën periodike të interesave të vitit 2010, në përputhje me ligjin nr. 9049/2003, si dhe ka rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën prej (-) 1.233.279 lekësh, për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie në datën 05.07.2010, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.*

¹ Paragrafi 79 i vendimit nr. 473, datë 05.11.2021, të Komisionit.

- Referuar analizës financiare për vitet 2003-2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të konstatuara për vitin 2005 në shumën (-) 1.392.870 lekë, për vitin 2011 në shumën (-) 4.000.811 lekë, për vitin 2012 në shumën (-) 351.943 lekë dhe për vitin 2014 në shumën (-) 175.865 lekë, me total pamjaftueshmërie prej (-) 5.921.489 lekësh, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit, më datë 22.12.2021, ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 473, datë 05.11.2021, të Komisionit, duke i kërkuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:
 - *Kalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore publike;*
 - *Vazhdimin e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera të procesit të rivlerësimit, që lidhen me figurën dhe aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit;*
 - *Ndryshimin e vendimit nr. 473, datë 05.11.2021, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.*
6. Ankimi i subjektit të rivlerësimit përmban shkaqe procedurale dhe shkaqe të tjera në lidhje me themelin e çështjes, të cilat në tërësinë e tyre kanë të bëjnë me interpretim të gabuar të ligjit material dhe mosvlerësimin siç duhet të provave të administruara nga Komisioni.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë (*ratione materiae*) ankimet kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Saemira Hila, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

8. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15

ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

9. Në zbatim të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe neneve 49 e 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), ankimi i subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit nr. 473, datë 05.11.2021, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues në dhomë këshillimi.

9.1. Trupi gjykues shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen me cilësinë e provave të reja të akteve bashkangjitur ankimit² dhe të akteve të reja të depozituara në Kolegj me korrespondencë, pas depozitimit të ankimit.

Analiza e pranueshmërisë për shqyrtim ose jo të këtyre provave lidhet me zbatimin e normave ligjore që rregullojnë situatën në fjalë. Kolegji e mbështeti vendimin e tij në këtë rast në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, si dhe në nenin 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016.

Në verifikim të këtyre parashikimeve ligjore në rastin konkret, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se paraqitjen e provave të reja me ankimin e ka bërë me qëllim që të vërtetojë të ardhurat e bashkëshortit të saj nga puna në emigracion në shtetin italian. Këtë dokumentacion, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se e ka kërkuar që pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ, ku Komisioni i kishte ngarkuar barrën e provës për vërtetimin e të ardhurave *neto* të bashkëshortit edhe pse subjekti i rivlerësimit kishte paraqitur aktin zyrtar të vërtetimit të këtyre të ardhurave të lëshuar nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore të shtetit italian. Nga analizimi i përmbajtjes së këtyre akteve shkresore në raport me atë që ka dashur të provojë subjekti i rivlerësimit në shkaqet e ankimit të adresuara lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues arriti në përfundimin se marrja e tyre në cilësinë e provës është e panevojshme dhe e parëndësishme për vendimmarrjen e Kolegjit, në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, pasi ato nuk përmbajnë të dhëna apo fakte të reja në funksion të përcaktimit të gjendjes faktike të ndryshme nga ajo që ka vlerësuar Komisioni. Trupi gjykues, ashtu siç do të arsyetohet edhe në vijim në këtë vendim, arriti në këtë konkluzion, pas verifikimit dhe kontrollit të vendimit të Komisionit, në të cilin është shprehur qartë se të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit si rezultat i punësimit në shtetin italian janë konsideruar

² Me ankimin, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Kolegjit, që bazuar në parashikimet e neneve 45, 49 e 52 të ligjit nr. 84/2016 të merren në cilësinë e provave të reja aktet e paraqitura prej saj, si më poshtë:

i. Vërtetim nga Agjencia e të Ardhurave, Drejtoria Rajonale Veneto, Drejtoria Provinciale Venecia, Zyra Territoriale Valdagno, me objekt: “Vërtetimi i gjendjes së të ardhurave për vitet fiskale 1998-2002, 2004, 2006, 2007”, për kontribuesin A. DH., i pajisur me vulë Apostille, i përkthyer nga gjuha italiane dhe vërtetuar përkthimi me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 21.12.2021.

ii. Vërtetim nga Agjencia e të Ardhurave, Drejtoria Rajonale Veneto, Drejtoria Provinciale Venecia, Zyra Territoriale Valdagno, me objekt: “Vërtetimi i pagesave të pashlyera që rezultojnë nga sistemi informativ i regjistrat tatimor”, i pajisur me vulë Apostille, i përkthyer dhe vërtetuar përkthimi me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 21.12.2021.

iii. Komunikime përmes postës elektronike të z. A. DH., bashkëshorti i subjektit me Agjencinë e të Ardhurave, Zyra Territoriale Piacenza, Itali.

të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në vlerë *neto* sipas të dhënave të pasqyruara në aktin zyrtar të lëshuar nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore të shtetit italian dhe i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision. Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për të konsideruar këto akte me cilësinë e provës së re, vlerësohet si i pabazuar edhe në drejtim të ndikimit që ato mund të kishin në zgjidhjen e çështjes e, për pasojë, ato nuk mund të detyrojnë trupën gjyqësore të vendosë për marrjen e tyre nëpërmjet kalimit në seancë gjyqësore publike.

9.2. Më datë 07.03.2022, regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 08.03.2022, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur “Kërkesë për lejimin dhe marrjen e provave të reja në vijim të ankimit kundër vendimit nr. 473, datë 05.11.2021, të Komisionit”³, në përfundim të parashtrimit të së cilës, ka kërkuar nga Kolegji, që pasi të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të gjitha provat e reja të paraqitura prej saj⁴, të vendosë, përveç sa është kërkuar në ankim, edhe konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit të Komisionit, për shkak të cenimit të parimeve të procesit të rregullt ligjor nga ana e Komisionit. Më datë 28.10.2024, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur përpara zhvillimit të seancës gjyqësore, në dhomë këshillimi, dokumentin “Parashtrime”, të regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 28.10.2024. Këto parashtrime, subjekti i rivlerësimit i paraqiti edhe në rrugë elektronike⁵, duke paraqitur në këtë moment, bashkëlidhur tyre edhe një dokument në formatin elektronik PDF⁶.

³ Të njëjtin material, subjekti i rivlerësimit e ka paraqitur edhe nëpërmjet postës elektronike, të regjistruar në Kolegj, me nr. {***} prot., datë 23.03.2022.

⁴ Bashkëlidhur kërkesës janë paraqitur aktet:

i. Vërtetim njësie me origjinalin nr. {***} rep., datë 23.02.2022, i dokumentit: Vërtetim nga Agjencia e të Ardhurave, Drejtoria Rajonale Veneto, Drejtoria Provinciale Venecia, Zyra Territoriale Valdagno, me objekt: “Vërtetimi i gjendjes së të ardhurave për vitet fiskale 1996-1997”, për kontribuuesin A. DH., i legalizuar me vulë Apostille, i përkthyer nga gjuha italiane dhe vërtetuar përkthimi me anë të vërtetimit përkthimi nr. {***} rep., datë 14.02.2022.

ii. Vërtetim njësie me origjinalin nr. {***} rep., datë 23.02.2022, i dokumentit: Vërtetim nga Agjencia e të Ardhurave, Drejtoria Rajonale Veneto, Drejtoria Provinciale Venecia, Zyra Territoriale Valdagno, me objekt: “Vërtetimi i gjendjes së të ardhurave për vitet fiskale 2005”, për kontribuuesin E. DH., i legalizuar me vulë Apostille, i përkthyer nga gjuha italiane dhe vërtetuar përkthimi me anë të vërtetimit përkthimi nr. {***} rep., datë 14.02.2022.

iii. Vërtetim njësie me origjinalin nr. {***} rep., datë 23.02.2022, i dokumentit: Vërtetim nga Agjencia e të Ardhurave, Drejtoria Rajonale Veneto, Drejtoria Provinciale Venecia, Zyra Territoriale Valdagno, me objekt: “Vërtetimi i gjendjes së të ardhurave për vitet fiskale 2005”, për kontribuuesin A. DH., i legalizuar me vulë Apostille, i përkthyer nga gjuha italiane dhe vërtetuar përkthimi me anë të Vërtetimit përkthimi nr. {***} rep., datë 14.02.2022.

iv. Vërtetim nga Agjencia e të Ardhurave, Drejtoria Rajonale Veneto, Drejtoria Provinciale Venecia, Zyra Territoriale Valdagno, me objekt: “Vërtetimi i gjendjes së të ardhurave për vitet e taksave 2000,2001, 2002, 2003, 2004”, për taksapaguesin E. DH., i pajisur me vulë Apostille, i përkthyer nga gjuha italiane dhe vërtetuar përkthimi me vërtetimit përkthimi nr. {***} rep., datë 02.03.2022.

v. Vërtetim nga Agjencia e të Ardhurave, Drejtoria Rajonale Veneto, Drejtoria Provinciale Venecia, Zyra Territoriale Valdagno, me objekt: “Vërtetimi i gjendjes së të ardhurave për vitet e taksave 2000,2001, 2002, 2003, 2004”, për taksapaguesin A. DH., i pajisur me vulë Apostille, i përkthyer nga gjuha italiane dhe vërtetuar përkthimi me vërtetimit përkthimi nr. {***} rep., datë 02.03.2022.

⁵ Regjistruar me nr. {***} prot., datë 07.11.2024, në Kolegj.

⁶ Bashkëlidhur parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur: “Formulari 770, për vitin tatimor 2000, Formulari SB- Moduli 1”, për z. A. DH., (një fletë), i Agjencisë së të Ardhurave, i përkthyer nga gjuha italiane, vërtetuar përkthimi me vërtetimit përkthimi nr. {***} rep., datë 02.11.2024.

9.3. Për sa u përket provave të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, pas paraqitjes së ankimit dhe me parashtrimet, trupi gjykues vlerësoi se, *së pari*, ato nuk plotësojnë kërkesën bazë të parashikuar prej nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, që parashikon se diskutimi mbi marrjen ose jo të një prove të re do të bëhet mbi provat që i bashkëlidhen ankimit, për të cilat subjekti, jo për faj të tij, nuk kishte mundur t'i paraqiste në Komision. Nga analizimi i tyre, trupi gjykues vlerësoi se ato nuk plotësonin këtë kërkesë të kësaj dispozite. Për më tepër, fakti që këto prova nuk janë paraqitur bashkë me ankimin, bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i përjashton ato nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së tyre, për sa i takon zgjidhjes së çështjes. Pavarësisht këtij argumenti formal të mospranueshmërisë së tyre për shqyrtim, trupi gjykues, nga analizimi i këtyre provave nën dritën e përcaktimeve të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, konkludoi se këto akte nuk do të arrinin të ndiknin në zgjidhjen e çështjes.

10. Pasi analizoi edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me procesin e rregullt dhe shkeljet procedurale të pretenduara, të cilat do të analizohen në vijim në këtë vendim, u gjend i pabazuar pretendimi i saj për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, duke qenë se nuk u verifikua asnjë prej situatave të parashikuara prej nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012. Për pasojë, gjykimi i çështjes u zhvillua në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumenteve të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, në përputhje me nenin 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me zbatimin e ligjit dhe parimet e procesit të rregullt ligjor

11. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *Komisioni i ka mohuar të drejtën për t'u dëgjuar drejtësisht, duke paracaktuar vendimin përfundimtar të shkarkimit të saj nga detyra, në shkelje të hapur të dispozitave kushtetuese dhe ligjore dhe të të drejtave të saj si subjekt rivlerësimi.* Sipas subjektit të rivlerësimit, disponimi i nxituar i Komisionit për të caktuar datën e seancës dëgjimore, vetëm një orë pasi ajo kishte paraqitur aktet provuese të shumta në numër, vërteton një vendimmarrje të paragjykuar, pa u çmuar e analizuar me objektivitet e ligjshmëri provat e reja të paraqitura prej saj në përmbushje të barrës së provës.

11.1. Lidhur me pretendimet e mësipërme, nga verifikimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi se më datë 01.11.2021, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, të shoqëruara me dokumente të paraqitura në cilësinë e provës. Bashkëlidhur këtyre shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe kërkesën për çeljen e hetimit gjyqësor edhe për kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të aftësive profesionale.

Në të njëjtën datë, Komisioni, me vendimin nr. 4, datë 01.11.2021, ka vendosur të pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për administrimin e provave të reja, si dhe të refuzojë kërkesën për riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit. Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, Komisioni është shprehur: *“Nëse me shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, si dhe me shpjegimet dhe*

provat të cilat mund të paraqiten gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, do të provohet e kundërta e këtyre rezultateve, trupi gjykues, pasi t'i vlerësojë ato, do të vendosë lidhur me ecurinë e procesit të rivlerësimit". Më tej, Komisioni, në të njëjtën datë, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit lidhur me vendimmarrjen e mësipërme, si dhe i ka dërguar ftesën për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore publike, e cila do të zhvillohej në datën 03.11.2021.

Sa më sipër, trupi gjykues vëren se në përmbajtjen e vendimit nr. 4, datë 01.11.2021, subjektit të rivlerësimit i është bërë e qartë se propësimet dhe provat e dërguara prej saj do të shqyrtoheshin në vijim nga Komisioni. Periudha kohore nga data 01.11.2021 deri më 03.11.2021, datë në të cilën është zhvilluar seanca dëgjimore publike, vlerësohet nga trupi gjykues si një hark kohor i mjaftueshëm për Komisionin, për t'u njohur me propësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

11.2. Trupi gjykues gjeti të pabazuar edhe pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit, se shkeljen procedurale të pretenduar si më sipërcituar nuk e ka ngritur në seancën dëgjimore publike të zhvilluar në Komision, pasi e ka pasur të pamundur, referuar mënyrës së përfundimit të seancës në fjalë, ku kryesuesja e trupit gjykues ka deklaruar caktimin e seancës së radhës, në të cilën subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar se do të debatoheshin provat e paraqitura prej saj dhe do t'i mundësohej të parashtronte shkeljet procedurale të gjetura deri në atë fazë të procesit. Nga verifikimi i procesverbalit të seancës dëgjimore publike të zhvilluar në datën 03.11.2021, trupi gjykues konstatoi se në përfundim të saj, nga kryesuesja e trupit gjykues të Komisionit, i është dhënë fjala subjektit të rivlerësimit për të shprehur qëndrimin e saj lidhur me procesin e rivlerësimit deri në atë fazë dhe në përgjigje ajo ka kërkuar administrimin e provave të paraqitura prej saj dhe çeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, duke mos paraqitur asnjë pretendim lidhur me pamundësinë e Komisionit për të çmuar e analizuar me objektivitet e ligjshmëri provat e reja të paraqitura prej saj në përmbushje të barrës së provës, për shkak të distancës së shkurtër kohore të caktimit të datës së seancës dëgjimore publike nga data e paraqitjes prej saj të propësimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ.

11.3. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues, në kontroll të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, duke mos konstatuar asnjë situatë konkrete që të mbështesë pretendimet si më lart cituar të subjektit të rivlerësimit, i vlerësoi ato të pabazuara.

- 12.** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *Komisioni i ka cenuar të drejtën për mbrojtje efektive brenda një afati të arsyeshëm, duke mos i lejuar të paraqiste akte provuese shtesë në kohën e duhur.*

Lidhur me këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se përgjatë periudhës dyvjeçare të zhvillimit të procesit administrativ ndaj saj, Komisioni i ka dërguar vetëm dy pyetësorë, duke i krijuar bindjen se shpjegimet dhe provat e paraqitura prej saj në përgjigje të tyre ishin të mjaftueshme. Provat e kërkuara nga Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ ishin të gjitha prova të reja që nuk i ishin kërkuar më parë. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se Komisioni i vendosi afate tejet të shkurtra, aspak të arsyeshme, të pamjaftueshme dhe joligjore për

të siguruar aktet në përmbysje të barrës së provës, të cilat duhet të ishin të apostiluara, të përkthyer e të noterizuara.

12.1. Në funksion të zgjidhjes dhe dhënies përgjigje të këtyre pretendimeve, referuar veprimtarisë procedurale të zhvilluar nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi se subjektit të rivlerësimit i janë drejtuar dy pyetësorë, në të cilët i janë drejtuar pyetje/kërkesa lidhur me mënyrat e likuidimit të kësteve të paguara për blerjen e pasurisë “apartament me sipërfaqe 112,1 m²”, në {***}, Tiranë dhe me burimet e financimit të këtyre pagesave, pyetje lidhur me burimet e krijimit të depozitave në “Raiffeisen Bank”, etj. Me vendimin nr. 2, datë 05.10.2021, Komisioni ka vendosur të përfundojë hetimin paraprak dhe ka njoftuar subjektin e rivlerësimit, ndër të tjera, edhe për paraqitjen e prapësimeve dhe provave në lidhje me rezultatet e hetimit, brenda një afati prej 15 ditësh. Me vendimin nr. 3, datë 20.10.2021, Komisioni ka vendosur të pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit, duke e shtyrë afatin e paraqitjes së shpjegimeve prej saj nga data 20.10.2021 në datën 01.11.2021, veprim i cili ka gjetur pasqyrim edhe në vendimin objekt gjykimi⁷. Në datën 01.11.2021, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, si dhe provat bashkëlidhur tyre, duke mosparaqitur asnjë pretendim për mospasje mundësi të mbledhjes së ndonjë prove të caktuar. Në seancën dëgjimore publike të datës 03.11.2021 të zhvilluar në Komision, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë paraqitur ndonjë pretendim për të kërkuar kohë shtesë në funksion të gjetjes së ndonjë prove, përkundrazi i ka kërkuar Komisionit të pranojë provat e reja të paraqitura prej saj në formën e kërkuar nga ligji, duke demonstruar se nuk i është krijuar asnjë pengesë për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga procesi i rivlerësimit. Marrja pjesë në mënyrë aktive e subjektit të rivlerësimit përgjatë procedurës hetimore dhe në seancën dëgjimore publike, gjatë së cilës ajo ka qenë e lirë të shpjegojë e të parashtrojë prapësimet e saj, të ngrejë pretendime e të mbrohet publikisht ndaj gjetjeve të Komisionit, si dhe të paraqesë prova të cilat Komisioni i ka pranuar, demonstroi se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar në mënyrë të plotë të drejtën e saj për t’u dëgjuar e për t’u mbrojtur, duke iu respektuar garancitë procedurale në zbatim të nenit 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

12.2. Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të mosgarantimit të së drejtës për t’u mbrojtur dhe dëgjuar në mënyrë efektive, nuk gjendet i bazuar në fakte.

13. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *Komisioni ka shkelur parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, duke parashtuar se nxitimi për të caktuar seancën për shpalljen e vendimit, ndërkohë që sapo kishte paraqitur një akt të ri ekspertimi financiar, i cili kishte arritur në konkluzione tërësisht të ndryshme nga analiza financiare e Komisionit në rezultatet e hetimit administrativ, vërteton një sjellje të njëanshme dhe vendim të paragjykuar. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni duhet të kishte rivlerësuar situatën financiare me anë të ekspertëve të tij dhe ta njëhte me këtë provë të re me qëllim që ajo të paraqiste kundërshtimet e saj. Për të kryer

⁷ Faqja 4 e vendimit të Komisionit.

këtë veprim procedural, Komisioni duhet të kishte riçelur hetimin, të dispononte me marrjen e provave të reja e më pas të dispononte me vendim për kryerjen e një bilanci të ri financiar. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se referuar mënyrës së sjelljes dhe disponimit, Komisioni nuk ka qenë dakord me mendimin e ekspertit të marrë privatisht prej subjektit të rivlerësimit dhe si rrjedhojë nuk ka riçelur hetimin administrativ për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Komisioni, në vendimin nr. 4, datë 01.11.2021, nuk ka arsyetuar me hollësi se për cilat arsye nuk ishte dakord me mendimin e ekspertit privat të marrë prej subjektit të rivlerësimit. Në vendimin përfundimtar, Komisioni ka marrë dhe përdorur disa prova të reja të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, të marra në një kohë që hetimi administrativ ishte mbyllur dhe nuk u riçel. Sipas subjektit të rivlerësimit, vetëm nëse do të ishte riçelur hetimi, Komisioni do të dukej se kishte marrë një vendim të paanshëm e objektiv, në respektim të të drejtave të saj.

13.1. Në analizë të pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i procesverbalit të seancës dëgjimore publike të datës 03.11.2021, të zhvilluar në Komision, trupi gjykues vëren se, pasi subjekti i rivlerësimit ka referuar se kërkon të administrohen provat e reja të paraqitura prej saj, kryesuesja e trupit gjykues të Komisionit i ka shpjeguar se këto prova do të administrohen nga sekretaria gjyqësore. Në seancën dëgjimore publike të datës 05.11.2021, kryesuesja e trupit gjykues të Komisionit është shprehur se: *“Lidhur me themelin e çështjes ky trup gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti në vijim të rezultateve të hetimit, gjatë seancës dëgjimore dhe pas saj, çmoi se subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën mbi të gjitha rezultatet e hetimit lidhur me kriterin e pasurisë [...]”*.

13.2. Sa më sipër, në kushtet kur Komisioni ishte duke kontrolluar dhe vlerësuar subjektin e rivlerësimit vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe seanca dëgjimore publike po zhvillohej në funksion të këtij procesi, trupi gjykues vlerëson se nuk ishte e nevojshme riçelja e hetimit administrativ për administrimin e provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë kësaj seance dëgjimore. Edhe në vendimin përfundimtar, Komisioni ka referuar në paragrafin 22.4, se: *“Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: [...] (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit”*.

13.3. Nga verifikimi i akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës në seancën dëgjimore publike të datës 03.11.2021 e të administruara nga Komisioni, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një analizë financiare në formë tabelare e përbërë vetëm nga një fletë dhe në të nuk asnjë referencë që të identifikojë përgatitjen e saj nga një ekspert kontabël i zgjedhur nga subjekti i rivlerësimit. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se me vendimin nr. 4, datë 01.11.2021, i referuar në argumentimin e shkakut të ankimit, në ndryshim nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për administrimin e provave të paraqitura së bashku me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit dhe nuk është shprehur mbi vlerën provuese të tyre, pasi ky vlerësim kryhet nga Komisioni vetëm në

vendimin përfundimtar. Me këtë vendim, Komisioni ka refuzuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për riçeljen e hetimit administrativ për dy kriteret e tjera të rivlerësimit.

13.4. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit është njohur me rezultatet e hetimit, si dhe me analizën financiare të hartuar nga Komisioni me këtë rast. Subjekti i rivlerësimit ka pasur dijeni se kjo analizë financiare nuk është përfundimtare, pasi në rezultatet e hetimit i është kaluar barra e provës lidhur me rezultatet financiare të nxjerra në të. Kjo analizë është debatuar edhe në seancën dëgjimore publike të zhvilluar në Komision, gjatë së cilës subjekti i rivlerësimit ka parashtruar pretendimet e saj dhe i është përgjigjur dhe pyetjeve të komisionerëve dhe atyre të vëzhguesit ndërkombëtar. Analiza financiare e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në seancën dëgjimore publike i është nënshtruar vlerësimit përfundimtar të Komisionit, i cili në vendim⁸ është shprehur: *“Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, vlerëson se pretendimet e subjektit në lidhje me analizën financiare janë shqyrtuar dhe trajtuar në këtë vendim, në kuptim të barrës së provës së lënë për të provuar mundësitë financiare të subjektit dhe personit të lidhur me të për krijimin e pasurive objekt vlerësimi, për të cilat subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën”*.

13.5. Trupi gjykues vlerësoi se analiza financiare, pjesë e vendimit të Komisionit, është rezultat i të gjithë procesit të rivlerësimit për kriterin e pasurisë, që përfshin analizën e kryer në kuadër të rezultateve të hetimit administrativ, provat dhe shpjegimet e subjektit të dhëna gjatë barrës së provës, si dhe gjatë seancës dëgjimore në Komision. Nga ana tjetër, nëse për çdo analizë që kryen Komisioni do të ndërvepronte me subjektet, procesi i rivlerësimit do të ishte i pamundur të konkludohej, përpos që do të ishte i tejzgjatur. Për sa kohë vendimi i Komisionit i nënshtrohet kontrollit nga ana e Kolegjit, kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit, mbi analizën financiare të Komisionit të pasqyruar në vendim, marrin zgjidhje dhe përgjigje përfundimtare për ato çështje për të cilat janë ngritur pretendime në ankimin e paraqitur në Kolegj, të cilat janë objekt analize i këtij vendimi në vijim. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, që lidhen me analizën financiare të përcjellë në vendimin e Komisionit apo me mosnjohjen me të, nuk qëndrojnë.

13.6. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit në ankim, për cenim të parimit të kontradiktorialitetit dhe barazisë së armëve, nuk gjeti mbështetje në situatën faktike, për pasojë është i pabazuar. Po ashtu, Komisioni ia ka garantuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për proces të rregullt ligjor, në mbështetje të nenit 46 të Kushtetutës, duke ia nënshtruar provat debatit në seancën dëgjimore publike.

14. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *Komisioni gjatë hetimit administrativ ka shkelur parimin e objektivitetit, pasi në rezultatet e hetimit:*

a) nuk kishte llogaritur si burime të ligjshme pasurimi, të ardhurat e siguruara prej saj nga paga si juriste pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (në vijim “ZVRPP”) Lushnjë;

⁸ Paragrafi 78 i vendimit të Komisionit.

b) nuk kishte llogaritur si burime të ligjshme fitimi e kursimi, as të ardhurat e siguruara nga personi i lidhur, në vitin 2003, gjatë ushtrimit të aktivitetit privat si mjek stomatolog.

Subjekti i rivlerësimit ka vijuar të parashtrojë shkaku e ankimit duke pretenduar se në vendimin përfundimtar, Komisioni i ka llogaritur të si të ardhura të ligjshme sa më sipër dhe kjo ka ndodhur vetëm pas paraqitjes së kundërshtimeve të saj në seancën dëgjimore, duke e detyruar të kryente privatisht një akt ekspertimi të ri. Por pavarësisht rillogaritjeve, Komisioni për të justifikuar vendimin e paracaktuar të shkarkimit ka shtuar fiktivisht shpenzimet jetike familjare duke krijuar gjetje të reja, siç është ngarkimi i subjektit të rivlerësimit me shpenzimet e jetesës së babait të ndjerë, mohimi i depozitës bankare të krijuar me mund e djesë, si dhe mohimi i kursimeve të bashkëshortit të saj. Të gjitha këto gjetje janë bërë vetëm në vendimin përfundimtar e jo në rezultatet e hetimit administrativ, pa e njohur më parë subjektin e rivlerësimit, duke i mohuar kështu mbrojtjen efektive ndaj tyre.

14.1. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të cilat i referohen problematikave lidhur me gjetjet e rezultateve të hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prapësimet e saj në shpjegimet e dhëna lidhur me këto rezultate, të cilat janë marrë në konsideratë nga Komisioni, duke vlerësuar se ato kanë përmbushur barrën e provës. Trupi gjykues çmon të theksojë se Kolegji shqyrton çështjet e juridiksionit të rivlerësimit që i adresohen nëpërmjet ankimit të vendimit të Komisionit, duke analizuar shkaqet e ankimit, sipas qëndrimit të mbajtur në jurisprudencën e tij dhe në vlerësim të fakteve, rrethanave konkrete dhe specifike të secilës çështje. Në mënyrë të detajuar analizimi i këtij shkak do të trajtohet më poshtë në këtë vendim së bashku me shkaqet e ankimit që lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë.

14.2. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se shpenzimet jetike të babait të saj të ndjerë janë shtuar në analizën financiare vetëm në vendimin e Komisionit, nga verifikimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka pohuar, për herë të parë, në shpjegimet e saj mbi rezultatet e hetimit administrativ se babai i saj ka jetuar me të dhe përballimi i shpenzimeve të jetesës së tij ka qenë në ngarkim të saj. Në këto kushte, është e logjikshme që Komisioni në analizën përfundimtare të pasqyruar në vendim do të përfshinte këtë fakt të pranuar nga vetë subjekti i rivlerësimit.

14.3. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në ligj e në prova.

- 15.** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka pasqyruar rrethana dhe fakte të pavërteta, si dhe i ka kaluar barrë prove fiktive, duke e rënduar padrejtësisht me qëllim të dhënies së një vendimi të paracaktuar në disfavor të saj.*

Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se Komisioni ka pasqyruar në rezultatet e hetimit administrativ rrethana të pavërteta lidhur me deklaratimet e saj para ILDKPKI-së në datën 29.04.2015, lidhur me deklaratimet e saj për kohën e dhënies së huas nga bashkëshorti vëllezërve të tij, si dhe lidhur me shumën e një huaje dhënë nga bashkëshorti njërit prej vëllezërve të tij. Sipas subjektit të rivlerësimit, ndonëse në vendimin përfundimtar nuk janë riparashtruar këto rrethana të

pavërteta, ato kanë ndikuar konsiderueshëm te formimi i bindjes së brendshme të Komisionit në mungesë të plotë të besimit në deklaratimet e saj, duke mohuar shumën prej 25.000 eurosh që bashkëshorti kishte kursyer nga puna në emigrim, por edhe të depozitës së tyre bankare në “Raiffeisen Bank”. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar, gjithashtu, se në rezultatet e hetimit i është kërkuar të paraqesë kontratën e blerjes së një apartamenti në Itali, nga kunati, z. E. DH., të cilit ajo dhe bashkëshorti i kishin dhënë një hua në shumën 10.000 euro dhe vetëm një ditë para seancës së fundit dëgjimore, Komisioni e ka njoftuar se kjo provë është e panevojshme. Ndërkohë marrja e kësaj prove nga subjekti i rivlerësimit është shoqëruar me shpenzime financiare, humbje kohe e konfuzion në mbledhjen e provave, duke rezultuar kështu një gjetje e sforcuar e Komisionit për të rënduar situatën në funksion të një vendimmarrjeje të paracaktuar. Të njëjtën situatë, subjekti i rivlerësimit e ka evidentuar edhe për sa i përket aktit zyrtar të lëshuar nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore i shtetit italian lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të saj, duke pretenduar se Komisioni i ka kaluar fiktivisht barrën e provës, pasi në rezultatet e hetimit i ka kërkuar akte shtesë për të provuar se mbi të ardhurat e pasqyruara në këtë dokumentacion janë paguar detyrimet tatimore, ndërsa në vendim Komisioni ka pranuar se të ardhurat e bashkëshortit të pasqyruara në aktin e sipërcituar janë të ardhurat *neto* të përfituara prej tij.

15.1. Në analizë të këtij shkakut ankimi, nga verifikimi i rezultateve të hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi se Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, si vijon: “a) Në lidhje me të ardhurat e krijuara nga viti 1996-2002 dhe në vitin 2004 si i punësuar në Itali, Komisioni është bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti gjatë hetimit administrativ në gjuhën italiane, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe apostiluar, emërtuar ekstrakt i llogarisë së sigurimeve shoqërore, lëshuar nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore, në datën 21.02.2020, nga ku duket se personi i lidhur A. D., ka qenë i punësuar në shtetin italian dhe për periudhën 1998-2002 dhe në vitin 2004 duket se ka pasur të ardhura totale *bruto* 73.753 euro, por nuk provohet nëse mbi këto të ardhura janë paguar detyrimet tatimore në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Bazuar në sa më lart, paraqisni dokumentacionin ligjor në lidhje me të ardhurat *neto* të përfituara nga bashkëshorti juaj për vitet e punësimit në Itali”.

Në shpjegimet e dhëna në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se shuma prej 73.753 eurosh është *neto*, pasi janë zbritur edhe pagesat e kontributeve shoqërore, sepse dokumenti i lëshuar nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore është një dokument zyrtar i shtetit italian, që tregon pagesat e kontributeve të derdhura në këtë vend, i njëjtë me dokumentin e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore në vendin tonë.

Komisioni, pas dëgjimit edhe të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, lidhur me atë që përfaqëson akti i lëshuar nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore për vërtetimin e të ardhurave të përfituara nga bashkëshorti i saj në shtetin italian, në vendim, ka arsyetuar⁹ se: “Komisioni ka analizuar burimet e krijimit të kësaj depozite, duke konsideruar dokumentacionin e paraqitur nga subjekti në formën e kërkuar sipas ligjit, të përkthyer dhe apostiluar, emërtuar “{***}”, datë 21.02.2020, për të provuar punësimin e bashkëshortit të saj në Itali, për periudhën nga data 08.03.1996 - 01.01.2007, si dhe

⁹ Paragrafi 32.1 i vendimit të Komisionit.

dokumentacionin e siguruar nga hetimi administrativ në lidhje me të ardhurat e përfituara nga punësimi i tij si stomatolog në Shqipëri për periudhën 2003-2004”.

Në vlerësimin e trupit gjykues, kronologjia e fakteve të mësipërme tregon një mënyrë të logjikshme veprimi nga Komisioni dhe plotësisht në përputhje me parashikimet ligjore procedurale të zhvillimit të hetimit administrativ. Subjekti i rivlerësimit ka arritur të bindë Komisionin se dokumenti i paraqitur prej saj provon shumë *neto* të të ardhurave të përfituara nga personi i lidhur, duke përmbushur qëllimin e kalimit të barrës së provës për të provuar të kundërtën e asaj që Komisioni e ka cilësuar si gjetje të hetimit administrativ. Gjetjet e rezultateve të hetimit administrativ janë gjetje paraprake, të cilat në varësi të shpjegimeve apo dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit marrin formën përfundimtare, në arsyetimin dhe vlerësimin konkludues në vendimin e Komisionit.

15.2. Për sa i përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me huan në shumën 10.000 euro dhënë kunatit, z. E. DH., në vitin 2015, nga verifikimi i rezultateve të hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se Komisioni ka evidentuar si vijon: *“Gjatë deklaratimit në ILDKPKI, subjekti ka paraqitur disa akte për të provuar në lidhje me huan e dhënë, si më poshtë: deklaratë e thjeshtë të lëshuar nga z. E. DH., në datën 24.12.2016, në të cilën ka deklaruar se ka marrë hua nga subjekti dhe personi i lidhur shumë prej 10.000 eurosh, të cilën e ka përdorur për blerjen e një apartamenti në datën 06.11.2015, në {***}, në Itali; kontratë shitblerje (në gjuhën italiane), datë 06.11.2015, për një pasuri të paluajtshme me palë blerëse shtetasin E. DH. në çmimin prej 68.000 eurosh; kontratë për kredi bankare (në gjuhën italiane), datë 06.11.2015, me palë kredimarrëse E. DH., në shumën 54.400 euro për një afat 20-vjeçar; si dhe dokumentacion teknik i pasurisë së paluajtshme (në gjuhën italiane)”*. Më tej, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për: *“Mbetet e paqartë mënyra dhe koha e dhënies së huas prej 10.000 eurosh kunatit të subjektit; nga analiza financiare e gjendjes cash, duket se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të krijuar me burime të ligjshme kursimet cash, duke rezultuar me pamundësi financiare në shumën (-) 3.864.191 lekë në vitin 2011 dhe në shumën (-) 175.865 lekë në vitin 2014”*. Në përfundim, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë dokumentacionin për blerjen e shtëpisë nga z. E. DH., në Itali, në formën e kërkuar ligjore. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka parashtuar se: *“Ndodhur në këto kushte, ju njoftoj se me gjithë përpjekjet, kunati ka mundur të sigurojë vetëm një kopje të njehsuar me origjinalin të kontratës së kërkuar prej jush, por jo të pajisura me vulën apostille. Ai, gjithashtu, më ka njoftuar se është në procedurë për marrjen e vulës apostille”*. Në seancën dëgjimore publike të datës 03.11.2021, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të thirret në cilësinë e dëshmitarit, ndër të tjerët, edhe z. E. DH. Me vendimin nr. 5, datë 04.11.2021, Komisioni ka vendosur të refuzojë kërkesën për thirrjen e dëshmitarëve, duke e cilësuar të panevojshme, për sa vullneti për huan e marrë është shprehur në formë shkresore nga z. E. DH., dhe se fakti i blerjes së shtëpisë, edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk do të ndikonte në marrjen e vendimit ndaj subjektit të rivlerësimit.

15.3. Situata faktike e pasqyruar më sipër, në vlerësim të trupit gjykues, dëshmon qartë se subjektit të rivlerësimit nuk i është kërkuar paraqitja e një dokumentacioni të ri, por paraqitja në formën e kërkuar nga ligji të dokumentacionit të çmuar e dorëzuar prej vetë asaj si dokumentacion

justifikues e provues i deklarimeve të pasqyruara në deklaratën e rivlerësimit, që në janar të viti 2017. Në këto kushte, kërkesa e Komisionit nuk mund të konsiderohet një gjetje e sforcuar, për të rënduar situatën e subjektit të rivlerësimit, pasi detyrimi që dokumentacioni të ishte i paraqitur në formën e duhur ligjore, bazuar në kuadrin ligjor që normon procesin e rivlerësimit, i kishte lindur subjektit të rivlerësimit që në momentin që ajo vetë ka vlerësuar të paraqesë këtë dokumentacion bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit. Trupi gjykues e gjeti të drejtë konstatimin i Komisionit në paragrafin 69 të vendimit, se *subjekti ka pasur detyrimin të depozitojë dokumentacionin e kërkuar sipas ligjit me depozitimin e deklaratës Vetting, bazuar në pikën 6 të udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive”*. Trupi gjykues vlerëson se, edhe nëse do të *provohej nga subjekti fakti i blerjes së shtëpisë nga shtetasi E. DH., përsëri ky fakt nuk do të ndikonte në vendimarrjen ndaj subjektit të rivlerësimit*.

15.4. Në konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka pasqyruar rrethana dhe fakte të pavërteta, si dhe i ka kaluar barrë prove fiktive, gjendet i pabazuar në prova dhe në ligj.

16. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka pretenduar se *Komisioni, jo vetëm nuk i ka studiuar me objektivitet e ligjshmëri aktet provuese të depozituara prej saj, por duket se as nuk i ka shfletuar ato*.

Në argumentimin e këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se me anë të postës elektronike, me e-mail të datës 09.11.2021 i ka kërkuar Komisionit që t’i vinte në dispozicion një kopje të akteve të dorëzuara prej saj në seancën dëgjimore publike të datës 03.11.2021, të cilat në total ishin 190 fletë. Sipas subjektit të rivlerësimit, me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 12.11.2021, Komisioni e ka njoftuar se pranonte t’i vinte në dispozicion kopje të akteve të kërkuara, të cilat ishin përdorur prej tij në vendimarrje dhe ato përbënin vetëm 25 fletë në total. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se kjo përgjigje, e cila i referohet numrit rendor të provave të paraqitura prej saj në seancën dëgjimore dhe jo numrit faktik të fletëve të dorëzuara prej saj, vërteton njëanshmërinë dhe vendimarrjen e paracaktuar të Komisionit, pa analizuar me objektivitet dhe paanshmëri provat.

16.1. Në analizë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstatoi se bashkëlidhur ankimit, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacionin e pretenduar e konkretisht kërkesën e paraqitur prej saj dhe përgjigjen e dhënë nga Komisioni, ashtu si ajo i ka cituar në ankim, duke qenë se pretendohet për ngjarje të ndodhura pasi procesi i rivlerësimit kishte përfunduar. Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes së subjektit të rivlerësimit të përcjellë nga Komisioni në Kolegj, trupi gjykues konstatoi se në të është administruar dokumenti “Lista e provave”, me numër rendor aktesh 25, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, e cila mban shënimin me shkrim kompjuterik, *Lushnjë më 01.11.2021* dhe shënuar me shkrim dore mban datën 03.11.2021, si dhe shënimin me shkrim dore “*Prova të dorëzuara në seancë, total 190 fletë*”. Dokumenti mban edhe nënshkrimin e sekretares gjyqësore të Komisionit. Bashkëlidhur tij gjenden aktet, gjithsej 190 fletë.

Në vendim, në paragrafin e titulluar “Seanca dëgjimore”, Komisioni ka referuar se: *Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe mori të gjithë kohën e duhur për të parashtruar shpjegimet*

në lidhje me procesin e rivlerësimit dhe rezultatet e hetimit administrativ, për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë. Në përfundim të shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit depozitoi prova shkresore, si dhe kërkesë për thirrjen në cilësinë e dëshmitarëve të disa shtetasve, në vijim të së cilës, pas shqyrtimit, trupi gjykues, me vendimin e datës 04.11.20218, vendosi refuzimin e kërkesës, bazuar në nenin 49, pikat 8, 9 dhe 6, shkronjat “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016.

16.2. Në konkluzion të situatës faktike të pasqyruar në sipër, trupi gjykues vlerësoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pambështetura në prova.

17. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *vendimi i Komisionit është rezultat i një procesi të paragjykuar dhe vendimmarrje të paracaktuar, në shkelje të ligjit material, pasi ka përfunduar hetimin administrativ bazuar vetëm në një kriter, duke mos hetuar për kriterin e figurës dhe atë profesional. Mosplotësimi i njërit kusht kur në ligj ato janë kumulative, bën që konkluzioni i Komisionit, duke u bazuar në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, të jetë haptazi i pambështetur në ligj, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën për një proces të rregullt ligjor.*

17.1. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se me vendimin nr. 1, datë 12.11.2019, Komisioni ka vendosur të fillojë hetimin administrativ për tri kriteret e rivlerësimit, ndërsa me vendimin nr. 2, datë 05.10.2021, ka vendosur të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, znj. Saemira Hila, vetëm për kriterin e pasurisë, bazuar në rezultatet e hetimit administrativ, pasi provat për këtë kriter kishin arritur nivelin e provueshmërisë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, Komisioni ka vlerësuar se subjektit të rivlerësimit mund t’i kalonte barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ. Një situatë e tillë procedurale çmohet nga trupi gjykues se nuk bie ndesh me parashikimet kushtetuese dhe ligjore në fuqi dhe nuk demonstroi as paragjykim të trupës gjykuese të Komisionit apo paracaktim të vendimit, në mbështetje edhe të jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit në raste të ngjashme. Trupi gjykues sjell në vëmendje se neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”*. Pra, vendimi në procesin e rivlerësimit për subjektet e rivlerësimit mund të merret bazuar në një ose disa prej kriterëve të rivlerësimit, që do të thotë se nëse në një moment të caktuar të zhvillimit të procedurës hetimore administrative nga ana e Komisionit, ky i fundit arrin në përfundimin se ekzistojnë shkaqe për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, bazuar në rezultatet e arritura nga procedura për vlerësimin edhe vetëm të një kriteri, ligji e lejon Komisionin të mbyllë procedurën e rivlerësimit për atë kriter, mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, dhe të marrë një vendim për shkarkimin e tij, pa qenë e nevojshme që procedura administrative të vazhdojë më tej me verifikimin e kriterëve të tjera. Kur Komisioni çmon se provat kanë një nivel të tillë provueshmërie, sipas parashikimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, lexuar në harmoni me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe interpretimi logjik i nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që bëjnë të besohet se subjekti i rivlerësimit gjendet para prezumimit ligjor të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga

detyra, atëherë është e mundur vendimmarrja për vetëm një ose dy kritere vlerësimi. Në nenin 59 të ligjit nr. 84/2016 është mirëpërcaktuar se me qëllim konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit kërkohet që ai të plotësojë kushtet e kërkuara për tri kriteret, duke arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; si dhe një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Në funksion të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, del i qartë interpretimi që institucionet e rivlerësimit mund ta marrin vendimin mbi bazën e një kriteri vlerësimi ose të disa kriterëve, si dhe në vlerësimin e tri kriterëve apo në vlerësimin e përgjithshëm të tyre ose në vlerësimin tërësor të procedurave të një ose disa kriterëve të rivlerësimit, qëndrim ky i mbajtur në jurisprudencën e Kolegjit. Komisioni dhe Kolegji kanë të drejtë për të konkluduar me vendim, qoftë edhe vetëm për njërin nga kriteret dhe, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, konkretisht për kriterin e pasurisë, Kushtetuta parashikon shkarkimin nga detyra për ato raste të deklarimit të pasurisë të parashikuara në këtë dispozitë, siç është përpjekja për të fshehur apo paraqitja në mënyrë të pasaktë e pasurive. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se shkaku i ankimit i subjektit të rivlerësimit se procesi i tij i rivlerësimit është kryer në interpretim të gabuar të ligjit, pasi është konkluduar vetëm për një kriter, nuk gjendet i bazuar.

17.2. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, kërkon plotësimin në mënyrë kumulative dhe jo alternative të dy kriterëve: pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë e, për pasojë, vendimi i Komisionit për shkarkimin e saj nga detyra i mbështetur në këtë bazë ligjore dhe në konkluzionet e arritura vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, bën që të jetë haptazi i pambështetur në ligj, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën për një proces të rregullt ligjor, trupi gjykues sjell në vëmendje jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Sipas qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit, vlerësimi për secilin kriter rivlerësimi (atë të pasurisë dhe kontrollit të figurës) është i pavarur dhe mund të çojë në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nëse deklarimi i subjektit të rivlerësimit për kriterin objekt shqyrtimi vlerësohet i pamjaftueshëm. Kolegji ka vlerësuar se nuk është e nevojshme që pamjaftueshmëritë në deklarin për kontrollin e pasurisë dhe të figurës të ekzistojnë në mënyrë kumulative për të konkluduar me vendimmarrjen për shkarkim nga detyra.

17.3. Në konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se vendimi i Komisionit është i pambështetur në ligj, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën për një proces të rregullt ligjor, është një pretendim i pabazuar në ligj.

18. Subjekti i rivlerësimit, përgjatë gjithë ankimit, ka pretenduar *për interpretim ndryshe të ligjit, vlerësim të ndryshëm të fakteve në vendimin objekt shqyrtimi, në raport me atë të mbajtur nga Komisioni ndaj subjekteve të tjerë të rivlerësimit*. Në analizë të këtij shkaku ankimi, në mbështetje të jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, trupi gjykues vlerësoi se mbajtja e standardeve të ndryshme nga Komisioni në situata të ngjashme, nuk mund të përbëjë *a priori* shkak procedural për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e Komisionit

vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, sipas shkaqeve konkrete të ankimit, të cilat lidhen me vlerësimin e kritereve të rivlerësimit, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe zbatimit të duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni.

C. Vlerësimi i trupit gjykues mbi shkaqet e ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

- ***Në lidhje me pasurinë e paluajtshme “apartament banimi me sipërfaqe 112,1 m²”, ndodhur në {***}, Tiranë (në vijim “pasuria apartament me sipërfaqe 112,1 m²”)***

19. Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

19.1. Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, në cilësinë e palës blerëse dhe shoqëria “{***}” ShPK, në cilësinë e palës shitëse, kanë lidhur kontratën paraprake të shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2010, me objekt shitjen e një apartamenti me sipërfaqe ndërtimi 112,1 m², për çmimin 82.500 euro. Çmimi i përcaktuar në këtë kontratë do të shlyhej me këste, si vijon: kësti i parë në vlerën prej 25.000 eurosh është likuiduar nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale në të cilën është lidhur kontrata në fjalë, ndërsa kësti i dytë në vlerën prej 57.500 eurosh do të paguhej me anë të një kredie bankare që pala blerëse do të merrte në “Raiffeisen Bank”.

19.2. Në datën 15.02.2011, midis palëve të sipërcituara është lidhur kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.02.2011, në të cilën është përcaktuar se çmimi për shitblerjen e apartamentit objekt kontrate është likuiduar nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale.

Në vijim, në të njëjtën datë, midis palëve është lidhur dhe kontrata e huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.02.2011, në të cilën është përcaktuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, si palë huamarrëse kanë detyrimin për t’i paguar palës huadhënëse shoqërisë “{***}” ShPK, shumën prej 37.500 eurosh, si vlerë e mbetur ende e papaguar për shitblerjen e pasurisë “apartament me sipërfaqe 112,1 m²”. Në këtë kontratë është cilësuar se shuma prej 37.500 eurosh do të paguhej nga pala blerëse/huamarrëse nëpërmjet një kredie bankare, e cila, pas lëvrimit të saj nga banka, do të kalonte menjëherë në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK.

19.3. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar si burime financiare për krijimin e pasurisë “apartament me sipërfaqe 112,1 m²”, si vijon: (i) kredi bankare dhe hipotekë e datës 18.02.2011, në “Raiffeisen Bank”, shuma 5.000.000 lekë; (ii) të ardhurat e fituara nga shitja e apartamentit të trashëguar nga prindërit, privatizuar me ligjin nr. 7652/1991; (iii) të ardhurat e kursyera nga puna e secilit bashkëshort në vitet paraardhëse.

20. Komisioni, në kuadër të kontrollit të pasurisë “apartament me sipërfaqe 112,1 m²”, ka verifikuar burimet financiare të deklaruara nga subjekti në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, për pagesën e secilit prej kësteve të blerjes së kësaj pasurie dhe ka arritur në konkluzionet përkatëse, të cilat

janë kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit në ankim, duke pretenduar se vendimi i Komisionit për këtë pasuri është i padrejtë për shkaqet e analizuara nga trupi gjykues si më poshtë.

◦ Në lidhje me depozitën bankare në vlerën 67.000 dollarë në “Raiffeisen Bank”, llogari bankare e krijuar nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj në vitin 2004 dhe shtuar ndër vite, deri në datën e tërheqjes në dhjetor 2010 (në vijim “depozita në Raiffeisen Bank”)

21. Depozita bankare e sipërcituar i është nënshtruar kontrollit nga ana e Komisionit, pasi referuar deklarimeve të subjektit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe në deklaratimet periodike të interesave private në vite, kjo pasuri është financuar kryesisht nga të ardhurat e kursyera nga puna e saj dhe e bashkëshortit, që nga çelja e depozitës në vitin 2004 e deri në mbylljen e saj në vitin 2010, vit në të cilin subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo depozitë është tërhequr për t’u përdorur e gjitha për blerjen e pasurisë “apartament me sipërfaqe 112,1 m²”.

Nga informacioni i përcjellë në Komision nga “Raiffeisen Bank”¹⁰, trupi gjykues konstatoi se llogaria e depozitës në këtë bankë është çelur nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në datën 01.10.2004 në shumën 200.000 lekë dhe është shtuar në vijim në vitet 2004, 2005 dhe 2006, e bashkë me interesat bankare të akumuluar deri në datën 31.12.2009, balanca ka qenë në shumën 7.947.972 lekë. Në datën 08.03.2010, kjo shumë është konvertuar në monedhën dollarë amerikanë, në vlerën 73.482 dollarë, e cila rezulton të jetë tërhequr e gjitha përgjatë vitit 2010, në shumat 4.250 dollarë, 3.191 dollarë dhe 67.000 dollarë.

22. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në ankim se *konkluzioni i Komisionit, lidhur me problematikat e konstatuara në krijimin e depozitës bankare në “Raiffeisen Bank”, është rezultat i një analize sipërfaqësore dhe hetimi jo të thellë e të gjithanshëm, në shkellje të parimit të objektivitetit e të proporcionalitetit dhe, për pasojë, është paragjykes, i gabuar dhe jo i mbështetur në prova e në ligj.*

Këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit e ka mbështetur në pretendime që kundërshtojnë përfundimet e Komisionit, lidhur me burimet e financimit të kësaj depozite, që nga çelja në vitin 2004 dhe shtesat në vite, deri në datën e tërheqjes/mbylljes së saj në vitin 2010, pretendime të cilat janë analizuar nga trupi gjykues në vijim.

23. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni *i ka mohuar padrejtësisht të ardhurat e saj të siguruara nga punësimi i subjektit në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë për periudhën 1996-1998, duke mos i llogaritur ato si burime të ligjshme kursimi për krijimin e depozitës bankare në emër të së ndjerës, znj. M. H., depozitë e cila ka shërbyer si një nga burimet financiare për shtimin e depozitës në “Raiffeisen Bank”, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, në vitin 2004.*

23.1. Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të këtij pretendimi, ka argumentuar se në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ ka kërkuar që në analizën financiare për verifikimin e mundësisë së krijimit të depozitës bankare në emër të së ndjerës, znj. M. H., duhet të përfshiheshin

¹⁰ Informacion i përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 12.03.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

edhe të ardhurat nga puna e saj e ligjshme, në periudhën 1996-2003, përpara martesës, kur ajo ka jetuar me prindërit dhe kontributi i saj në familje është kursyer prej tyre, për pasojë mundësia e kursimit të familjes së saj rezulton të jetë 1.823.958 lekë, shumë e mjaftueshme për të krijuar depozitën në fjalë. Lidhur me punësimin e saj në ZVRPP-në Lushnjë, nga dokumentacioni i dorëzuar prej saj nuk provohet saktësisht paga mujore *neto* e përfituar në atë periudhë, por në kushtet kur, bazuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ajo kishte provuar se ishte në pamundësi objektive për të paraqitur vërtetimin e pagës për këtë periudhë, Komisioni duhet të kërkonte informacion zyrtar nga ZVRPP-ja Lushnjë apo Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, lidhur me të ardhurat nga paga të përfituara nga subjekti i rivlerësimit, si juriste pranë këtij institucioni. Vetëm kështu hetimi do të konsiderohej i plotë e i gjithanshëm e, për pasojë, edhe vendimmarrja do të ishte objektive. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar, gjithashtu, një vlerësim të ri financiar nga Kolegji, me qëllim që të verifikohet mundësia e kursimit të familjes së saj së origjinës për krijimin e depozitës bankare në emër të znj. M. H., në të cilën të merren në konsideratë pretendimet e saj lidhur me të ardhurat nga pagat si juriste pranë ZVRPP-së Lushnjë, si dhe në përputhje me jurisprudencën e tij, shpenzimet e jetesës për periudhën 1996-1998 të llogariten në masën 30% të të ardhurave të ligjshme.

23.2. Në shqyrtim të këtyre pretendimeve, pas analizimit të dokumentacionit të administruar nga Komisioni për këtë çështje, trupi gjykues konstatoi se:

23.2.1. Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga “Raiffeisen Bank”¹¹, gjatë vitit 2004, në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit të saj në këtë bankë, janë kredituar shuma të ndryshme që në total arrijnë vlerën 2.066.847 lekë, të cilat, referuar deklaratimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e interesave të vitit 2004, burojnë nga: (i) një depozitë bankare e trashëguar nga nëna e saj M. H.; si dhe (ii) të ardhurat nga puna e personit të lidhur.

Në llogarinë bankare në emër të znj. M. H., nënës së subjektit të rivlerësimit, në “Raiffeisen Bank”, dega Lushnjë, ka pasur një gjendje prej 1.000.000 lekësh, të cilat ishin mbartur nga një depozitë e znj. H., në ish-Bankën e Kursimeve, dega Lushnjë. Pas maturimit të depozitës dhe kreditimit të interesit, në datën 19.12.2004, gjendja e llogarisë në “Raiffeisen Bank” ka qenë në shumën 1.066.362 lekë dhe në vijim më datë 29.12.2004, kjo shumë është tërhequr me përshkrimin “Vendim gjyqi nr. {***}, datë 08.09.2004. Prok. {***}, 08.10.2004” dhe në të njëjtën datë, kjo shumë është depozituar *cash* nga z. A. DH., në llogarinë e përbashkët të tij me subjektin e rivlerësimit, në të njëjtën bankë.

23.2.2. Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka paraqitur vendimin nr. {***}, datë 08.09.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me të cilin është vendosur lëshimi i dëshmisë të trashëgimisë ligjore për të ndjerën, znj. M. H., në favor të trashëgimtarëve ligjorë, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit dhe babai i saj kanë trashëguar përkatësisht secili nga ½ pjesë të pasurisë trashëgimore.

¹¹ Informacion i përcjellë nga “Raiffeisen Bank”, në Komision, me shkresat nr. {***} prot., datë 12.03.2020; nr. {***} prot., datë 12.07.2021; si dhe nr. {***} prot., datë 15.07.2021.

23.2.3. Në rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me depozitën e trashëguar nga e ndjera nëna e saj, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, ndër të tjera, edhe për: *“Nga hetimi, gjithashtu, nuk provohet burimi i krijimit të kësaj depozite.[...] Referuar dokumentacionin të administruar nga Komisioni, duket se babai dhe nëna e subjektit kanë qenë në pamundësi financiare për krijimin e depozitës në shumën prej 1.066.362 lekësh”*.

Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: *“Gjithashtu si burim krijimi duhet të përfshihen në analizë edhe pagat e mia përpara martesës në periudhën 1996-2003. Unë kam jetuar me prindërit dhe kontributi i pagës sime është kursyer në familje. Unë nuk kam pasur kurse familjare dhe as llogari bankare përpara martese. [...] Për të ardhurat e përfituara në periudhën shtator 1996 deri në tetor 1998 si juriste në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive Lushnjë, po ju vendos në dispozicion Vërtetimin për Bazën e Vlerësuar, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore”*.

Në vazhdim të shpjegimeve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një tabelë në formën e një analize financiare për periudhën 1998-2003, për të provuar mundësinë e familjes së saj për të krijuar depozitën në emër të znj. M. H., nga e cila rezultonte se mundësia e kursimit të familjes së saj rezulton të jetë 1.704.091 lekë. Trupi gjykues vëren se kjo paraqitje tabelare është e njëjtë me atë të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në ankim, në të cilën mundësia e kursimit të familjes së saj rezulton të jetë 1.823.958 lekë, por rezultati i ndryshëm financiar në mundësinë e kursimit ndikohet nga mënyra e përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës së familjes, të cilat, referuar pretendimit të subjektit të rivlerësimit, në ankim, janë përlllogaritur në vlerë më të ulët.

23.2.4. Në vendim¹², Komisioni ka arsyetuar se: *“Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit dhe shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur, vlerëson si burim të mundshëm financiar për krijimin e depozitës të trashëguar nga e ëma, përveç pensioneve të prindërve, edhe pagat e subjektit të rivlerësimit të përfituara nga punësimi për periudhën kohore 1996-2003, të provuara me dokumentacion ligjor, për sa subjekti provoi se ka qenë në të njëjtin trung familjar me prindërit e saj. Nga analizimi në tërësi i burimeve të krijimit të provuara nga subjekti, pas kalimit të barrës së provës, trupi gjykues arrin në përfundimin se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi financiare për krijimin e depozitës me burime të ligjshme”*.

23.2.5. Nga situata faktike e pasqyruar më sipër, trupi gjykues vëren se pretendimet e parashtuara nga subjekti i rivlerësimit në ankim u referohen gjetjeve fillestare të hetimit administrativ të Komisionit, gjetje këto për të cilat Komisioni nuk ka konkluduar në disfavor të subjektit të rivlerësimit, pasi në vendim është shprehur qartë se si burim të mundshëm financiar për krijimin e depozitës të trashëguar nga e ëma, përveç pensioneve të prindërve, janë përfshirë edhe pagat e subjektit të rivlerësimit të përfituara nga punësimi për periudhën kohore 1996-2003, të provuara me dokumentacion ligjor. Trupi gjykues konstatoi se Komisioni i ka marrë në konsideratë shpjegimet dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, duke përfshirë në burimet financiare të familjes H., edhe pagat e përfituara prej saj për periudhën 1996-2003, si juriste pranë ZVRPP-së, dega Lushnjë, e duke arritur si rrjedhojë në një konkluzion të ndryshëm

¹² Paragrafi 31, faqe 10-11, e vendimit të Komisionit.

në vendim, sipas së cilit prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur mundësi financiare që me burime të ligjshme të krijojnë depozitën bankare në emër të znj. M. H., në shumën 1.066.362 lekë, shumë e cila, më tej, ka shërbyer si një nga burimet e financimit të shtimit të depozitës bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, në “Raiffeisen Bank”, në vitin 2004.

Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni i ka mohuar padrejtësisht të ardhurat e saj të siguruara nga punësimi i subjektit në ZVRPP-në Lushnjë për periudhën 1996-1998, duke mos i llogaritur ato si burime të ligjshme kursimi për krijimin e depozitës bankare në emër të së ndjerës, znj. M. H., nuk është relevant në drejtim të kundërshtimit të konkluzionit të Komisionit, lidhur me vlerësimin e depozitës në “Raiffeisen Bank” dhe, si i tillë, nuk mund të ndikojë në shqyrtimin e shkakut të ngritur në ankim për kundërshtimin si të gabuar të konkluzionit të Komisionit në vendim.

24. Lidhur me pretendimin se *Komisioni nuk ka kryer një hetim të thellë e shterues, pasi ka konkluduar se nga kursimet e tij nga puna si emigrant në shtetin italian dhe nga aktiviteti privat si stomatolog në Lushnjë, personi i lidhur ka arritur të krijojë vetëm depozitën në shumën 1.000.485 lekë në vitin 2004*, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në ankim se Komisioni nuk ka kryer një hetim të thellë, të plotë e shterues, pasi ka konkluduar në mënyrë të përgjithshme se kursimet e bashkëshortit të saj nga puna si emigrant në shtetin italian nga të ardhurat *neto* nga paga në shumën totale prej rreth 76.000 eurosh, si dhe kursimet nga aktiviteti privat si mjek stomatolog në Lushnjë, në vitet 2003-2004, të gjitha së bashku, kanë qenë të afta vetëm që t’i siguronin atij çeljen e një depozite në shumën totale prej 1.000.485 lekësh, në vitin 2004, e cila ka shërbyer si një nga burimet e krijimit të depozitës në “Raiffeisen Bank”. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se në rezultatet e hetimit administrativ, por edhe në vendim, Komisioni nuk i ka përllogaritur të ardhurat e siguruara nga bashkëshorti në vitin 2003, nga aktiviteti si person fizik mjek stomatolog. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni, në vendim, vetëm ka përshtetur formalisht me fjalë llogaritjen e të ardhurave të sipërcituara, por pa e pasqyruar këtë në tabelën e analizës financiare. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ajo ka vërtetuar gjatë hetimit administrativ në Komision se depozita në “Raiffeisen Bank” është krijuar edhe me kursimet e bashkëshortit nga puna e tij dhe veprimtaria si person fizik mjek stomatolog, në periudhën 2003-tetor 2004.

24.1. Në analizë të pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i akteve të administruara nga hetimi administrativ i Komisionit, trupi gjykues, në vijim edhe të rrethanave faktike të pasqyruara në paragrafët 21 dhe 23 më sipër në këtë vendim, konstatoi si më poshtë.

24.1.1. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se: “[...] (b) Në lidhje me të ardhurat nga vetëpunësimi si stomatolog në vitet 2003-2004, Komisioni është bazuar në dokumentacionin ligjor, ku rezulton se z. A. DH., ka qenë i regjistruar si person fizik dhe në dokumentacionin tatimor lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, ku duket se personi i lidhur ka qenë i vetëpunësuar si person fizik stomatolog dhe ka pasur qarkullim për vitin 2004, në shumën 1.250.000 lekë dhe një fitim neto të përllogaritur për vitin 2004, në shumën 625.000 lekë”. Ky konstatim është reflektuar në analizën financiare 2003-2016, në të cilën për vitin 2003, në zërin “Të ardhura nga fitimi i bashkëshortit person fizik stomatolog”, Komisioni nuk ka pasqyruar të

dhëna, ndërsa për vitin 2004 janë pasqyruar në shumën 625.000 lekë, si fitim i realizuar nga personi i lidhur. Në vendim¹³, Komisioni ka arsyetuar dhe konkluduar se: *“Nga analizimi në tërësi i dokumentacionit për të ardhurat e siguruara nga punësimi në shtetin italian, referuar periudhës 1996 - 2002 dhe 2004 (pasi në vitin 2003 bashkëshorti i subjektit nuk rezultoi të ketë përfituar të ardhura në shtetin italian), si dhe dokumentacionit në lidhje me të ardhurat nga vetëpunësimi si stomatolog në vitet 2003-2004, rezultoi se personi i lidhur ka pasur mundësi për krijimin e depozitës prej 1.000.485 lekësh, deklaruar nga subjekti në deklaratën e interesave periodike private 2004”*.

24.2. Edhe pse konkluzioni i mësipërm është në favor të subjektit të rivlerësimit dhe, si i tillë, nuk ka ndikuar si shkak për ngarkimin e tij me përgjegjësi disiplinore në kuadër të këtij procesi e, për pasojë, shqyrtimi i pretendimeve të mësipërme nuk do të afektonte zgjidhjen e çështjes, me qëllim shterimin e shkaqeve të ankimit, trupi gjykues vlerësoi të verifikonte pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me përllogaritjen e të ardhurave të bashkëshortit të saj nga Komisioni.

24.2.1. Nga kontrolli i analizës financiare 2003-2016 bashkëlidhur vendimit të Komisionit, trupi gjykues vëren se ajo është e njëjtë me atë që i është bërë e njohur subjektit të rivlerësimit në rezultatet e hetimit administrativ. Për pasojë, edhe pse në arsyetimin e vendimit, Komisioni ka referuar se ka konsideruar në analizën financiare të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga vetëpunësimi si mjek stomatolog në vitet 2003-2004, në paraqitjen tabelare të të ardhurave të personit të lidhur, në zërin përkatës, nuk janë pasqyruar të ardhura për vitin 2003, ndërsa për vitin 2004 është vendosur vlera 625.000 lekë.

Në kushtet kur vlerësimi i saktë i të ardhurave të ligjshme, në funksion të kontrollit të kriterit pasuror në procesin e rivlerësimit, mundësohet vetëm mbi bazën e dokumenteve nga institucionet shtetërore, trupi gjykues verifikoi dokumentacionin e administruar dhe referuar nga vetë Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ, i cili jep të dhëna për të ardhurat e personit të lidhur nga aktiviteti si mjek stomatolog, në vitet 2003 dhe 2004. Referuar të dhënave të përcjella në Komision nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier¹⁴, si dhe metodologjisë për llogaritjen e fitimit *neto* të personit të lidhur nga aktiviteti si mjek stomatolog, shpjeguar nga Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ¹⁵, trupi gjykues konstatoi se të ardhurat e ligjshme të z. A. DH., si mjek stomatolog, në vitin 2003, duhet të ishin përllogaritur në shumën 625.000 lekë. Gjithashtu, trupi gjykues konstatoi se edhe fitimi *neto* i përllogaritur nga Komisioni për vitin 2004 është përllogaritur mbi bazën e të dhënës për qarkullimin vjetor të vitit 2003 të realizuar nga aktiviteti i personit të lidhur si mjek stomatolog dhe jo mbi atë të vitit 2004.

¹³ Paragrafi 32.2 i vendimit të Komisionit.

¹⁴ Të dhëna të përcjella në Komision nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 20.05.2020.

¹⁵ Në faqen 5 të rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni ka referuar se për periudhën për të cilën nuk ka konfirmim nga organi kompetent për fitimin *neto* të aktivitetit të personit të lidhur si mjek stomatolog, të ardhurat *neto* nga ky aktivitet janë konsideruar në marzhin sa 50% e qarkullimit të konfirmuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier dhe Bashkia Lushnjë, marzh ky i cili është edhe në përputhje me deklarin e subjektit të rivlerësimit në pyetësorin e dytë.

Nga korrektimi i zërit “Të ardhura nga fitimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit (Person Fizik Stomatolog)”, në analizën financiare të Komisionit, për vitin 2003, në shumën 625.000 lekë dhe për vitin 2004 në shumën 550.000 lekë, rezultati i analizës financiare reflekton përmirësim të balancave financiare pozitive për këto vite. Edhe pse pretendimi i subjektit të rivlerësimit u gjet i drejtë, trupi gjykues gjen me vend të nënvizojë se ky konstatim nuk sjell asnjë pasojë mbi konkluzionin e Komisionit, i cili ka reflektuar një situatë pozitive financiare për vitet në fjalë, duke konkluduar se personi i lidhur ka pasur mundësi që me burime të ligjshme financiare të krijonte depozitën prej 1.000.485 lekësh, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së vitit 2004.

24.2.2. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni duhet të llogariste si zëra më vete me shifra konkrete, mundësinë për kursim nga të ardhurat e ligjshme nga puna e bashkëshortit në emigracion dhe mundësinë për kursim nga puna e tij si mjek stomatolog në vitet 2003-2004, trupi gjykues vëren se në analizën financiare, për vitin 2004, Komisioni ka përllogaritur si zëra më vete “Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit para martesë” dhe “Të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti si person fizik mjek stomatolog”. Komisioni e ka trajtuar depozitim në *cash* në llogarinë bankare në vitin 2004 si derivate të të ardhurave të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga të dy këto zëra, në përputhje me burimin financiar të deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së vitit 2004 dhe deklarimet e saj gjatë hetimit administrativ në Komision, se kjo depozitë është krijuar nga të ardhurat nga puna e bashkëshortit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se mënyra e përllogaritjes së mundësisë për të krijuar kurse nga personi i lidhur nga aktiviteti privat si mjek stomatolog, në analizën financiare të Komisionit për vitin 2004, i përgjigjet metodologjisë së pasqyrit të kontabilitetit financiar dhe, për pasojë, është një përllogaritje e drejtë.

25. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *përfundimet e Komisionit për shtimin e depozitës në “Raiffeisen Bank”, në vitin 2005, kanë mohuar padrejtësisht të ardhurat e ligjshme të bashkëshortit të saj në shumat 300.000 lekë dhe 20.000 euro, bazuar në një arsyetim që është rezultat i një hetimi jo të plotë, jo të gjithanshëm dhe as objektiv e proporcional, në kushtet kur ai nuk mbështetet në të gjitha rrethanat e jetës së saj, të deklaruara saktësisht në deklaratat e pasurisë e në vijim gjatë hetimit administrativ në Komision.*

25.1. Në analizë të këtij pretendimi, nga verifikimi i akteve të administruara përgjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues konstatoi si vijon.

Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A. DH., ka investuar në bono thesari në Bankën e Shqipërisë, në datën 16.12.2005, shumën 2.500.000 lekë.

Në llogarinë e z. DH., në “Tirana Bank”¹⁶, në të cilën ka pasur të drejtë veprimi dhe subjekti i rivlerësimit, janë kryer dy depozitime: në datën 17.06.2005, z. A. DH., ka depozituar *cash* shumën prej 300.000 lekësh dhe në datën 30.11.2005, z. I. M., ka depozituar *cash* shumën 600.000 lekë me përshkrimin “Derdhur nga I. M., për blerje shtëpie”. Shuma totale prej 900.400 lekësh (shtuar

¹⁶ Sipas informacionit të përcjellë në Komision, me shkresë nr. {***} prot., datë 05.03.2020, nga “Tirana Bank”.

interesat) është tërhequr nga kjo llogari nga z. DH., në datat 4 dhe 05.01.2006, për t'u investuar më pas në datën 16.01.2006 në bono thesari, në Bankën e Shqipërisë.

Si rezultat i sa më sipër, përgjatë vitit 2005, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë shtuar likuiditetet bankare, në total, në vlerën 3.400.000 lekë.

25.2. Në përfundim të procedurës administrative, pasi ka verifikuar deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në raport me dokumentacionin e mbledhur gjatë hetimit lidhur me likuiditetet bankare të mësipërme, Komisioni, në vendim, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës mbi rezultatet e hetimit, për arsytet, në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:

(i) Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për mosdeklarimin në deklaratën e pasurisë së vitit 2004, të huas dhënë kunetërve nga bashkëshorti, nuk janë bindëse, në raport me detyrimin ligjor për deklarimin e saj;

(ii) Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e mospërputhjeve të fakteve që lidhen me kohën e dhënies dhe kthimin e huas, vlerën dhe qëllimin e përdorimit të saj.

Bazuar në këto përfundime, Komisioni, në vendim¹⁷, ka arritur në konkluzionin se: *“Në analizën financiare të vitit 2005 janë konsideruar të ardhurat e përfituara nga bashkëshortët referuar dokumentacionit ligjor të administruar në dosjen e hetimit, si dhe e ardhura e përfitur nga bashkëshorti i subjektit në shumën 600.000 lekë në datën 15.12.2005. Gjithashtu, në analizën financiare të këtij viti, sikundër dhe në vitet e tjera vijuese, subjektit i janë ngarkuar edhe shpenzimet jetike për babain e saj, bazuar në deklarimin e subjektit se babai ka jetuar me të dhe familjen e saj deri para se të ndërronte jetë. [...] Si konkluzion, subjekti ka kryer deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me burimet e krijimit të depozitave në vitin 2005, duke rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën prej (-) 1.392.870 lekësh, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016”.*

26. Në kundërshtim të secilit prej përfundimeve të arritura nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit në argumentimin e shkakut të ankimit ka parashtruar pretendimet e saj, të cilat janë shqyrtuar dhe analizuar nga trupi gjykues, si më poshtë.

27. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *konkluzioni i Komisionit për të moskonsideruar huan dhënë nga bashkëshorti vëllezërve të tij, për shkak të mosdeklarimit të saj në deklaratën e pasurisë së vitit 2004, është sipërfaqësor e i sforcuar, në favor të një vendimmarrjeje të paracaktuar.*

27.1. Në vendim¹⁸, Komisioni ka arsyetuar se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për mosdeklarimin e huadhënies në deklaratën e interesave të vitit 2004 janë jobindëse dhe të pabazuara në ligj, pasi në bazë të nenit 4, pika 1, shkronja “d” e ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte

¹⁷ Paragrafët 33-35 të vendimit të Komisionit.

¹⁸ Paragrafi 35.18 i vendimit të Komisionit.

në deklaratën vjetore huadhënien ndaj kunetërve, për të cilën në vitin 2005 ka deklaruar se me të ardhurat nga kthimi i saj ka kryer investimin në bono thesari.

27.2. Në ankim, në kundërshtimin e qëndrimit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, ashtu si edhe gjatë hetimit administrativ, ka argumentuar se pasaktësia në deklaratën e vitit 2004 në mosdeklarimin e huas në shumën 20.000 euro, dhënë nga bashkëshorti vëllezërve të tij, ka ardhur për shkak se:

i. këto të ardhura bashkëshorti i ka fituar para martesës me subjektin e rivlerësimit, nga puna si emigrant në shtetin italian;

ii. shuma prej 20.000 eurosh disponohej nga vëllezërit e tij, pra, nuk ishte gjendje në shtëpi apo në llogarinë e tij bankare. Nëse kjo shumë nuk do të ishte kthyer te bashkëshorti, ky i fundit nuk do ta kishte kërkuar kurrë atë nga vëllezërit e tij, për shkak të lidhjes së fortë mes tyre e, për pasojë, subjekti i rivlerësimit, me shumë gjasa, nuk do të kishte rënë kurrë në dijeni të kësaj huaje;

iii. viti 2004 ishte viti i parë i deklarimit të pasurisë nga bashkëshorti¹⁹, vit në të cilin u vërtetuan edhe disa rrethana familjare²⁰, për shkak të të cilave subjekti i rivlerësimit nuk u vu në dijeni të ekzistencës së kësaj huaje;

iv. deklarimi i kësaj shume është bërë me iniciativë nga vetë subjekti i rivlerësimit në vitin 2005, pikërisht në vitin kur kjo shumë iu rikthye fizikisht bashkëshortit nga vëllezërit dhe në kohën kur subjekti i rivlerësimit e mësoi faktikisht këtë rrethanë.

27.3. Nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi si vijon.

27.3.1. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar:

“Në periudhën 1993-2000 kam punuar në shtetin italian si emigrant për motive ekonomike. [...] Nga të ardhurat e pagës si punëmarrës i siguruar dhe jo i siguruar, gjatë gjithë kësaj periudhe, kam realizuar në total të ardhura neto, kursimet nga të cilat i kam sjellë gradualisht në Shqipëri, dorazi. Vlera: 110.000 euro”.

Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2005, ka deklaruar: *“Bono thesari në Bankën e Shqipërisë, rrethi Lushnjë, në dy ankande të organizuara në datën 22.12.2005, në shumën 2.500.000 lekë. Ankandi, datë 20.01.2006, shuma 1.000.000 lekë. Bashkëshorti A. DH., nga puna e tij si emigrant në Itali, nga viti 1993-2002, ka kursyer dhe këtë shumë ia kishte dhënë hua vëllezërve të tij, E., e A. DH. Njëri prej tyre, E. DH., kishte blerë në emër të tij, por me të hollat e kursyera nga bashkëshorti im A., një apartament në fshatin {***}, komuna {***}, Lushnjë. Me kontratë të vitit 2005, kunati im shiti shtëpinë dhe të hollat e përfutuara prej saj ia ktheu bashkëshortit tim. Gjithashtu, të dy kunetërit e mi A., e E., i kthyen bashkëshortit tim dhe pjesën*

¹⁹ Subjekti ka lidhur martesën me bashkëshortin në dhjetor 2003.

²⁰ Subjekti ka pretenduar se rrethanat jetësore të përjetuara gjatë vitit 2004 kishin pasur impakt mbi mosdeklarimin e shumës 20.000 euro, të cilat ishin: ndarja nga jeta e nënës së saj kishte ndikuar në një gjendje emocionale të rënduar në familjen e re të saj të sapokrijuar, si dhe një ndërhyrje kirurgjikale e bashkëshortit, duke sjellë si pasojë që mes tyre të mos diskutohej çdo rrethanë e jetës së mëparshme dhe sigurisht passolli dhe mosnjohjen nga ana e saj të shumës së kursyer nga bashkëshorti që ai ia kishte dhënë hua vëllezërve.

tjetër të huas në total 3.000.000 lekë. Shuma prej 500.000 lekësh u kursye nga të ardhurat nga puna jonë”.

27.3.2. Për shkak të kontrollit të deklaratave të pasurisë për periudhën 2003-2013, sipas procesverbalit të datës 29.04.2015, e pyetur nga ILDKPKI-ja, në lidhje me mosdeklarimin e depozitës së krijuar në “Tirana Bank”, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar, ndër të tjera, se: *“Për sa i përket mosdeklarimit të huadhënies në vitin 2004, është një pasaktësi në deklaram. [...] Lidhur me bonot e thesarit, burimi i krijimit është puna e bashkëshortit në Itali. Në vitin 1998, bashkëshorti ka dërguar likuiditete në Shqipëri dhe vëllai i tij, siç theksova më lart, bleu tokën dhe apartamentin, për llogari të bashkëshortit. Në vitin 2005, apartamenti është shitur dhe shuma e përfituar është depozituar në Tirana Bank, në dy depozita të konstatuara edhe nga ju. Kam paraqitur kontratën e shitjes së apartamentit në shumën 1.000.000 lekë. Kam paraqitur edhe kontratën e blerjes së apartamentit, në vitin 1998. Depozitat bankare në Tirana Bank janë tërhequr në vitin 2006 dhe janë shtuar në bono thesari”.*

27.4. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në raport me deklaramet e saj si më sipër pasqyruar, me aktet e administruara nga Komisioni dhe arsyetimin e këtij të fundit në vendim, trupi gjykues vëren se parashikimi ligjor i përcaktuar në nenin 4 të ligjit nr. 9043/2003 detyronte subjektin e rivlerësimit të deklaronte huan e dhënë nga bashkëshorti vëllezërve të tij, që në momentin e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë prej tij, për herë të parë, por deklarimi i subjektit të rivlerësimit në vitin 2005 duhet lexuar e kuptuar si korrigjim i atij të vitit 2004, për sa kohë objekt i verifikimit janë deklarimet periodike të interesave të deklaruara më parë në ILDKPKI, të cilat në bazë të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 mund të shërbejnë si provë në këtë proces. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mban në konsideratë edhe rrethanat e shpjeguara nga subjekti i rivlerësimit, mbi arsyet pse ka ndodhur mosdeklarimi i huas në vitin 2004, për sa i përket elementit të padijenisë së saj lidhur me ekzistencën e huas, siç ishte situata e rënduar familjare për shkak të ndarjes nga jeta të nënës së saj dhe sëmundjes së bashkëshortit, kombinuar këto edhe me faktin se shuma ishte dhënë hua te vëllezërit e bashkëshortit dhe, për këtë arsye, siç shpjegon subjekti i rivlerësimit edhe mund të mos kthehej fare. Është i vërtetë konstatimi i Komisionit se këto vlera monetare janë bërë burim financimi të një pasurie të krijuar më vonë (këto vlera monetare janë depozituar në vitin 2008 në “Raiffeisen Bank”), por në këtë rast trupi gjykues çmon se prevalon në rëndësi fakti se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar ekzistencën e huas pikërisht në momentin e pretenduar se ka marrë dijeni për ekzistencën e saj, në vitin 2005. Pavarësisht këtyre rrethanave, në mbështetje edhe të jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit²¹, ajo që çmohet se mban peshën kryesore në këtë vlerësim është fakti se të ardhurat e bashkëshortit të subjektit që kanë shërbyer si burim financiar për krijimin e huas, ashtu siç ka pranuar edhe Komisioni në vendim përmbushin standardet e ligjshmërisë, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të

²¹ Lidhur me pasaktësitë në deklaratat periodike vjetore, nëse ato nuk janë të shoqëruara me mungesë burimesh të ligjshme apo nuk janë përpjekje të subjektit për fshehje apo deklarim të rremë të pasurive të krijuara, Kolegji ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, sipas së cilës ato nuk mund të mbahen në konsideratë për t'u kualifikuar si shkelje në kuadër të procesit të rivlerësimit, për rrjedhojë të gjejnë ndonjë kualifikim, sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, për pasojë pasaktësia në deklaram nuk është e lidhur me mungesë të burimeve financiare për të justifikuar pasurinë.

28. Lidhur me pretendimin se në ndryshim nga sa ka konkluduar Komisioni, deklaramet e subjektit të rivlerësimit për kohën e dhënies dhe kthimin e huas, si dhe vlerën dhe qëllimin e përdorimit të saj janë në përputhje të plotë me rrethanat e vërteta jetësore të kësaj marrëdhënieje, trupi gjykues konstatoi si vijon.

28.1. Në vendim²², Komisioni ka arsyetuar se: “Në rastin konkret, deklarata e datës 05.05.2015 përfaqëson vullnetin e vëllezërve të bashkëshortit të subjektit të formalizuar në formë shkresore, e cila ka provuar faktin e marrjes në përdorim të një shume prej 20.000 eurosh në vitin 2000 nga bashkëshorti i subjektit me qëllim përdorimi për motive familjare dhe, për rrjedhojë, çdo lloj deklarate e lëshuar nga të njëjtët deklarues në cilësinë e dëshmitarëve, nuk do të kishte të njëjtën vlerë provuese për kohën e lëshimit. Nën dritën e këtyre rrethanave, trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimi i subjektit për ta bërë pjesërisht të pasaktë deklaratën e dhënë nga kunetërit e saj, në mënyrë që ata të thirren si dëshmitarë, përfaqëson një përpjekje të subjektit për të minuar vlerën e provës shkresore, me qëllim nxjerrjen në pah të provës me dëshmitarë, për t’u mbrojtur për efekt të procesit të rivlerësimit”.

28.2. Në kundërshtim të këtij arsyetimi të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, duke argumentuar se veprimi juridik i huas ekzistonte edhe pse nuk ishte pasqyruar në përmbajtje të ndonjë akti formal të hartuar në kohë reale. Sipas subjektit të rivlerësimit, për të vërtetuar ekzistencën e kësaj marrëdhënieje, ajo ka paraqitur si provë një deklaratë të thjeshtë që kunetërit e saj e kanë plotësuar në një afat të shkurtër e të shpejtë e, për këtë shkak, edhe kanë gabuar (*lapsus*), lidhur me vitin e kthimit të saj, nga 2005 në 2004.

28.3. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në raport me arsyetimin e Komisionit, trupi gjykues vëren se në thelb të tyre qëndron përmbajtja e deklaratës së thjeshtë e datës 05.05.2015, e lëshuar nga A., dhe E. DH., me rastin e kontrollit të ushtruar nga ILDKPKI-ja në vitin 2015, për të provuar vërtetësinë e deklarameve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me huan në deklaratën periodike të interesave të vitit 2005. A., dhe E. DH., në deklaratën e sipërcituar, janë shprehur: “*Deklarojmë se vëllai ynë A. LL. DH., në vitin 2000, na ka lënë në ruajtje dhe përdorim një shumë prej rreth 20.000 euro, me qëllim përdorimi për motive familjare. Këtë shumë ne ia kemi kthyer në vitin 2004*”.

28.4. Në vlerësimin e situatës faktike të rezultuar nga hetimi administrativ i kryer në Komision, trupi gjykues vëren se:

(i) subjekti i rivlerësimit ka mbajtur një qëndrim konsekuent gjatë gjithë hetimit administrativ në Komision se deklarimi i saj në deklaratën e interesave të vitit 2005, se huaja është kthyer në

²² Paragrafi 35.8 i vendimit të Komisionit.

këtë vit, është një deklaram i saktë, ndërsa vendosja e vitit 2004, si vit i kthimit të huas në deklaratën e kunetërve të saj, është një gabim material, një *lapsus*, i bërë prej tyre;

(ii) deklarata e lëshuar nga vëllezërit DH., është për efekt të kontrollit të ILDKPKI-së mbi deklaramet e subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003-2013. Referuar procesverbaleve të përcjella në Komision nga ILDKPKI-ja, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet para inspektorëve të këtij institucioni në datat 15.04.2015 dhe 29.04.2015, ndërsa deklarata e vëllezërve DH., i është përcjellë subjektit të rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike në datën 05.05.2015 e më pas duhet të jetë përcjellë prej saj në ILDKPKI. Në bazë të parashikimit të nenit 27 të ligjit nr. 9049/2003, gjatë kontrollit, Inspektorati i Lartë thërret zyrtarin për të dhënë shpjegime të hollësishme dhe argumentet përkatëse, të cilat paraqiten kurdoherë me shkrim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Duke krahasuar parashikimin e mësipërm, me datat në të cilat subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet e saj pranë institucionit të kontrollit dhe datës në të cilën është hartuar deklarata e vëllezërve DH., duket i besueshëm pretendimi i subjektit të rivlerësimit se kunetërit e saj e kanë plotësuar në një afat të shkurtër e të shpejtë deklaratën e dërguar me postë elektronike. Sigurisht që subjekti duhet të kishte treguar sensitivitet e kujdes në verifikimin e të dhënave të deklaruara prej kunetërve, për shkak se kjo deklaratë do të dorëzohej në një institucion shtetëror, i cili kishte në fokus pikërisht kontrollin e vërtetësisë së deklarameve të saj;

(iii) nuk evidentohet asnjë rrethanë që do e detyronte subjektin e rivlerësimit të mos deklaronte të vërtetën në këtë rast, për sa kohë që huaja dhe kthimi i saj nuk është deklaruar për efekt të procesit të rivlerësimit, por është deklaruar në mënyrë vullnetare prej saj në deklaratën e interesave të vitit 2005. Gjithashtu, edhe versioni i zhvendosjes në kohë të kthimit të huas në vitin 2004, si kanë deklaruar vëllezërit DH., nuk sjell asnjë pasojë në lidhje me financimin prej personit të lidhur të bonove të thesarit, për sa huaja, në çdo rast, është kthyer përpara datës së investimit në këto bono;

(iv) përveç sa më sipër, siç është pranuar nga Komisioni, por edhe konfirmuar nga kontrolli i kryer në Kolegj, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit kishte burime të ligjshme financiare për dhënien në përdorim/hua të shumës prej 20.000 eurosh vëllezërve të tij;

(v) në ndryshim nga sa ka konstatuar Komisioni²³, nuk duket se ka deklarime kontradiktore në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, e cila në përgjigje të barrës së provës së kaluar nga Komisioni lidhur me huan, brenda të njëjtit paragraf, ka deklaruar se: *“Lidhur me kthimin e huasë, gjithmonë referuar marrëdhënies së posaçme mes tyre, për aq sa më ka deklaruar bashkëshorti, kjo shumë është kthyer nga vëllezërit tek ai në Shqipëri, gjatë kohës që ata vinin nga Italia. Shumat janë dorëzuar pjesë-pjesë dhe dorazi te bashkëshorti im, në vitin 2005, në një kohë që edhe lidhja jonë po konsolidohej dhe po diskutonim mundësinë e ndonjë investimi për ushtrimin e profesionit të tij si stomatolog. Shumat janë sjellë në Shqipëri nga kunati im A. DH., dhe bashkëshortja e tij E.,*

²³ Komisioni ka arsyetuar në vendim: 35.15. Gjithashtu, nga administrimi i shpjegimeve përfundimtare të subjektit dhe provave, konstatohet se ka deklarime kontradiktore për kthimin e shumës së huas. Subjekti, në fillim ka shpjeguar se shuma e huas i është dorëzuar dorazi dhe pjesë-pjesë bashkëshortit nga vëllezërit e tij në vitin 2005, duke theksuar se deklarimi për kthimin në vitin 2004 nga ana e tyre ka qenë *lapsus*. Ndërsa në vijim të shpjegimeve ka sqaruar se shumat janë sjellë në Shqipëri pjesë-pjesë nga kunati i saj A. Dh. dhe bashkëshortja e tij E. Dh., si dhe kushëririn e bashkëshortit të saj, E.P.B., dorazi, gjatë vitit 2005. Trupi gjykues konkludon se subjekti nuk arriti të provojë në lidhje me kthimin e huas, si dhe mbi mospërputhjet e deklarameve për vitin e kthimit të kësaj huaje.

DH., si dhe kushëriri (djali i hallës së bashkëshortit) E. P. B., pjesë-pjesë dhe dorazi në Shqipëri gjatë vitit 2005”. Pra, subjekti i rivlerësimit, fillimisht, ka qenë përgjithësuese në shpjegimet e saj, duke iu referuar personave që kishin detyrimin për kthimin e huas e, më tej, ka zbritur në detajet e dorëzimit fizik të huas te bashkëshorti i saj nga personat përkatës.

28.5. Në përfundim, nga tërësia e rrethanave të sipëranalizuara, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se huaja/ndihma e dhënë nga personi i lidhur vëllezërve të tij është kthyer prej tyre në vitin 2005, është bindës dhe, për rrjedhojë, shuma prej 20.000 eurosh konsiderohet si një burim i ligjshëm të ardhurash për të financuar investimin në bono thesari nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e, më tej, krijimin e depozitës bankare, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

29. Në lidhje me pretendimin se Komisioni, *me një vendim të ndërmjetëm e të paarsyetuar, ka refuzuar marrjen e një prove të re, siç është prova me dëshmitarë, duke shkelur parimin e barazisë së armëve e kontradiktoritetit, në funksion të një vendimmarrje të paracaktuar*, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në ankim se dëshmia e kunetërve të saj dhe bashkëshortëve Q., është kërkuar jo për të minuar vlerën e provës me dokument, por për të qartësuar plotësisht para Komisionit rrethana të vërteta dhe reale të jetuara prej tyre. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni i ka dhënë deklaratës së datës 05.05.2015 të z. E., dhe z. A., DH., një vlerë të paracaktuar e fuqi të plotë provuese mbi të gjitha aktet e tjera.

29.1. Nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, më datë 03.11.2021, në përfundim të seancës dëgjimore publike, së bashku me kërkesën për administrimin e provave, ka depozituar në Komision edhe kërkesën që Komisioni të thërrasë e të pyesë në cilësinë e dëshmitarit z. A., D., z. E., DH., z. F., Q., dhe znj. S., Q. Me vendimin nr. 5, datë 04.11.2021, Komisioni, pasi ka shqyrtuar kërkesën e sipërcituar të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me shkronjat “b” dhe “d” të pikës 6 dhe pikat 8 e 9 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, ka refuzuar kërkesën e saj, duke e çmuar *si të panevojshme këtë dëshmi, përderisa këta shtetas kanë shprehur vullnetin në formë shkresore në lidhje me rrethana të caktuara, të cilat janë administruar në cilësinë e provave*.

29.2. Në analizë të kësaj situate faktike në raport me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se paraqitja e deklaratave të personave të sipërcituar është konsideruar nga Komisioni se ka ezauruar barrën e provës, bazuar në nenin Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016. Në vlerësim të trupit gjykues, argumentimi i dhënë nga Komisioni për mospranimin e kërkesës rezulton të jetë sqarues lidhur me arsyet e vendimmarrjes, brenda diskrecionit të Komisionit për të vlerësuar marrjen e provave dhe thirrjen e dëshmitarëve në kuadër të parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit vlerësohen se janë të pabazuara në fakte e në ligj.

30. Lidhur me pretendimin se *konkluzioni i Komisionit për blerjen e pasurisë “apartament”, në {***}, Lushnjë, në vitin 1998, nga bashkëshorti i saj është sipërfaqësor dhe empirik, në kundërshtim të*

arsyetimit të Komisionit në vendim²⁴, ashtu si edhe në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se blerja e pasurisë “apartament”, në {***}, Lushnjë, është bërë nga z. E., DH., vëllai i bashkëshortit, për llogari të këtij të fundit dhe se nuk ka pasur asnjë marrëveshje të shkruar mes tyre për këtë çështje. Ata kanë qenë në kushtet e mirëbesimit reciprok e të plotë mes tyre dhe ligji nuk e ndalonte këtë veprim. Kontrata është lidhur në vitin 1998, kohë në të cilën z. A., DH., nuk kishte lidhur martesë ligjore me subjektin e rivlerësimit e, në këto kushte, ai nuk kishte asnjë detyrim që të nënshkruante një prokurë siç pretendon Komisioni, pasi ai nuk mund të parashikonte se për një veprim të kryer mes dy vëllezërve në mirëbesim do të duhej të jepte llogari e të penalizohej rreth 20 vjet më vonë. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar, gjithashtu, se në ndryshim të arsyetimit fyes të Komisionit ndaj saj, me argumentet dhe provat e paraqitura, ajo nuk ka pasur aspak qëllim të justifikojë një kontratë fiktive siç e quan Komisioni kontratën e shitblerjes së pasurisë, por ka provuar faktin se çmimi i blerjes së pasurisë “apartament” është siguruar nga puna e bashkëshortit të saj nga emigracioni, në Itali.

30.1. Në vlerësimin e situatës faktike të rezultuar nga hetimi administrativ, në raport me arsyetimin e Komisionit dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, nga interpretimi i deklaratës së pasurisë së vitit 2005²⁵, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka bërë një ndarje të qartë të faktit të blerjes dhe shitjes së pasurisë “apartament” nga z. E., DH., me faktin e kthimit të pjesës tjetër të huas, në total në shumën 3.000.000 lekë. Në këtë deklaram, subjekti i rivlerësimit ka

²⁴ Komisioni, në vendim, ka arsyetuar: “35.12. Trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk është i bazuar në ligj, pasi, nëse bashkëshorti i subjektit ka pasur qëllim të blinte një apartament dhe ka ardhur nga Italia në Shqipëri në vitin 1998 për të ndërmjetësuar dhe paguar çmimin e blerjes, sikurse ka shpjeguar subjekti, nuk ka pasur asnjë pengesë të lëshonte edhe një prokurë të posaçme para se të largohej nga Shqipëria, ku të autorizonte vëllain e tij, shtetasin E. Dh., që të nënshkruante kontratën e blerjes së apartamentit në emër për llogari të tij. Për më tepër, përpjekjet e subjektit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, duke e trajtuar kontratën e blerjes së apartamentit të datës 24.08.1998, si një kontratë e bërë në marrëveshje midis palëve, pa pasur qëllim të sjellë pasojën ligjore të blerjes nga shtetasi E. Dh., nuk i përshiaten aspak etikës profesionale të një subjekti magjistrat, i cili duhet t’i garantojë publikut zbatimin e normave ligjore. 35.13. Në lidhje me deklarinimin për huan e dhënë, trupi gjykues vlerëson, gjithashtu, se subjekti ka ndryshuar deklarinimin në shpjegimet përfundimtare, duke pasur për qëllim që t’i shkojë sa më afër deklaratës së lëshuar nga kunetërit e saj për shumën e marrë 20.000 euro, me qëllim justifikimin e investimit në bono thesari në shumën 2.500.000 lekë, në vitin 2005, si dhe njëkohësisht, duke pasur si qëllim të veçojë huan nga fakti i blerjes së apartamentit, për shkak të mospërputhjes së elementit kohë. Subjekti, ndryshe nga sa ka deklaruar në DIPP/2005 se bashkëshorti i saj u ka dhënë vëllezërve të tij hua për blerjen e apartamentit, i cili nga hetimi rezultoi se ishte blerë përpara huas së dhënë, në shpjegimet përfundimtare ka deklaruar se paratë për blerjen e apartamentit në shumën prej 710.000 lekësh janë sjellë vetë nga bashkëshorti i saj në vitin 1998 dhe me të është paguar çmimi i blerjes. Subjekti ka deklaruar si hua të dhënë kunetërve të saj vetëm shumën 20.000 euro ose, sipas subjektit, kundërvlera në shumën rreth 2.500.000 lekë, pra, sa vlera e investimit në bono thesari. Duke i dhënë vlerë provuese deklarinimit vjetor në DIPP/2005, bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues çmon se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e mospërputhjeve të deklarinimit me faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit”.

²⁵ Në deklaratën e interesave të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Bashkëshorti A., DH., nga puna e tij si emigrant në Itali, nga viti 1993-2002 ka kursyer dhe këtë shumë ia kishte dhënë hua vëllezërve të tij, E., e A., DH. Njëri prej tyre E., DH., kishte blerë në emër të tij, por me të hollat e kursyera nga bashkëshorti im A., një apartament në fshatin {***}, komuna {***}, Lushnjë. Me kontratë të vitit 2005, kunati im shiti shtëpinë dhe të hollat e përfituara prej saj ia ktheu bashkëshortit tim. Gjithashtu, të dy kunetërit e mi A., e E., i kthyen bashkëshortit tim dhe pjesën tjetër të huas në total 3.000.000 lekë. Shuma prej 500.000 lekësh u kursye nga të ardhurat nga puna jonë”.

potencuar faktin e blerjes së pasurisë “apartament” nga z. E., DH., me kursimet e bashkëshortit të saj, ndërsa kthimi i shumës 20.000 euro prej dy kunetërve është deklaruar si një moment i ndarë nga kthimi i të hollave të përfituara nga shitja e pasurisë “apartament” nga z. E., DH. Fragmentarizmi i fakteve të mësipërme nga subjekti i rivlerësimit nuk bie në kundërshtim me atë që kanë deklaruar vëllezërit DH., në datën 05.05.2015, se shuma u është lënë në ruajtje me qëllim përdorimi për motive familjare, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar qëllimin e dhënies së pjesës *tjetër* të huas. Për më tepër, vëllezërit e personit të lidhur, në deklaratën e tyre kanë identifikuar edhe elementin e kohës së dhënies së pjesës *tjetër* të huas, vitin 2000. Për rrjedhojë, konstatimi dhe arsyetimi i Komisionit në vendim, se *subjekti ka deklaruar se me huan e dhënë kunetërve nga bashkëshorti i saj, z. E., DH., kishte blerë një apartament në {***}, hua të cilën ia ktheu bashkëshortit me shitjen e këtij apartamenti*, në vlerësim të trupit gjykues, nuk është i drejtë, pasi u gjet i pabazuar në prova.

30.2. Në vijim të analizës së pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit, si vijon.

30.2.1. Me anë të kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.08.1998, z. E., DH., ka blerë nga z. TH., RR., pasurinë “apartament (2+1)”, të ndodhur në fshatin {***}, Lushnjë, në shumën 710.000 lekë. Kjo pasuri është shitur nga z. E., DH., te z. I., M., për shumën 1.000.000 lekë, me anë të kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.11.2005. Ky fakt është deklaruar në mënyrë konsistente nga subjekti i rivlerësimit, si në deklaratën e pasurisë së vitit 2005, vit në të cilin ka ndodhur shitja e pasurisë “apartament” dhe përfitimi i të ardhurave, ashtu dhe në shpjegimet e dhëna prej saj pranë ILDKPKI-së, me rastin e kontrollit të ushtruar nga ky institucion, në datat 15.04.2015 dhe 29.04.2015, në të cilat ka deklaruar, ndër të tjera, se: “[...] Në vitin 1998, bashkëshorti ka dërguar likuiditete në Shqipëri dhe vëllai i tij, siç theksova më lart, bleu tokën dhe apartamentin, për llogari të bashkëshortit. Në vitin 2005, apartamenti është shitur dhe shuma e përfituar është depozituar pranë Tirana Bank, në dy depozita të konstatuara edhe nga ju. Kam paraqitur kontratën e shitjes së apartamentit në shumën 1.000.000 lekë. Kam paraqitur edhe kontratën e blerjes së apartamentit, në vitin 1998. Depozitat bankare në Tirana Bank, janë tërhequr në vitin 2006 dhe janë shtuar në bono thesari”.

Një deklaram i njëjtë është bërë edhe nga personi i lidhur në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në të cilën ka deklaruar se: “[...] Këto sipërfaqe toke janë blerë faktikisht me kontratën noteriale datë 24.08.1998, nr. {***} rep., nr. {***} kol., dhe së bashku me një apartament të ndodhur po në fshatin {***}, të cilin aktualisht e kam shitur. Shitës i këtyre sipërfaqeve ka qenë z. TH., RR., dhe blerës në kontratë ka qenë vëllai im E., DH., i cili ka nënshkruar kontratën në kushtet e mirëbesimit, në emër të tij, por për llogarinë time, pasi në atë kohë ndodhesha në Itali si emigrant për motive punësimi dhe kam dërguar dorazi shumën për blerjen e këtyre pasurive 710.000 lekë, pasi nuk mund të paraqitesha personalisht para noterit”. Të njëjtin qëndrim, subjekti i rivlerësimit e ka mbajtur edhe gjatë hetimit administrativ në Komision, por edhe në ankim.

30.2.2. Trupi gjykues vëren se lidhja e kontratës së shitblerjes së pasurisë “apartament” nga z. E., DH., veprimi juridik i cili qëndron në thelb të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, është kryer në këto rrethana të provuara gjatë hetimit administrativ të Komisionit:

(i) veprimi i blerjes së pasurisë “apartament” është kryer në vitin e largët 1998, kur z. A., DH., ishte emigrant në Itali; veprimi është kryer nga një person në lidhje të ngushtë ligjore, nga vëllai i tij, z. E., DH., i cili jetonte në atë kohë në {***}, Lushnjë;

(ii) nga verifikimi i gjeneraliteteve të z. E., DH., rezulton se ai është i ditëlindjes 08.04.1980, çka do të thotë se në kohën e lidhjes së kontratës së blerjes së pasurisë (datë 24.08.1998) ai ishte në moshën 18 vjeçare, lindur dhe banues në {***}, Lushnjë, që justifikon faktin që çmimi i blerjes së pasurisë të kenë qenë të ardhurat e vëllait të tij emigrant, një situatë e njohur kjo për shumë nga familjet shqiptare. Blerja e apartamentit me të ardhurat e z. A., DH., është pranuar edhe nga z. E., DH., në deklaratën e thjeshtë të nënshkruar prej tij, në datën 01.10.2021, në të cilën deklaron se ai nuk mund të kishte të ardhura të vetat për blerjen e pasurisë “apartament”, pasi ishte në shkollë të mesme, por ato i janë dhënë nga vëllai i tij z. A., DH;

(iii) subjekti i rivlerësimit ka vërtetuar gjatë hetimit administrativ në Komision se kjo pasuri është përdorur nga bashkëshorti i saj, pasi kontrata e energjisë elektrike ka qenë lidhur në emër të z. A., DH., Me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 19.10.2021, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (së energjisë elektrike) ka informuar subjektin e rivlerësimit se: *“Në sistemin e faturimit, kontrata me kod {***}, aktualisht i përket shtetasit I., M., me adresë {***}, Lushnjë. Kjo kontratë ka qenë në emër të abonentit A., DH.,”*. Bashkëlidhur shkresës, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka paraqitur dokumentacionin për ndryshimin e emrit të abonentit nga A., DH., në I., M., si dhe faturat e energjisë elektrike në emër të abonentit A., DH;

(iv) në deklaratën e pasurisë së vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar përbërjen familjare sipas regjistrit të gjendjes civile të Njësisë Administrative {***}, Lushnjë;

(v) një pjesë e çmimit të shitjes së apartamentit në shumën 1.000.000 lekë si rezultat i lidhjes së kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.11.2005, mes z. E., DH., dhe z. I., M., është derdhur në llogarinë bankare të z. A., DH., në Bankën e Tiranës, dega Lushnjë, në datën 30.11.2005, në shumën 600.000 lekë, me përshkrimin “Derdhur nga I., M., për blerje shtëpie”. Ky veprim i kryer në kohën e blerjes së pasurisë, jo vetëm shkon në linjë me pretendimet e subjektit të rivlerësimit se të ardhurat nga shitja e pasurisë “apartament”, në {***}, Lushnjë, janë përfituar nga personi i lidhur, por janë vlerësuar në të njëjtën mënyrë edhe nga Komisioni, duke i konsideruar këto të ardhura në analizën financiare të vitit 2005²⁶;

(vi) analiza e marrëdhënies së personit të lidhur me vëllanë e tij i përket periudhës rreth 5 vjet më parë se subjekti i rivlerësimit të lidhej në martesë me z. DH., dhe, në vijim edhe të jurisprndencës së Kolegjit në këtë drejtim, konsiderohet jo objektive të ngarkohet me barrë subjekti i rivlerësimit për pasuri të krijuara, në një kohë kur ai nuk kishte me këta individë asnjë lloj

²⁶ Në paragrafin 35.18 të vendimit, Komisioni ka konkluduar: *“Në analizën financiare të vitit 2005 janë konsideruar të ardhurat e përfituara nga bashkëshortët referuar dokumentacionit ligjor të administruar në dosjen e hetimit, si dhe e ardhura e përfituar nga bashkëshorti i subjektit në shumën 600.000 lekë në datën 15.12.2005, referuar depozitimit bankar pranë “Tirana Bank” me përshkrimin “Depozitim nga I. M., për blerje shtëpie”.*

marrëdhënieje, që do t'i detyronte ata apo vetë subjektin të ishin të vëmendshëm rreth standardit të dokumentimit të marrëdhënieve juridike, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.

30.3. Në vlerësim të trupit gjykues, tërësia e rrethanave të sipëranalizuar dëshmon se është bindës pretendimi i subjektit të rivlerësimit se investimi fillestar për blerjen e pasurisë “apartament”, në {***}, Lushnjë, në vitin 1998, është bërë nga personi i lidhur nga të ardhura të ligjshme nga puna në emigracion e, për pasojë, shuma prej 1.000.000 lekësh e përfituar nga shitja e kësaj pasurie në vitin 2005 i përkiste bashkëshortit të saj, z. A., DH., si një shumë e krijuar nga një marrëdhënie juridike e ligjshme dhe e dokumentuar rregullisht. Në konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se shuma prej 1.000.000 lekësh konsiderohet si një burim i ligjshëm financiar për investimin në bono thesari e, më tej, në shtimin e depozitës bankare në “Raiffeisen Bank”, në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

30.4. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *konstatimi i Komisionit në paragrafin 35.16 të vendimit²⁷ është një rrethanë e re e shtuar në vendimin përfundimtar, për të cilën nuk i janë kërkuar shpjegime apo prova gjatë hetimit administrativ*, trupi gjykues vëren se në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni nuk i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës mbi mundësinë e vëllezërve të bashkëshortit për të kthyer huan e marrë atij, edhe pse ky kontroll do të ishte në përputhje me nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, konstatimi i Komisionit në vendim, lidhur me pamundësinë e verifikimit nëse z. E., dhe z. A., DH., kishin mundësi të kthenin huan, nuk mund të shërbejë si një argument në disfavor të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të arritjes së konkluzionit se huaja nuk i është kthyer personit të lidhur nga vëllezërit e tij.

30.5. Në konkluzion, referuar rrethanave të mësipërme, trupi gjykues i çmon bindëse deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me shumën e përfituar nga shitja e pasurisë “apartament”, në {***}, Lushnjë, si dhe kthimin e huas nga vëllezërit e bashkëshortit, duke i konsideruar këto shuma të përdorura si burime të ligjshme financimi për investimin në bono thesari e, më tej, për shtimin e depozitës bankare në “Raiffeisen Bank”, në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

30.6. Në analizën financiare të kryer nga Komisioni, për verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për të kryer investimet në bono thesari në Bankën e Shqipërisë në vitin 2005, duke korrigjuar vetëm zërat për të cilët pretendimet e subjektit të rivlerësimit u konsideruan të drejta, balanca negative nga vlera (-) 1.392.870 lekë, që ishte në analizën e Komisionit, kthehet në bilanc pozitiv në vlerën (+) 1.481.190 lekë, për pasojë trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

²⁷ Komisioni ka arsyetuar se: “35.16. Trupi gjykues çmon, gjithashtu, se nga vlerësimi i bërë dokumentacionit të të ardhurave të kunetërve të përfituara në Itali për periudhën 01.03.2000-31.12.2005, nuk mund të arrihet në një konkluzion për mundësinë financiare të tyre për kthimin e huas në vitin 2005, siç ka pretenduar subjekti, pasi mbi to duhet të llogariten shpenzimet jetike për numrin e familjarëve, shpenzimet e tjera dhe investimet e kryera përgjatë viteve, detyrimet ndaj të tretëve, mungesa e të cilëve e bën të pamundur analizën e treguesve financiarë”.

31. Në përmbledhje të arsyetimit të mësipërm, në analizë të situatës faktike dhe ligjore lidhur me burimet financiare të krijimit të depozitës bankare në “Raiffeisen Bank”, në shumën 67.000 dollarë, trupi gjykues vlerësoi se kjo pasuri është krijuar nga burime të ligjshme financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

- *Lidhur me pagesën e kështit të parë në shumën 25.000 euro, për blerjen e pasurisë “apartament me sip. 112,1 m²”, në {***}, Tiranë*

32. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *shuma prej 25.000 eurosh, si pagesë e kështit të parë të pasurisë “apartament”, duhet të konsiderohet nga Kolegji se ka si burim të ligjshëm financiar, depozitën bankare në “Raiffeisen Bank”, krijuar me rrugë plotësisht të ligjshme e të moralshme, prej saj dhe personit të lidhur.*

32.1. Komisioni, në vendim²⁸, ka arritur në përfundimin se: *“Si konkluzion, lidhur me pagesën e kështit të parë prej 25.000 eurosh në datën 17.12.2010, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në DIPP/2010 për pagesën e këtij kësti me burim nga depozita bankare në Raiffeisen Bank, pasi nga hetimi rezultoi se subjekti nuk ka përdorur depozitën si burim për pagesën e kështit të parë. Gjithashtu, subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën prej (-) 4.225.563 lekësh për të justifikuar pagesën e kështit të parë, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016”.*

Komisioni, në vendim²⁹, ka arsyetuar në mënyrë të përmbledhur se subjekti i rivlerësimit nuk provoi deklarimin e saj në deklaratën e interesave private të vitit 2010 dhe në deklaratën e rivlerësimit për pagesën e kështit të parë prej 25.000 eurosh me depozitën bankare në “Raiffeisen Bank”, pasi nga hetimi rezultoi se: (a) megjithëse depozita ishte maturuar që në datën 08.12.2010, për rrjedhojë ishte e lirë të përdorej nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në datën e pagesës më 17.12.2010, ajo rezultoi e pa tërhequr nga “Raiffeisen Bank”; (b) depozita u tërhoq nga znj. S., Q., në datën 21.12.2010 dhe nuk mund të ketë shërbyer për pagesën e kështit të parë prej 25.000 eurosh, kështu që cili nga hetimi u provua se është paguar me mandatpagesën e datës 17.12.2010 nga bashkëshorti i subjektit, z. A., DH.

32.2. Në argumentim të shkakut të ankimit në kundërshtim të arsyetimit e konkluzionit të mësipërm të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni duhet ta vlerësonte përdorimin e depozitës në “Raiffeisen Bank” për pagesën e pasurisë “apartament” nën dritën e të gjithë fakteve dhe rrethanave të ndodhura nga muaji dhjetor 2010 deri në muajin shkurt 2011. Ajo ka parashtruar të njëjtat argumente si në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, duke pretenduar se pasaktësitë në deklarimin e saj në lidhje me maturimin e depozitës bankare kanë qenë për shkak se nuk ishte konsultuar me aktet e bankës, me bashkëshortin dhe z. F., Q., e bashkëshorten e tij, znj. S., Q., por gjatë konsultimit me qetësi me ata ka kujtuar të gjithë diskutimet dhe veprimet e kryera në datën 17.12.2010. Subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshortin dhe

²⁸ Paragrafi 47.11 i vendimit të Komisionit.

²⁹ Paragrafët 47.1-47.5 të vendimit të Komisionit.

z. F., Q., si dhe motrën e tij janë gjendur së bashku në zyrat e shoqërisë “{***}” ShPK për të diskutuar mbi blerjen e një apartamenti. Përfaqësuesi i shoqërisë kërkoi që në rast të prenotimit të apartamentit ata duhet të paguanin të paktën një këst. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk dispononin shuma të hollash me vete, z. Q., propozoi të jepte një shumë të hollash nga gjendja që kishte me vete dhe të ulte këstin e tij për prenotimin e apartamentit, pasi për shkak të aktivitetit që ushtronte i interesonte që kësti i parapagimit të ishte më i ulët dhe kështu kishte mundësi të përdorte shumat monetare edhe për disa kohë. Ata e pranuan propozimin e z. Q., dhe ranë dakord që nëse do të ktheheshin në Lushnjë brenda orarit zyrtar do të shkonin në bankë për të kryer tërheqjen e depozitës që dispononin. Z. A., DH., firmosi mandatin në zyrat e shoqërisë për likuidimin e kështit në shumën 25.000 euro dhe më pas janë paraqitur të tre familjet te noteri për të nënshkruar kontratën paraprake të shitjes. Duke qenë se nuk kanë mundur të shkojnë në bankë, më datë 17.10.2010, për të tërhequr depozitën dhe për t’i dhënë z. Q., shumën e paguar prej tij, si dhe për shkak se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kishin prenotuar biletat për udhëtimin me traget drejt Italisë, i kanë lënë znj. S., Q., prokurën e posaçme, datë 17.12.2020, për të tërhequr depozitën bankare, në shumën 67.000 dollarë, në “Raiffeisen Bank”, shumë e tërhequr prej saj në datën 21.12.2010, nga e cila, pasi është mbajtur shuma prej 25.000 eurosh, i është kthyer subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj shuma prej 20.000 eurosh, në muajin shkurt 2011. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar të njëjtin qëndrim që ka mbajtur edhe në përgjigje të barrës së provës së kaluar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, duke pretenduar se është i saktë deklarimi i saj në deklaratën periodike të vitit 2010, se si burim financiar për kryerjen e pagesës prej 25.000 eurosh ka shërbyer depozita bankare. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se marrëdhënia me familjen Q., ka zgjatur ligjërisht vetëm për disa orë të datës 17.12.2010, duke filluar nga koha e pagimit të kështit nga z. F., Q., deri në momentin e nënshkrimit të prokurës së posaçme në emër të znj. S., Q., me të cilën subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i dhanë asaj të drejta të plota mbi depozitën bankare. Në këto kushte, kur të gjitha këto veprime janë kryer brenda vitit 2010, nuk kishte mbetur asgjë për t’u deklaruar më datë 31.12.2010, në kuptim të ligjit nr. 9049/2003. Depozita prej 67.000 dollarësh është kursimi i gjithë punës së subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj ndër vite, me qëllim blerjen e një apartamenti. Ky apartament është e vetmja pasuri e paluajtshme blerë gjatë martesës me të ardhurat e secilit, duke përdorur në thelb depozitën bankare prej 67.000 dollarësh dhe kredinë bankare prej 5.000.000 lekësh. Sipas subjektit të rivlerësimit, marrëdhënia mes tyre dhe bashkëshortëve Q., nuk duhet të konsiderohet, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të passjellë detyrimin e saj që të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave që ata kanë përdorur për të blerë shtëpinë e tyre të banimit, nga të cilat kanë parapaguar njërin këst të çmimit të apartamentit për llogari të bashkëshortit të subjektit, për ta rimarrë vetëm pak orë më pas, në datën 17.12.2010, në momentin që me anë të prokurës noteriale znj. Q., iu dha tagër e plotë mbi depozitën në “Raiffeisen Bank” dhe ajo mund të dispononte tërësisht shumën. Sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, marrëdhënia e “borxhit me bashkëshortët Q.,” është kushtëzuar nga dy faktorë: kërkesa e menjëhershme e shoqërisë shitëse për parapagimin e një kësti për blerjen e pasurisë “apartament”, ditën e lidhjes së kontratës, kërkesë të cilën subjekti dhe bashkëshorti nuk e njihnin më parë, si dhe planifikimi

paraprak që ata kishin bërë për t'u larguar në Itali në datën 19.12.2010, nga ku do të ktheheshin në muajin janar.

32.3. Nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit, trupi gjykues konstatoi situatën faktike si më poshtë.

32.3.1. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, si një nga burimet e krijimit të pasurisë “apartament me sipërfaqe totale 112,1 m²”, në {***}, Tiranë, subjekti ka deklaruar të ardhurat e kursyera nga puna e secilit bashkëshort në vitet paraardhëse.

32.3.2. Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar³⁰: “Depozita bankare (USD) në Raiffeisen Bank, dega Lushnjë është tërhequr për t'u përdorur për blerjen e një apartamenti të ndodhur në ZK {***}, nr. pasurie {***}. [...] Me kontratën paraprake të shitjes (kreditimi), datë 17.12.2010, unë dhe bashkëshorti si blerës dhe shoqëria “{***}” ShPK si shitëse, kemi shprehur vullnetin për blerjen e një apartamenti të ndodhur në {***}, Tiranë, çmimi i shitjes është 82.500 euro, nga të cilat 25.000 euro i kemi paguar shitësit. Diferenca prej 57.500 eurosh do të paguhej në momentin e lëvrimin të një kredie bankare në Raiffeisen Bank, dega Lushnjë. Kjo kredi është miratuar në muajin shkurt 2011 dhe do të jetë objekt verifikimi i punës tuaj për vitin pasardhës. E gjithë depozita jonë bankare e deklaruar më parë ka shkuar për llogari të blerjes së apartamentit. [...]”.

32.3.3. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 1 të drejtuar nga Komisioni, subjekti rivlerësimit ka deklaruar se: “[...] Pagimi i çmimit për blerjen e apartamentit, në shumën 82.500 euro, është bërë nga ana jonë me kështu. Të ardhurat për blerjen janë siguruar nga ne të dy bashkëshortët në këto mënyra: së pari, të ardhurat e kursyera nga puna e secilit bashkëshort para dhe gjatë martesës ligjore. Këto kursime të përbashkëta të jetës sonë, deri në fund të vitit 2010, kanë qenë të gjitha të depozituara në Raiffeisen Bank, dega Lushnjë, me një kontratë depozite me afat maturimi 1 (një) vjeçar, afat i cili përfundonte në datën 21 dhjetor 2010 [...]”.

32.3.4. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, e pyetur nga Komisioni në lidhje me burimin e të ardhurave për kryerjen e pagesës së kështit të parë prej 25.000 euro në datën 17.12.2010, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “[...] Kjo shumë [...] është parapaguar nga miqtë e familjes sonë F., e S., Q., bashkëshortë ligjorë me njëri-tjetrin [...] Me qëllim që të mos humbisnim përfitimin e interesit vjetor bankar, pasi depozita maturohej më datë 21.12.2010, bashkëshortët Q., shprehën gatishmërinë për të parapaguar në atë moment këtë shumë për llogarinë tonë. Si garanci e dhënë nga ana jonë për këtë veprim të tyre, ne nënshkruam një prokurë noteriale me anë të së cilës zgjodhëm si përfaqësuese tonën znj. S., Q. Ne i dhamë znj. Q., të gjitha të drejtat për të tërhequr depozitën bankare në momentin e maturimit [...]. Ajo gjithashtu kishte të drejtë edhe për ta mbajtur e përdorur gjithë shumën deri në momentin e kthimit tonë nga Italia. Kjo për faktin se, pas nënshkrimit të kontratës paraprake të shitjes, si edhe në momentin që do të maturohej depozita

³⁰ Përkatësisht, në rubrikat “Ndryshimet e interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme” dhe “Të dhëna konfidenciale”.

[...] në datën 21.12.2010 ne ishim larguar në Itali te familjarët dhe jemi kthyer në muajin janar 2011 [...].”

32.3.5. Sipas të dhënave të mandatarkëtimit³¹ të lëshuar nga pala shitëse shoqëria “{***}” ShPK, në datën 17.12.2010, nga z. A., DH., është arkëtuar shuma 25.000 euro, me përshkrimin “*Likuidim pjesor për blerje apartamenti, godina {***}, kati {***}*”. Mandati është nënshkruar nga përfaqësuesi i shoqërisë dhe personi i lidhur, z. A., DH.

32.3.6. Sipas deklaratës së datës 28.04.2015, drejtuar ILDKPKI-së, bashkëshortët F., dhe S., Q., kanë deklaruar, ndër të tjera, se kanë blerë një apartament në {***}, Tiranë, në të njëjtin kat dhe në të njëjtën kohë me bashkëshortët D.-H., miqtë e tyre. Në datën 17.12.2010, kur kanë paguar këstin e parë të tyrin, kanë paguar, gjithashtu, edhe këstin e parë për çiftin DH.-H, *për arsye se këta të fundit kishin një depozitë që maturohej disa ditë më vonë dhe nuk donin të humbnin interesin*. Meqenëse ata janë larguar në Itali, kanë nënshkruar një prokurë noteriale për znj. S., Q., me qëllim që ajo në datën e maturimit, më datë 21.12.2010 të tërhiqte depozitën pranë “Raiffeisen Bank” dhe të merrte shumën e parapaguar prej 25.000 eurosh. Znj. Q., ka deklaruar se bazuar në prokurën e dhënë ka tërhequr gjithë depozitën, të cilën ia ka dorëzuar bashkëshortit të saj, z. F., Q. Z. Q., pasi ka mbajtur shumën prej 25.000 eurosh, pjesën e mbetur e ka përdorur për qëllime të aktivitetit të tij të ligjshëm në fushën e këmbimit valutor, në qytetin e Lushnjës, deri kur bashkëshortët DH.-H., janë kthyer nga Italia dhe kjo shumë i është dorëzuar atyre, pas konvertimit në 20.000 euro.

32.3.7. Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.10.2021, bashkëshortët Q., kanë deklaruar, në mënyrë të përmbledhur, se meqenëse z. A., DH., nuk kishte *cash* me vete, por një depozitë bankare, z. F., Q., ra dakord që nga shuma monetare në euro që dispononte për momentin (ishte i përgatitur për të paguar gjysmën e vlerës së apartamentit), pra, kishte mundësi që jo vetëm të paguante këstin e apartamentit të tij, por të mundësonte pagesën edhe për shumën prej 25.000 eurosh që kërkohej për këstin e parë të shtëpisë së z. A., DH. Znj. S., Q., ka bërë të njëjtat deklarime si në ILDKPKI për veprimet e saj sipas prokurës noteriale.

32.3.8. Në datën 17.12.2010, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, me anë të prokurës së posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., kanë emëruar si përfaqësuese të posaçme znj. S., Q., duke i dhënë të drejtën të paraqitet në “Raiffeisen Bank”, dega Lushnjë, për të tërhequr të gjithë shumën e gjendur në depozitën bankare me nr. llogarie {***}, gjithsej 67.000 dollarë, si dhe të kryejë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore e administrative për lëvrimin e një kredie bankare në emër të z. A., DH., dhe znj. Saemira Hila, pranë bankës.

32.3.9. Referuar të dhënave të sistemit *TIMS*, në datën 19.12.2010, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj janë larguar drejt Italisë dhe janë kthyer në Shqipëri në datën 20.01.2011.

³¹ Mandatarkëtimi është paraqitur nga subjekti pranë ILDKPKI-së në shpjegimet e dhëna me rastin e kontrollit të deklarave të interesave të ushtruar prej këtij institucioni në vitin 2015.

32.3.10. Sipas të dhënave të përcjella në Komision nga “Raiffeisen Bank”³², ka rezultuar se nga llogaria e z. A., DH., është tërhequr shuma prej 67.000 dollarësh nga znj. S., Q., sipas prokurës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2010. Gjendja e llogarisë së depozitës së z. A., DH., në datën 17.12.2010 ka qenë në balancën 67.000 dollarë, depozitë e cila është maturuar në datën 08.12.2010.

32.4. Në analizë të situatës faktike të sipërcituar, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:

(a) më datë 17.12.2010, datë e kryerjes së pagesës prej 25.000 eurosh si këst i parë për blerjen e pasurisë “apartament”, depozita bankare në emër të z. A., DH., në “Raiffeisen Bank” ka pasur balancën 67.000 dollarë, balancë e cila ka ndryshuar duke u zeruar vetëm në datën 21.12.2010, kur shuma është tërhequr nga znj. S., Q., sipas së drejtës që i ishte dhënë asaj nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, me anë të prokurës së posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2010. Në këto kushte, në ndryshim nga sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, fondet e depozitës bankare në “Raiffeisen Bank” nuk kanë shërbyer si burim financimi për kryerjen e pagesës së këstit të parë për blerjen e pasurisë “apartament”, pasi në momentin e kryerjes së kësaj pagese, depozita bankare ishte ende e paprekur;

(b) pretendimi i pagesës së këstit të parë në shumën 25.000 euro prej z. F., Q., përveçse mbeti deklarativ dhe i pambështetur në dokumentacion të kohës është evidentuar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në një fazë të avancuar të procesit të rivlerësimit, vetëm në përgjigje të pyetjeve specifike të drejtëara nga Komisioni, në ballafaqim të faktit se në momentin e kryerjes së pagesës, depozita bankare e pretenduar si burim financimi për këtë pagesë gjendej ende në bankë. Ky fakt i pretenduar nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në asnjë nga deklaratimet periodike të pasurisë, as në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në kontrollin e ushtruar në vitin 2015 [si shpjegime të dhëna afër kohës së kryerjes së pagesave] dhe as në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit;

(c) rrethanat në të cilat, sipas deklaratimit të subjektit të rivlerësimit, u krye pagesa nga z. F., Q., nuk rezultuan të vërteta nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni. Ndërsa subjekti i rivlerësimit pretendonte se depozita bankare në “Raiffeisen Bank” maturohej në datën 21.12.2010 dhe me qëllim që ata të mos humbitnin interesin bankar z. Q., shprehu gatishmërinë për të paguar shumën prej 25.000 eurosh për llogari të tyre, të dhënat e përcjella në Komision nga institucioni bankar provuan të kundërtën. Fondet e depozitës bankare kanë qenë të lira për t’u tërhequr, pasi depozita ishte maturuar që në datën 08.12.2010 dhe z. A., DH., bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka qenë në dijeni të këtij fakti, pasi në datën 15.12.2010 ka tërhequr nga llogaria bankare e depozitës shumën 3.191 dollarë dhe vetëm dy ditë më vonë subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë lidhur kontratën paraprake të shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2010 dhe kanë kryer pagesën në shumën 25.000 euro;

(d) subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore gjatë procesit administrativ, në shpjegimet e dhëna për të justifikuar pse pagesa e këstit të parë të apartamentit është kryer nga z. F., Q., në një kohë që ata edhe pse ishin nisur në mënyrë të posaçme nga Lushnja me qëllimin për të vlerësuar blerjen e mundshme të një apartamenti pikërisht në objektin e ndërtuar nga shoqëria

³² Përcjellë në Komision, me shkresë nr. {***} prot., datë 12.03.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

“{***}” ShPK, nuk kishin marrë para me vete. Arsyeja e “nevojës për të mos prishur interesin bankar” e deklaruar nga bashkëshortët Q., në një deklaratë me shkrim të drejtuar ILDKPKI-së në datën 28.04.2015 dhe nga subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të drejtuar nga Komisioni, ka devijuar në arsyen e “kushtëzimit të pagimit të kështit të parë aty për aty nga shoqëria shitëse e apartamentit” e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, si dhe nga bashkëshortët Q., në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.10.2021 (paraqitur nga subjekti në Komision, bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ). Ajo që konstatohet lehtësisht nga analiza e këtyre kundërshtive është se ato kanë ardhur për shkak të vështirësisë së subjektit të rivlerësimit për t’u përballur e provuar të kundërtën e gjetjeve të Komisionit, të dala nga hetimi administrativ e janë një përpjekje e saj për të prezantuar para organeve të rivlerësimit një situatë që do ta favorizonte, në vijim, përgjatë procedurës së rivlerësimit;

(e) në prokurën e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2010, me anë të së cilës subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë emëruar si përfaqësuese të posaçme znj. S., Q., duke i dhënë të drejtën të paraqitet në “Raiffeisen Bank”, dega Lushnjë, për të tërhequr të gjithë shumën e depozitës bankare me nr. llogarie {***}, gjithsej 67.000 dollarë, pala e përfaqësuar nuk ka dhënë asnjë shpjegim për qëllimin/arsyen e dhënies së tagrave të përfaqësimit znj. S., Q. Gjithashtu, nuk është dhënë asnjë shpjegim nga të përfaqësuarit për dhënien e së drejtës znj. S., Q., për të tërhequr të gjithë vlerën e depozitës bankare, pasi rrethanat e pretenduara prej subjektit të rivlerësimit do të përligjinin tërheqjen nga znj. Q., vetëm të shumës prej 25.000 eurosh, shumë e paguar nga z. F., Q., kundërt shoqërisë “{***}” ShPK për llogari të z. A., DH.

Arsyet të cilat kanë shtyrë subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur për të autorizuar znj. S., Q., për të tërhequr të gjithë vlerën e depozitës e për të lënë kursimet e krijuara përgjatë gjithë viteve të punës së tyre jashtë sigurisë që ofronte institucioni bankar, duken të papërligjura dhe të panevojshme nën dritën e parashikimeve të kontratës paraprake të shitblerjes së pasurisë “apartament”, sipas së cilës kësti i dytë në shumën 57.000 euro do të paguhej nëpërmjet një kredie bankare që pala blerëse do të merrte në “Raiffeisen Bank” dhe po ashtu edhe nga rrjedha e fakteve të provuara gjatë hetimit administrativ, se kësti i dytë në shumën 20.000 euro është paguar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rreth dy muaj më vonë, në datën 11.02.2011. Në asnjë rresht të kësaj prokure, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë tentuar të shpjegojnë marrëdhënien e interesit të krijuar mes tyre dhe z. F., Q., lidhur me pagesën e kështit të parë në shumën 25.000 euro dhe kthimin e kësaj shume nëpërmjet tërheqjes nga znj. Q., të depozitës bankare, marrëdhënie, e cila, sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, përbënte motivin e hartimit të prokurës së posaçme dhe dhënies së tagrave të përfaqësimit znj. Q. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se shuma prej 67.000 dollarësh e tërhequr nga znj. S., Q., mund të jetë përdorur për çdo qëllim tjetër prej çiftit Q., por jo për zëvendësimin/kthimin e shumës/huas së pretenduar të paguar nga z. F., Q., e, më tej, pagesën nga subjekti të kështit të dytë të apartamentit;

(f) fakti i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit se shuma prej 25.000 eurosh, si kësht i parë për blerjen e pasurisë “apartament”, është paguar nga z. F., Q., për llogari të personit të lidhur, z. A., DH., mbetet një fakt i padokumentuar në kohën reale të kryerjes. Në të kundërt të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, i vetmi fakt i dokumentuar është pagesa e shumës prej 25.000 eurosh nga

bashkëshorti i saj, i provuar nga mandatarkëtimi i lëshuar nga pala shitëse shoqëria “{***}” ShPK, në datën 17.12.2010, për pagesën e shumës 25.000 euro, me përshkrimin “*Likuidim pjesor për blerje apartamenti, godina {***}, kati {***}*”, i nënshkruar nga përfaqësuesi i shoqërisë dhe personi i lidhur, z. A., DH.

32.5. Në vlerësimin e trupit gjykues, tërësia e rrethanave faktike të konstatuara e të analizuara si më sipër, e bëjnë të pabesueshëm dhe të paprovuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se pagesa e kështit të parë për blerjen e pasurisë “apartament” është kryer nga z. F., Q., për llogari të personit të lidhur, z. A., DH.

32.6. Trupi gjykues çmon të nënvizojë se dhe në një qasje garantiste, nëse do të pranohej pretendimi se pagesa prej 25.000 eurosh, si kësht i parë për blerjen e pasurisë, është paguar nga z. F., Q., në datën 17.12.2010, subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj shume nga z. Q., pasi marrëdhënia mes z. A., DH., e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortëve Q., do të ishte një marrëdhënie huaje e mirëfilltë, e cila plotëson të gjitha kushtet e një marrëdhënie të tillë, ashtu siç ato janë përshkruar në nenin 1050 të Kodit Civil³³ dhe në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të Komisionit nga subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës mbi mundësinë e z. F., Q., për të paguar me burime të ligjshme shumën 25.000 euro në datën 17.12.2010, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

Z. F., Q., dhe z. T., Q., janë ortakë të shoqërisë “{***}” ShPK, me seli në Lushnjë, me objekt aktiviteti “Shkëmbim valutor, agjenci udhëtimesh, agjenci informacioni, agjenci për transferim parash brenda dhe jashtë vendit”. Shoqëria ka kapital të regjistruar në shumën 2.500.000 lekë³⁴.

Sipas të dhënave të vërtetimit nr. {***} prot., datë 22.10.2021, të lëshuar nga Bashkia Lushnjë, shoqëria “{***}” ShPK ka realizuar aktivitet tregtar me qarkullim në vitet 2008, 2009 dhe 2010 përkatësisht në vlerat 1.320.405 lekë, 1.134.780 lekë dhe 1.219.564 lekë.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion provues nëse shoqëria “{***}” ShPK u ka shpërndarë dividend/fitim vjetor dy aksionerëve/ortakëve të saj.

Edhe nëse, hipotetikisht, në një qëndrim tejet garantist, do të konsiderohej se gjithë vlera e qarkullimit përbënte fitimin e realizuar nga shoqëria në fjalë dhe të shpërndarë dy aksionerëve, fitimi që do t’i përkiste secilit prej tyre do të ishte në vlerën rreth 13.237 euro, shumë kjo që nuk mbulon vlerën 25.000 euro të kështit të parë për blerjen e pasurisë “apartament”, të pretenduar se është paguar nga z. F., Q., për llogari të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj.

Megjithëse nga verifikimi i llogarive bankare të shoqërisë në fjalë në “Credins Bank” dhe në Bankën Kombëtare Tregtare, rezulton se në to janë regjistruar transaksione në shuma të mëdha, duket se ato janë qarkullime/transaksione që në konsideratë të objektit të veprimtarisë së shoqërisë [këmbim valutor] janë kryer për qëllime të kësaj veprimtarie. Referuar parashikimeve të statutit të

³³ Kodi Civil, në nenin 1050 “Kontrata e huasë”, përcakton: “Me kontratën e huas njëra palë (huadhënësi) i jep në pronësi palës tjetër (huamarrësit) një shumë të hollash ose sende që përcaktohen në numër, me peshë ose me masë dhe huamarrësi detyrohet t’i kthejë huadhënësit aq të holla, ose aq sende të atij lloji dhe të asaj cilësie, brenda afatit të caktuar në kontratë ose, kur nuk është caktuar afat, me kërkesën e huadhënësit”.

³⁴ Sipas të dhënave të ekstraktit historik të regjistrimit tregtar për subjektin tregtar me NUIS {***}.

shoqërisë tregtare “{***}” ShPK, i publikuar në internet, në burimet zyrtare të hapura të Qendrës Kombëtare të Biznesit, ortakët e shoqërisë lejohen t’i përdorin këto fonde vetëm në kuadër të veprimtarisë së shoqërisë, përveç rastit kur Asambleja e Ortakëve do të kishte miratuar me vendim dhënien e një huaje ndaj secilit prej tyre. Në mungesë të bilanceve të shoqërisë, nuk mund të verifikohet, nëse shoqëria ka kryer një veprim të tillë financiar, për t’i dhënë akses z. F., Q., në fondet e shoqërisë për nevoja të ndryshme nga ato të aktivitetit tregtar.

32.7. Në përmbledhje, trupi gjykues çmon se me të drejtë Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë pretendimin e saj se pagesa e kështit të parë për blerjen e pasurisë “apartament”, në Tiranë, e kryer më datë 17.12.2010, është financuar nga depozita bankare në “Raiffeisen Bank” dhe as pretendimin se kjo pagesë është kryer nga z. F., Q., për llogari të personit të lidhur.

Për pasojë, në analizën financiare për verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të paguar nga burime të ligjshme financiare shumën prej 25.000 eurosh, në datën 17.12.2010, nuk mund të përfshihet pakësimi i depozitës bankare në “Raiffeisen Bank” dhe as të pasqyrohet ndonjë detyrim ndaj bashkëshortëve Q., në lidhje me kryerjen e kësaj pagese.

32.8. Për sa më lart, sipas analizës financiare të kryer në Kolegj, duke përdorur konkluzionet e përshkruara në drejtim të burimeve të ligjshme të përdorura për financimin e pagesës së kështit të parë të pasurisë “apartament”, në Tiranë, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e një balance negative financiare në drejtim të mbulimit me të ardhura të ligjshme për përballimin e pagesës së këtij kështi, për një vlerë prej (-) 3.225.563 lekësh. Ky rezultat i reduktuar i balancës negative nga ai prej (-) 4.225.563 lekësh në analizën financiare të kryer nga Komisioni në vendim, është afektuar nga qëndrimi i ndryshëm i mbajtur nga trupi gjykues, lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të përdorimit të kursimeve të akumuluar në *cash* për blerjen e pasurive gjatë vitit 2010, qëndrim i cili analizohet në detaje në vijim të këtij vendimi.

33. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se lidhur me pagesën e kështit të parë në shumën 25.000 euro në datën 17.12.2010, për blerjen e pasurisë “apartament banimi, me sipërfaqe 112,1 m²”, ndodhur në {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pagesën e kryer, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- *Lidhur me pagesën e kështit të dytë në shumën 20.000 euro për blerjen e pasurisë “apartament me sipërfaqe 112,1 m²”, në {***}, Tiranë*

34. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim *se lidhur me pagesën e kështit të dytë të pasurisë “apartament”, në Tiranë, Komisioni ka nxituar të dalë në konkluzione pa analizuar me objektivitet, në mënyrë të plotë e gjithëpërfshirëse çdo deklaram të subjektit ndër vite.*

34.1. Komisioni, në vendim³⁵, ka arritur në përfundimin se: “Si konkluzion, në lidhje me pagesën e kështit të dytë në shumën prej 20.000 eurosh në datën 11.2.2011, subjekti ka kryer deklaram të

³⁵ Paragrafi 50.6 i vendimit të Komisionit.

pasaktë në DIPP/2011, në lidhje me burimin “depozitë bankare në Raiffeisen Bank”, për blerjen e apartamentit, pasi nga hetimi rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e një viti më parë gjendje të kësaj depozite të tërhequr në vitin 2010, e cila mund të përbënte burim krijimi për pagesën e këstit të dytë në datën 11.2.2011. Gjithashtu, subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën prej (-) 2.783.173 lekësh, për të justifikuar pagesën e këstit të dytë, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016”.

Komisioni, në vendim³⁶, ka arsyetuar në mënyrë të përmbledhur se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se kësti i dytë është paguar me të ardhurat nga tërheqja e depozitës bankare të deklaruar në vitet 2010 dhe 2011, për sa nuk rezultoi: (i) të ketë deklaruar në deklaratën 2010 në lidhje me gjendjen e mbetur të depozitës pas pagesës së këstit të parë në shumën prej 25.000 eurosh dhe as destinimin e shumës së depozitës në favor të shtetasve Q.; (ii) të ketë deklaruar në deklaratën e interesave të vitit 2011, shlyerjen e këtij kësti me burim nga pakësimi i gjendjes së depozitës deklaruar një vit më parë.

34.2. Nga hetimi administrativ i Komisionit, përveç sa është pasqyruar në paragrafët më sipër në këtë vendim³⁷, trupi gjykues konstatoi, gjithashtu se:

34.2.1. Në deklaratën e interesave të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Depozita bankare në Raiffeisen Bank, dega Lushnje është tërhequr dhe përdorur e gjitha për blerjen e një apartamenti të ndodhur në ZK {***}, nr. pasurie {***}, {***}, Tiranë. [...] Kredi hipotekore e përdorur për blerjen e apartamentit si më sipër me afat 15 vjeçar, disbursuar në datën 09.03.2011. Shuma 5.000.000 lekë.*

34.2.2. Referuar procesverbalit, datë 29.04.2015, të mbajtur para ILDKPKI-së, vënë në dispozicion të Komisionit nga ky institucion, me shkresën nr. {***} prot., datë 18.06.2021, subjekti i rivlerësimit, mbi pyetjen “Nëse likuiditeti i mbetur nga tërheqja e depozitës bankare në shumën 3.941.933 lekë është mbajtur cash, përse nuk është deklaruar?”, ka dhënë shpjegime si vijon: “Likuiditeti nuk është mbajtur cash, por ka shërbyer për likuidimin e një pjese të detyrimit dhe konkretisht 45.000 euro ndaj firmës së ndërtimit”.

34.2.3. Sipas të dhënave të përcjella në Komision nga “Raiffeisen Bank”³⁸, ka rezultuar se në datën 11.02.2011, në llogarinë në euro pranë kësaj banke, subjekti i rivlerësimit ka depozituar shumën prej 20.000 eurosh me përshkrimin “Derdh në llogari të ardhura nga biznesi” dhe më pas kjo shumë është transferuar në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, me përshkrimin “Kalim për blerje apartamenti”.

34.2.4. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, të drejtuar nga Komisioni, lidhur me burimin e financimit për pagesën e shumës prej 20.000 eurosh, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: “Shuma prej 20.000 eurosh është një pjesë e depozitës tonë prej 67.000 dollarësh në Raiffeisen Bank, dega Lushnjë. Sipas kursit të këmbimit valutor të asaj kohe shuma prej 67.000 dollarësh konvertohej në

³⁶ Paragrafët 50.1-50.5 të vendimit të Komisionit.

³⁷ Paragrafi 34 i këtij vendimi.

³⁸ Përcjellë në Komision, me shkresë nr. {***} prot., datë 12.03.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

(pothuajse) 45.000 euro (madje pak më shumë me sa më kujtohet). Nga data e tërheqjes së depozitës prej znj. S. Q., (21.12.2010) e deri në muajin shkurt 2011 (kohë kur shuma 20.000 euro është paguar te shitësi “{***}” ShPK), me marrëveshje reciproke mes nesh e për motive sigurie, kjo shumë i është lënë në ruajtje familjes Q., të cilët ushtronin aktivitet tregtar në këtë fushë, me qëllim që ne të mos e mbanim në shtëpi shumë e eurove. Kjo shumë nuk është derdhur më parë në bankë për llogari të shitësit “{***}” ShPK, pasi ne kishim filluar procedurat dhe ishim duke pritur disbursimin e kredisë bankare, me qëllim për të përmbushur përfundimisht detyrimin e pagimit të çmimit të plotë prej 82.500 euro. Pasi është konvertuar në euro prej familjarëve Q., të cilët ushtronin aktivitet tregtar në këmbimin valutor, në muajin shkurt 2011, ndërkohë që pritej të lëvrohej edhe kredia bankare, kjo shumë prej 20.000 euro është paguar prej meje nëpërmjet bankës te shoqëria për llogari të çmimit total të shitjes së apartamentit prej 82.500 eurosh.”

Bashkëlidhur përgjigjes, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kontratën e huas me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.02.2011, të lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK, në të cilën është përcaktuar se detyrimi i mbetur i papaguar ndaj shoqërisë shitëse është në shumën 37.500 euro, i cili do të paguhet me kredi bankare.

34.3. Në përgjigje të barrës së provës së kaluar nga Komisioni³⁹, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në ankim, duke pretenduar se pagesa e shumës te shoqëria “{***}” ShPK, për blerjen e pasurisë “apartament”, është shtrirë përgjatë viteve 2010 dhe 2011, sikurse është deklaruar dhe në deklaratat periodike të këtyre viteve. Përdorimi i depozitës ka nisur në vitin 2010 dhe ka përfunduar në vitin 2011. Mosdeklarimi shprehimisht i pagesës me dy këste, si edhe shumën e secilit këst, si edhe veprimet me familjen Q., përbëjnë pasaktësi. Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë qëllim për fshehjen e veprimeve më sipër, të cilat janë lehtësisht të verifikueshme nga regjistrat e bankës, janë tërësisht të ligjshme, të moralshme dhe në mirëbesim të plotë mes palëve. Sipas subjektit të rivlerësimit, mosdeklarimi ka ardhur për shkak se “*ipso facto*”, asnjëherë nuk e ka vlerësuar veten të lidhur në marrëdhënie huaje me familjen Q., për sa kohë që ajo dhe bashkëshorti i saj kishin burimet e tyre të ligjshme (depozitën) për pagesën e pjesës kryesore të çmimit të apartamentit në Tiranë. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar gjithashtu se mosdeklarimi i pagesës së këstit të dytë dhe mosdeklarimi i pjesës së mbetur të depozitës në *cash* ka ardhur edhe për faktin se kësti ishte paguar në shkurt përpara datës së plotësimit e dorëzimit të deklaratës së interesave të vitit 2010, në mars të vitit 2011. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar edhe mënyrën e ndërtimit të analizës financiare, duke pretenduar se Komisioni është shfaqur kontradiktor, pasi në rezultatet e hetimit administrativ nga njëra anë nxjerr balancë negative nga analiza financiare e datës 11.02.2011 dhe nga ana tjetër në analizën financiare për vitin 2010,

³⁹ Subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit për sa rezultoi se: (i) subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e vitit 2011 pagesën e këstit të dytë në shumën prej 20.000 eurosh ndaj shoqërisë shitëse; (ii) nga verifikimi i deklaratës 2010, konstatohet se subjekti dhe personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar gjendje *cash* nga depozita e tërhequr nga “Raiffeisen Bank” deri në datën 31.12.2010 dhe as të dhëna në lidhje me administrimin e depozitës nga familja Q., sikurse pretendohet nga subjekti dhe, për rrjedhojë, nuk provohet se pagesa e këstit të dytë në shumën prej 20.000 eurosh në vitin 2011 të jetë kryer me burim nga depozita në “Raiffeisen Bank”; (iii) nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e këstit të dytë në datën 11.02.2011, duke rezultuar me balancë negative në shumën prej (-) 2.767.827 lekësh.

nxjerr balancë pozitive (+) 3.006.522 lekë, pa përfshirë këtu edhe pakësimin e gjendjes *cash* prej 1.000.000 lekësh për blerjen e një automjeti, ndërkohë që ndryshe ka arsyetuar në vendimin përfundimtar.

34.4. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër, si dhe në vijim të arsyetimit e konkluzionit të arritur lidhur me pagesën e kështit të parë për blerjen e pasurisë objekt kontrolli, trupi gjykues mori në analizë, në mënyrë integrale e në harmoni me njëra-tjetrën, rrethanat si më poshtë.

(i) Pagesa e kështit të dytë në shumën 20.000 euro nuk rezulton e deklaruar në asnjë nga deklaratat e interesave private të subjektit të rivlerësimit, në vitet 2010 dhe 2011. Mënyra e deklarimit të blerjes së pasurisë “apartament” nga subjekti i rivlerësimit në të dy këto deklarata se si burim krijimi për këtë pasuri ka shërbyer tërheqja e të gjithë depozitës bankare, ka shmangur nga deklarimi pasqyrimin e saktë të situatës reale të kryerjes së pagesave në këste, por sidomos faktin e tërheqjes së të gjithë vlerës së depozitës nga znj. Q., në vitin 2010;

(ii) Mbështetur në parashikimet e nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, subjekti i rivlerësimit, referuar pretendimeve dhe shpjegimeve të dhëna prej saj, kishte detyrimin për të deklaruar që në deklaratën e interesave të vitit 2010 gjendjen e mbetur të depozitës bankare si gjendje në *cash*, pas pagesës së kështit të parë në shumën prej 25.000 eurosh, si dhe lënien e kësaj shume, në ruajtje bashkëshortëve Q., detyrim ky i papërmbyshur jo vetëm në këtë deklaratë, por as në atë të vitit 2011, në të cilën subjekti i rivlerësimit do të duhej të deklaronte pagesën e kështit të dytë në shumën 20.000 euro, si dhe vijueshmërinë e marrëdhënies së pretenduar me bashkëshortët Q., për kthimin e pjesës së mbetur nga tërheqja e depozitës bankare në “Raiffeisen Bank”;

(iii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me asnjë dokument të kohës, kthimin e shumës prej 20.000 eurosh nga bashkëshortët Q. Në prokurën e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2010, me anë të së cilës subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë emëruar si përfaqësuese të posaçme znj. S., Q., duke i dhënë të drejtën të paraqitet në “Raiffeisen Bank”, dega Lushnjë, për të tërhequr të gjithë shumën e depozitës bankare me nr. llogarie {***}, gjithsej 67.000 dollarë, nuk është përcaktuar afat/koha për kthimin e kësaj shume, qoftë edhe në versionin e pretenduar, por të paprovuar nga subjekti për kthimin e pjesës prej 20.000 eurosh të të përfaqësuarit pas mbajtjes së shumës prej 25.000 eurosh, për shkak të pagesës së kështit të parë nga z. F., Q., për llogari të z. A., DH. Mungesa e dokumentacionit ligjor apo financiar të kohës, lidhur me kthimin e shumës prej 20.000 eurosh nga bashkëshortët Q., si dhe mungesa e gjurmëve në deklarimet periodike të marrëdhënies së interesit mes subjektit të rivlerësimit e personit të lidhur me bashkëshortët Q., bën që pretendimet e subjektit të rivlerësimit se kështi i dytë në shumën 20.000 euro është paguar nga pjesa e mbetur e depozitës bankare të mbeten deklarative e të paprovuara me dokumentacion;

(iv) Në drejtim të kundërt të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit shkon dhe fakti i provuar nga dokumentacioni bankar se në përshkrimin e depozitimit në *cash* të shumës 20.000 euro në datën 11.02.2011, në “Raiffeisen Bank”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të kësaj shume “të ardhurat nga biznesi”, një përshkrim ky që nuk përputhet me deklarimet e saj se deri në

momentin e pagimit të këtij kësti, depozita bankare, e cila përbënte kursimet e punës së dy bashkëshortëve, ka përbërë burimin bazë të financimit të pasurisë “apartament”.

34.5. Në përfundim të këtij arsyetimi, i cili vjen si rrjedhë logjike e arsyetimit dhe analizës së bërë për verifikimin e burimeve financiare të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për pagesën e këstit të parë të blerjes së pasurisë “apartament”, në Tiranë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dështoi të provonte se si burim për financimin e pagesës së këstit të dytë për blerjen e pasurisë objekt kontrolli ka shërbyer depozita bankare e tërhequr nga “Raiffeisen Bank”. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të drejtë analizën financiare të kryer nga Komisioni, me qëllim verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të paguar me burime të ligjshme financiare shumën prej 20.000 eurosh, në datën 11.02.2011, si këst i dytë për blerjen e pasurisë “apartament”, në Tiranë, balancën negative të rezultuar në vlerën (-) 2.783.173 lekë.

34.6. Trupi gjykues mori në shqyrtim edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me mënyrën e ndërtimit të analizës financiare, duke argumentuar se Komisioni është shfaqur kontradiktor, pasi në rezultatet e hetimit administrativ nga njëra anë nxjerr balancë negative nga analiza financiare e datës 11.02.2011 dhe nga ana tjetër në analizën financiare për vitin 2010, nxjerr balancë pozitive (+) 3.006.522 lekë, pa përfshirë këtu edhe pakësimin e gjendjes *cash* prej 1.000.000 lekësh për blerjen e automjetit, ndërkohë që ndryshe ka arsyetuar në vendimin përfundimtar.

Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vëren se balanca pozitive e rezultuar në paraqitjen tabelare të analizës financiare për vitin 2010, është afektuar nga konsiderimi nga Komisioni i shumës 67.000 dollarë të përfituar nga tërheqja e depozitës në “Raiffeisen Bank”, si burim financimi për pagesën e këstit të parë prej 25.000 eurosh, edhe pse në të kundërt ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka përdorur këtë depozitë bankare për të kryer pagesën në fjalë, pasi data 21.12.2010 e tërheqjes së saj nga znj. S., Q., rezulton të jetë e mëvonshme se data 17.12.2010 e kryerjes së pagesës së këstit prej 25.000 eurosh. Trupi gjykues çmon se, për të siguruar një qasje realiste, shuma prej 67.000 dollarësh, duhet të pasqyrohet nga Komisioni, në analizën financiare të vitit 2010, si një shumë që nuk disponohej nga subjekti i rivlerësimit, në fund të vitit 2010, një konsiderim që do të prodhonte një situatë negative financiare në përputhje me rezultatin negativ të arritur në analizën financiare për verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për të paguar me burime të ligjshme financiare këstin e parë të pasurisë “apartament” në datën 17.12.2010. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues, në zbatim të parimit të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit, vlerëson të konsiderojë analizën e kryer nga Komisioni për vitin 2010, nga e cila ka rezultuar një bilanc pozitiv për këtë vit. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, lidhur me gjendjen e kursimeve në *cash* dhe si ka afektuar përlllogaritja e tyre analizën financiare të vitit 2010, merr përgjigje në qëndrimin e trupit gjykues të trajtuar në vijim në këtë vendim.

35. Sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se për pagesën e këstit të dytë në shumën prej 20.000 eurosh në datën 11.02.2011, për blerjen e pasurisë objekt kontrolli, subjekti i rivlerësimit gjendet në

kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme financiare prej (-) 2.783.173 lekësh, për të justifikuar pagesën e kryer, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

36. Në përmbledhje të arsytimit si më lart, në funksion të dhënies përgjigje të pretendimeve të parashtruara në ankim, duke analizuar faktin e mungesës së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar pagesën e kështit të parë në shumën 25.000 euro dhe pagesën e kështit të dytë në shumën 20.000 euro, trupi gjykues arriti në konkluzionin se për pasurinë “apartament me sipërfaqe 112,1 m²”, në {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

○ *Për pasurinë “autoveturë, tip Daimler Chrysler ML 270”*

37. Komisioni, në vendim⁴⁰, në lidhje me këtë pasuri, ka arritur në përfundimin se: “[...] subjekti nuk ka kryer deklarimin e kësaj pasurie në deklaratën e interesave periodike private të vitit 2010 në përputhje me ligjin nr. 9049/2003, si dhe ka rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën prej 1.233.279 lekësh për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie në datën 05.07.2010, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” të ligjit nr. 84/2016”.

Konkluzionin e mësipërm, Komisioni e ka mbështetur në arsytimin⁴¹ si vijon: “Trupi gjykues, pas administrimit të shpjegimeve të subjektit mbi rezultatet e hetimit, vlerëson se ato nuk janë bindëse dhe se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e tyre. Subjekti nuk shpjegoi arsyet mbi mosdeklarimin e blerjes së automjetit në deklaratën e interesave të vitit 2010. Interpretimi i subjektit mbi deklaratimet në deklaratën e interesave të vitit 2012 dhe Vetting për sa i përket burimit që ka shërbyer për blerjen e pasurisë automjet, nuk është i bazuar, për sa automjeti është blerë në vitin 2010 dhe subjekti nuk e ka deklaruar në këtë deklaratë shtimin e kësaj pasurie. Për rrjedhojë, burimet e pretenduara nga subjekti të përdorura për blerjen e automjetit nuk duhet të konsiderohen në analizën financiare. [...] Nga analiza e fakteve të rezultuara nga hetimi dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e konstatimeve të Komisionit. Në analizën përfundimtare për blerjen e automjetit, janë rivlerësuar shpenzimet jetike, duke përfshirë në këtë zë edhe shpenzimet për babain e subjektit, bazuar në deklarimin e subjektit se babai ka jetuar me të deri para se të ndërronte jetë dhe, për rrjedhojë, rezultati financiar nga shuma (-) 1.164.969 lekë arrin në shumën (-) 1.233.279 lekë”.

37.1. Subjekti i rivlerësimit në kundërshtim të konkluzionit dhe arsytimit të mësipërm të Komisionit ka pretenduar në ankim se në analizën financiare për pasurinë “autoveturë, tip Daimler Chrysler ML 270”, Komisioni duhet të përfshinte pakësimin e likuiditeteve në cash dhe të të ardhurave të tjera nga depozita në “Raiffeisen Bank”.

⁴⁰ Paragrafi 57.3 i vendimit të Komisionit.

⁴¹ Paragrafët 57-57.2 të vendimit të Komisionit.

Në mbështetje të këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ në Komision⁴², duke argumentuar se pasuria “autoveturë, tip Daimler Chrysler ML 270” (në vijim “pasuria autoveturë”) është blerë në muajt qershor-korrik 2010 në {***}, Itali, për çmimin prej 9.000 eurosh. Mosdeklarimi i kësaj pasurie në vitin 2010 është korrigjuar me iniciativë prej saj në deklaratën e vitit 2012, kohë kur mjeti u zhdoganua dhe u regjistrua në territorin shqiptar. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se pavarësisht pasaktësive në deklaratimet e interesave private për vitet 2010 dhe 2012, ajo ka deklaruar saktësisht pasurinë në ILDKPKI në vitin 2015, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, si dhe gjatë hetimit administrativ në Komision. Ajo ka deklaruar saktësisht se transferta bankare nga “Raiffeisen Bank”, dega Lushnjë, në muajin qershor 2010, në shumën prej 7.400 eurosh nga z. A., DH., në emër të vëllait të tij A., DH., ka qenë pikërisht për blerjen e pasurisë “autoveturë”. Subjekti ka shpjeguar se shuma prej 7.400 eurosh ka qenë pikërisht nga gjendja e kursimeve në *cash* prej 1.000.000 lekësh e disponuar nga një vit më parë. Shtimi i gjendjes në *cash*, të deklaruar në vitin 2009 nga shitja e automjetit të mëparshëm, është përdorur për blerjen e pasurisë “autoveturë”. Në deklaratën e interesave private të vitit 2012 ka deklaruar kursimet e viteve të mëparshme si burim krijimi për këtë pasuri, ndërsa në deklaratën e rivlerësimit ka shtuar si burim financimi edhe fitimin e realizuar nga shitja e automjetit të parë, në shumën 500.000 lekë. Sipas subjektit të rivlerësimit, pavarësisht se duket sikur janë përdorur dy burime të ndryshme financiare për blerjen e pasurisë “autoveturë”, në fakt është i njëjti burim, pasi të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz 250” kanë shtuar gjendjen e kursimeve në *cash* në fund të vitit 2009, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi për blerjen e pasurisë “autoveturë”, në vitin 2010. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni duhet të përfshinte në analizën financiare, pakësimin e gjendjes *cash* në shumën 1.000.000 lekë ose rreth 7.400 euro dhe të ardhurat e tjera në shumën 1.600 euro të mbetura nga tërheqja e depozitës bankare (në shumën 67.000 dollarë).

37.2. Nga analizimi i akteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi situatën faktike si vijon.

37.2.1. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar: “Autoveturë, marka “Mercedes-Benz, Daimler Chrysler, ML 270”, viti i prodhimit 2003, me targa italiane në momentin e blerjes {***}, me targa shqiptare {***}, në bashkëpronësi me bashkëshortin A., DH., blerë nga bashkëshorti në Itali, me kursimet tona të viteve të mëparshme, si edhe nga fitimi i realizuar nga shitja në shumën 500.000 lekë e automjetit të parë me targa {***}. Vlera: 9.000 euro”.

Në deklaratën e interesave private të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Autoveturë, marka “Mercedes-Benz, Daimler Chrysler, ML 270”, viti i prodhimit 2003, me targa {***}, në bashkëpronësi me bashkëshortin A., DH. Blerë nga bashkëshorti në Itali, me kursimet tona të viteve të mëparshme. Vlera: 10.500 euro. Leje qarkullimi lëshuar nga DPShTRr, datë 02.04.2012”.

⁴² Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1 (standard) të drejtuar nga Komisioni dhe në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ.

37.2.2. Nga të dhënat e përcjella në Komision nga “Raiffeisen Bank”⁴³, rezulton se në datën 24.06.2010, bashkëshorti i subjektit ka transferuar nëpërmjet llogarisë së tij bankare në favor të z. A., DH., shumën prej 7.400 eurosh.

37.2.3. Referuar të dhënave të përcjella në Komision nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor⁴⁴, autovetura e markës “Daimler Chrysler, tip ML 270 CDI”, është blerë më datë 05.07.2010, nga z. A., DH., dhe z. A., DH., në Itali, në çmimin 9.000 euro. Më datë 11.07.2010 automjeti është transferuar në Shqipëri nga z. A., DH. Më tej, në datën 22.02.2012, është bërë zhdoganimi i mjetit nga z. A., DH., dhe është paguar prej tij detyrimi doganor në shumën 194.507 lekë.

37.2.4. Në datën 02.04.2012, është lëshuar certifikata e pronësisë së mjetit, në emër të z. A., DH., dhe znj. Saemira Hila.

37.3. Në analizë të rrethanave të konstatuara si më sipër, në raport me arsyetimin e Komisionit në vendim dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën periodike të vitit 2010 nuk ka deklaruar blerjen e pasurisë “autoveturë”, duke e konsideruar këtë fakt, në ankim, si pasaktësi në deklaram, e korrigjuar në deklaramin e vitit 2012, kur ajo ka deklaruar pasurinë për shkak të zhdoganimit dhe regjistrimit të saj në territorin shqiptar, në këtë vit. Trupi gjykues vlerësoi se, duke mos deklaruar blerjen e pasurisë “autoveturë” në deklaratën e interesave private të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, sipas së cilit subjekti i rivlerësimit duhej të deklaronte pranë organit kompetent, ndër të tjera, pasuritë e luajtshme të regjistrueshme në regjistrat publikë. Formulari i deklarimit të interesave private, në rubrikën “Ndryshimet i interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, përcaktonte qartë detyrimin për deklaram të çdo lloj pasurie të zotëruar nga zyrtari deklarues, të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit, duke i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit ta plotësonte saktësisht atë.

Trupi gjykues vëren, gjithashtu, se nga hetimi administrativ i Komisionit rezultoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se autoveturën e ka deklaruar në vitin 2012, për shkak të regjistrimit në këtë vit në territorin shqiptar, është i mbështetur në prova, sipas të dhënave të lejes së qarkullimit të automjetit, lëshuar fillimisht në emër të personit të lidhur në datën 21.03.2012 e, më pas, në datën 02.04.2012, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur.

37.4. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues çmoi se deklaratat e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë në ILDKPKI, në kuadër të ligjit nr. 9049/2003, mund të përdoren si provë në procesin e rivlerësimit. Këtë cilësim ua njeh vetë ligji i posaçëm nr. 84/2016, në nenin 32, pika 5 e tij, për të provuar nëpërmjet tyre, deklarimet e bëra në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, duke ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me

⁴³ Informacion i përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 12.03.2020.

⁴⁴ Informacion i përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 01.04.2020.

pasuritë e deklaruar. Në këtë kuptim, deklarimi i blerjes së pasurisë “autoveturë” nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2012, duhet lexuar e kuptuar si korrigjim i pasaktësisë së mosdeklarimit të kësaj pasurie në deklaratën e interesave private të vitit 2010. Trupi gjykues çmoi se situata e mosdeklarimit të blerjes së pasurisë në vitin 2010, jo vetëm nuk e ngarkon me përgjegjësi të drejtpërdrejtë subjektin e rivlerësimit në drejtim të vendosjes së masës disiplinore në ngarkim të tij, por as nuk mund të afektojë procesin e kontrollit të verifikimit të vërtetësisë së deklarimeve në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit lidhur me burimin e krijimit të pasurisë objekt kontrolli, në kushtet kur në zbatim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, konkretisht parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31 të ligjit nr. 84/2016, për efekt të procesit të rivlerësimit, objekt i kontrollit janë pasuritë për të cilat subjekti mbarte detyrimin për t’i deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe që janë relevante në këtë proces dhe kontrolli fillon nga verifikimi i deklarimeve të subjektit në të, një qëndrim tashmë i konsoliduar ky në jurisprudencën e Kolegjit⁴⁵. Në këtë kuptim, e në kushtet kur: (a) në deklaratat periodike të interesave gjenden të deklaruar të dhënat e blerjes së pasurisë “autoveturë”, të cilat përputhen me ato të deklaruar në deklaratën e rivlerësimit⁴⁶; si dhe (b) Komisioni nuk ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit qëllimisht nuk ka deklaruar blerjen e kësaj pasurie në deklaratën e interesave private të vitit 2010, çka do të përbënte rrethanë që duhej vlerësuar e analizuar në mënyrë të posaçme; trupi gjykues vlerësoi se Komisioni nuk gjendej në kushtet e pamundësisë për të arritur në një konkluzion mbi burimet financiare të krijimit të pasurisë objekt kontrolli, të cilat në vlerësim të trupit gjykues duhet të verifikoheshin nga Komisioni, sipas deklarimit të subjektit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

37.5. Në vijim të këtij arsytimi, trupi gjykues verifikoi burimet e krijimit të pasurisë “autoveturë”, të cilat, sipas deklarimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, janë: *kursimet e viteve të mëparshme, si edhe fitimi i realizuar nga shitja në shumën 500.000 lekë e automjetit të parë me targa {***}*, duke e ballafaquar këtë deklaram me atë të bërë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike të interesave private.

Trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në *cash*, për herë të parë në deklaratën periodike të interesave të vitit 2009, në rubrikën “Ndryshimet e interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, në të cilën ka deklaruar: *Kursime në formën e shumës cash, të cilat i kemi në shtëpi dhe i përdorim për nevoja familjare. Vlera: 500.000 lekë*.

Në të njëjtën rubrikë të kësaj deklarate, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “[...] 2. Të ardhura të përfituara nga shitja e automjetit të regjistruar në bashkëpronësinë time dhe të bashkëshortit, tip Mercedes-Benz [...]. Vlera: 500.000 lekë”.

Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë lidhur kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.09.2009, për shitjen e automjetit me targa {***} tip “Mercedes-Benz”, palës blerëse, në çmimin 500.000 lekë, i cili ishte shlyer totalisht nga blerësi⁴⁷.

⁴⁵ Vendimi nr. 33/2021 (JR), datë 03.11.2021; vendimi nr. 2/2022, datë 15.02.2022; vendimi nr. 6, datë 22.02.2023, etj.

⁴⁶ Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar vlerën 10.500 euro si vlerë të blerjes së pasurisë “autoveturë”, duke përfshirë në të edhe shumën e paguar për zhdoganimin e mjetit, në vlerën 194.507 lekë, në datën 22.02.2012.

⁴⁷ Referuar kontratës së shitblerjes së sipërcituar përcjellë në Komision, si pjesë e informacionit të përcjellë nga DPShTRr me shkresën nr. {***} prot., datë 01.04.2020.

37.6. Në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz 250” kanë shtuar gjendjen e kursimeve në *cash* në fund të vitit 2009, në shumën 1.000.000 lekë, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi për blerjen e pasurisë “autoveturë”, në vitin 2010, është një pretendim që nuk gjen mbështetje në përmbajtjen e deklaratës së interesave private të vitit 2009, në të cilën subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kursimet në *cash* në banesë, gjendje në datën 31.12.2009, janë në shumën 500.000 lekë. Në deklaratën e interesave private në fjalë, në zbatim të nenit 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049, nën përgjegjësi, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlerën e likuiditeteve, shtesat e gjendjes në *cash*, në lekë ose në valutë të huaj, më 31 dhjetor të vitit të deklarimit në raport me vitin pararendës. Kjo dispozitë dhe formulari në zbatim të saj, duke përcaktuar qartë detyrimin për të deklaruar gjendjen e likuiditeteve, e bën të pabesueshëm pretendimin e subjektit të rivlerësimit se gjendja e kursimeve në *cash* nuk ka qenë në shumën e deklaruar prej 500.000 lekësh, por në shumën prej 1.000.000 lekësh.

Trupi gjykues sjell në vëmendje se deklarata periodike e interesave e vitit 2009 është i vetmi dokument nga i cili merren të dhëna lidhur me ndryshimet e gjendjes së kursimeve në *cash* të subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se kursimet në *cash* në banesë në fund të vitit 2009 ishin në shumën 1.000.000 lekë rezulton i paprovuar me dokumentacion. Për rrjedhojë, shuma prej 500.000 lekësh do të duhet të konsiderohet si vlera e kursimeve në *cash* në vitin 2009, e përdorur për blerjen e pasurisë “autoveturë”, që duhet të përfshihet në analizën financiare të kryer nga Komisioni për kontrollin e burimeve të ligjshme të përdorura për krijimin e kësaj pasurie.

37.7. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se si burim financiar për blerjen e kësaj pasurie kanë shërbyer edhe të ardhurat e tjera në shumën 1.600 euro të mbetura nga tërheqja e depozitës bankare (në shumën 67.000 dollarë) në “Raiffeisen Bank”, trupi gjykues vëren se ky pretendim është paraqitur për herë të parë në ankim, pa u parashtruar prej saj në asnjë fazë të procesit të rivlerësimit në Komision. Për pasojë, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim i sipërcituar i subjektit të rivlerësimit duhet trajtuar si i rënë në dekadencë në kuptim të nenit 459, pika 2 e Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se: “Në ankim nuk mund të parashtrohen kërtime të reja që nuk janë parashtruar në gjykimin në shkallë të parë”. Pavarësisht këtij argumenti formal të mospranueshmërisë së këtij pretendimi për shqyrtim, trupi gjykues konstatoi se ky pretendim nuk gjendet i mbështetur në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e interesave të vitit 2010, të cilat janë si vijon: *Depozita bankare (USD) në Raiffeisen Bank, dega Lushnjë, është tërhequr për t’u përdorur për blerjen e një apartamenti të ndodhur në ZK {***}, nr. pasurie {***}*. [...] *E gjithë depozita jonë bankare e deklaruar më parë ka shkuar për llogari të blerjes së apartamentit. [...]*. Për rrjedhojë, pretendimet e reja të subjektit të rivlerësimit në ankim, për përdorim kursimesh të paspecifikuara më parë, përbëjnë një përpjekje për ta paraqitur situatën në një dritë të favorshme, që nuk përputhet me deklaratimet e saj në deklaratat e interesave private, të cilat përbëjnë provë në këtë proces, në përputhje me parashikimin e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

37.8. Duke përdorur arsyetimin e bërë më sipër, në lidhje me burimet e deklaruara për blerjen e pasurisë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, nga korrektimi i analizës financiare të kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kishin pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për financimin e blerjes së pasurisë “autoveturë, tip Daimler Chrysler ML 270”, në vitin 2010, në shumën (-) 733.279 lekë.

38. Për pasojë, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme financiare, për blerjen e pasurisë “autoveturë, tip Daimler Chrysler ML 270”, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

◦ *Për analizën financiare 2003-2016*

39. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me anë të të cilave ajo ka kundërshtuar rezultatet e analizës financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2003-2016.

39.1. Në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, nga analiza ekonomike e kryer, është konkluduar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të konstatuara për vitet 2005, 2011, 2012 dhe 2014, të cilat paraqiten me balancë negative të fondeve (ku përfshihet edhe analiza e kryer për vitet në të cilat është analizuar më vete krijimi i aseteve në momentin e kryerjes së pagesave) dhe konkretisht: për vitin 2005, balanca negative e fondeve (-) 1.392.870 lekë; për vitin 2011, balanca negative e fondeve (-) 4.000.811 lekë; për vitin 2012, balanca negative e fondeve (-) 351.943 lekë; si dhe për vitin 2014, balanca negative e fondeve (-) 175.865 lekë, me total pamjaftueshmërie prej (-) 5.921.489 lekësh, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

39.2. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar analizën financiare të kryer nga Komisioni si të pasaktë, duke pretenduar se situata financiare e paraqitur nga ky i fundit nuk i përgjigjet realitetit, pasi nuk janë përlllogaritur saktë të ardhurat e personit të lidhur përpara martesës me subjektin e rivlerësimit, të cilat janë deklaruar e vërtetuar me prova shkresore; nuk janë përlllogaritur saktë shpenzimet e jetesës; nuk janë përlllogaritur saktë kursimet në *cash* të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe mundësia për të dhënë huan kunatit të saj; nuk janë përlllogaritur saktë shpenzimet e mobilimit; si dhe nuk janë përfshirë të ardhurat e lëna nga trashëgimia e babait të saj. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një analizë financiare për periudhën 2003-2016, duke reflektuar të gjitha pretendimet e saj, sipas së cilës ajo dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara, si vijon: për vitin 2011, në shumën (-) 114.937 lekë; për vitin 2012, në shumën (-) 351.943 lekë; për vitin 2014, në shumën (-) 75.865 lekë, me total pamjaftueshmërie prej (-) 542.745 lekësh.

Sipas subjektit të rivlerësimit, balancat negative në vitet e sipërcituara janë diferenca të cilat personi i lidhur i ka mbuluar nga gjendjet e tij në *cash* nga aktiviteti privat, për të cilat nuk mund të paraqesë dhe analizojë për çdo vit veprimet financiare, për shkak edhe të mungesës së bilancit

dhe deklarimit të gjendjes në *cash*, në varësi nga momenti kohor i pagesës së detyrimeve tatimore ose furnitorëve. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se kjo diferencë negative duhet të vlerësohej edhe nën dritën e parimit të proporcionalitetit, ashtu siç Komisioni ka konsoliduar qëndrimin e tij në disa vendimmarrje lidhur me vlerat e vogla negative të konstatuara nga analizat financiare. Për rrjedhojë, në vlerësim të subjektit të rivlerësimit, ajo ka mundur të provojë në mënyrë bindëse, krijimin e pasurive me burime të ligjshme dhe, për këtë arsye, ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e pasurisë.

40. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me të cilat ka kundërshtuar mënyrën e përlllogaritjes nga Komisioni të shpenzimeve të jetesës për periudhën 2005-2012, duke pretenduar se shpenzimet e jetesës së babait të saj ndjerë, duhet të llogariteshin më vete, të shkëputura nga ato të familjes së saj, pasi pavarësisht se ata jetonin në të njëjtën banesë dhe subjekti i rivlerësimit kujdesej për të, babai i saj i ndjerë ka pasur ekonomi familjare të ndarë nga ekonomia e familjes së subjektit të rivlerësimit, siç vërtetohet edhe nga certifikatat e gjendjes civile, në të cilat subjekti i rivlerësimit dhe babai i saj paraqiten me përbërje familjare të ndara. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar, gjithashtu, se shpenzimet e jetesës së babait të saj pensionist nuk duhet të ishin llogaritur nga Komisioni me të njëjtën metodologji të përlllogaritjes së shpenzimeve për familjen e saj.

40.1. Nga verifikimi i analizës financiare 2003-2016 të pasqyruar në vendim, trupi gjykues vëren se në vitet 2005-2011, shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur nga Komisioni duke përfshirë edhe babain e subjektit të rivlerësimit. Këtë mënyrë përlllogaritjeje të shpenzimeve të jetesës, Komisioni e ka mbështetur në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit administrativ, në të cilat ajo ka pohuar se: *Duke qenë se unë kam qenë fëmijë i vetëm, është e qartë se e gjithë përgjegjësia për kujdesen ndaj babait dhe përballimin e shpenzimeve për të do të ishte në ngarkimin tim. Sikurse e kam deklaruar edhe gjatë hetimit unë kam jetuar së bashku me babain tim prej vitit 2005 deri në vitin 2012.*

Komisioni, në vendim, duke konsideruar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se ka bashkëjetuar me babain e saj dhe i ka mbuluar atij shpenzimet jetike, ka arritur në përfundimin se babai i saj ka pasur mundësi që me të ardhurat nga pensioni i tij të krijonte depozitën bankare në shumën 619.265 lekë trashëguar subjektit të rivlerësimit, si kursimet e pretenduara në *cash* në shumën 900.000 lekë, të cilat kanë shërbyer si burim financiar krijimi për depozitat në emër të vajzave të subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”, në vitin 2012.

40.2. Trupi gjykues konstatoi fillimisht se, nëse nga Komisioni do të konsiderohej se shpenzimet e jetesës së babait të subjektit të rivlerësimit nuk do të ishin përballuar nga kjo e fundit, atëherë ai nuk do të kishte mundësi, nga të ardhurat nga pensioni i pleqërisë, përgjatë periudhës 2005-2011, në shumën 1.076.332 lekë, të krijonte kursimet e pretenduara.

40.3. Trupi gjykues konsideroi jobindëse argumentet e subjektit të rivlerësimit, në ankim, pasi: *Së pari*: vëren në to mungesë koherence: nga njëra anë subjekti i rivlerësimit pranon se babai i saj ka jetuar me familjen e saj, edhe pse ata figurojnë me përbërje familjare të ndarë nga aktet e

gjendjes civile dhe, nga ana tjetër, mbështetur në të njëjtin fakt, pretendon se ata kanë pasur ekonomi të ndara referuar shpenzimeve të jetesës.

Së dyti: vëren se ato janë kontradiktore me shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit administrativ, në të cilat ka pranuar qartësisht se gjithë përgjegjësia për kujdesen ndaj babait dhe përballimin e shpenzimeve për të do të ishte në ngarkimin të saj.

40.3.1. Sa i përket pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit, se shpenzimet e jetesës së babait të saj pensionist nuk duhet përlllogariteshin me të njëjtën metodologji të përlllogaritjes së shpenzimeve për familjen e saj, trupi gjykues vëren se këto shpenzime janë përlllogaritur prej Komisionit sipas standardit të ILDKPKI-së, bazuar në INSTAT. Trupi gjykues e gjen të drejtë këtë mënyrë përlllogaritjeje të shpenzimeve të jetesës për babain e subjektit të rivlerësimit, në mbështetje të jurisprudencës tashmë të konsoliduar të Kolegjit, sipas së cilës, shpenzimet e jetesës, sipas standardit të ILDKPKI-së dhe INSTAT-it, kanë për qëllim të standardizojnë dhe unifikojnë këto shpenzime për të gjithë shtetasit shqiptarë. Këto shpenzime janë mesatare dhe përfshijnë të gjitha shtresat e popullsisë dhe zonat e Shqipërisë, çka do të thotë se ato nuk mund të përfaqësojnë shpenzimet reale të çdo individi dhe familjeje. Në këtë kuptim, ato përbëjnë një vlerë mesatare që përfaqëson një jetesë normale të një njësie familjare dhe jo shpenzime që realisht janë kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij.

40.4. Për pasojë, llogaritja e shpenzimeve të jetesës për babain e subjektit të rivlerësimit, duke i përfshirë ato në shpenzimet e jetesës së familjes së subjektit të rivlerësimit në analizën financiare të Komisionit për periudhën 2005-2011, u vlerësua nga trupi gjykues si një përlllogaritje e drejtë dhe objektive, në përputhje me përmbajtjen e deklarimeve të vetë subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision.

- 41.** Në analizë të shkakut të ankimit, trupi gjykues vëren se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për sa i përket analizës financiare të vitit 2005, lidhur me shumën e kthyer personit të lidhur nga vëllezërit e tij në shumën 20.000 euro si kthim shumash të dhëna në përdorim dhe 1.000.000 lekë nga shitja e pasurisë “apartament”, në {***}, Lushnjë (të cilat kanë financuar investimin e personit të lidhur në bono thesari në Bankën e Shqipërisë e, më tej, depozitën bankare në “Raiffeisen Bank), janë trajtuar në detaje më sipër në këtë vendim, nga ka rezultuar se ato janë pretendime të drejta e, për pasojë, nga reflektimi i këtij qëndrimi në analizën financiare të kryer nga Komisioni, balanca negative për vitin 2005 nga vlera (-) 1.392.870, që ishte në analizën e Komisionit, u kthye në bilanc pozitiv në vlerën (+) 1.481.190 lekë.
- 42.** Në drejtim të analizës financiare për vitet 2011, 2012 dhe 2013, trupi gjykues shqyrtoi pretendimet e subjekti të rivlerësimit, me të cilat ajo kundërshton analizën e Komisionit të bërë për këto vite, pretendime të cilat pasqyrojnë të njëjtin qëndrim që subjekti ka mbajtur edhe në deklaratimet e saj gjatë hetimit administrativ në Komision. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se:
- i.* Gjendja e kursimeve në *cash* nuk është përlllogaritur saktë, përlllogaritje e cila ka derivuar që nga viti 2009, kur subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë këto kursime. Në gjendjen e kursimeve në *cash* të këtij viti duhet të përfshihen edhe të ardhurat e përfituara nga shitja e

automjetit tip “Mercedes-Benz 250”. Këto kursime janë pakësuar në shumën 1.000.000 lekë, për shkak të blerjes së pasurisë “autoveturë”. Gjendja e kursimeve në *cash*, në fund të vitit 2010, është në shumën 4.053.536 lekë, pasi përpos kursimeve të deklaruara në këtë vit, subjekti i rivlerësimit ka pasur të drejtën e depozitës bankare lënë në dispozicion bashkëshortëve Q., pas mbajtjes prej tyre të shumës prej 25.000 eurosh. Në total, gjendja e kursimeve *cash*, në fund të vitit 2011, është 1.000.000 lekë, e cila ka mbetur e pandryshuar edhe në fund të vitit 2012.

ii. Në analizën e vitit 2011 duhet të njihen të ardhurat e përfituara nga kursi i këmbimit në këtë vit, pasi pjesa e mbetur nga depozita e tërhequr në “Raiffeisen Bank” është konvertuar në euro në vitin 2011, kur subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj u kthyen nga Italia dhe bashkëshortët Q., u kthyen pjesën e mbetur të depozitës, pasi kishin mbajtur shumën prej 25.000 eurosh.

iii. Në analizën e vitit 2012 dhe 2013 duhet të përfshihen të ardhurat e lëna nga trashëgimia e babait të subjektit të rivlerësimit.

42.1. Lidhur me pretendimin se në analizën financiare të kryer nga Komisioni nuk është pasqyruar saktë gjendja e kursimeve në *cash*, trupi gjykues vëren se në deklaratat e interesave private në vite, për periudhën e kontestuar, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

Në deklaratën e interesave private të vitit 2009: *Kursime në formën e shumës cash, të cilat i kemi në shtëpi dhe i përdorim për nevoja familjare. Vlera: 500.000 lekë.*

Në deklaratën e interesave private të vitit 2010: *Shuma e kursyer gjatë një viti nga të ardhurat e siguruara nga puna e bashkëshortit dhe imja. Vlera: 500.000 lekë.*

Në deklaratën e interesave private të vitit 2011: *Shuma e kursyer gjatë një viti nga të ardhurat e siguruara nga puna e bashkëshortit dhe imja. Vlera: 500.000 lekë.*

Në deklaratën e interesave private të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesa apo pakësime të kursimeve në *cash*, por në rubrikën “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit” ka deklaruar: *Autoveturë, tip “Daimler Chrysler” ML 270 CDI, me targa {***}, në bashkëpronësi me bashkëshortin A. LL. DH. Blerë nga bashkëshorti në Itali, me kursimet tona të viteve të mëparshme. Vlera: 10.500 euro.*

42.2. Komisioni, në vendim⁴⁸, ka arsyetuar se: *Në lidhje me pretendimin se për vitin 2009 gjendja cash nuk është 500.000 lekë, sa deklaruar shprehimisht në deklaratën e interesave private 2009, por 1.000.000 lekë, duke përfshirë dhe të ardhurat nga shitja e automjetit në vlerën 500.000 lekë, ky pretendim është i pabazuar, pasi, referuar nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9049/2003, subjektet kanë pasur detyrimin të deklarojnë gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme. Në interpretim të kësaj dispozite ligjore, subjekti ka deklaruar gjendjen deri më 31.12.2009, për pasurinë “automjet”, tip “Mercedes-Benz” dhe kursime në formën e gjendjes cash në shumën 500.000 lekë nga të ardhurat e përfituara përgjatë vitit 2009. [...] Në lidhje me përfshirjen për vitin 2010 të të ardhurave të mbetura në shumën prej 25.600 eurosh të depozitës në “Raiffeisen Bank”, nga pagesa e këstit të parë prej 20.000 eurosh, ky pretendim nuk është i bazuar, pasi, sikurse është trajtuar gjerësisht në seksionin e pagesës së këstit të parë të apartamentit, subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e interesave private 2010 gjendje*

⁴⁸ Paragrafët 66.1-66.3 të vendimit të Komisionit.

në fund të vitit 2010 nga disponimi i depozitës në “Raiffeisen Bank”. Ky pretendim bie në kundërshtim edhe me vetë deklarinimet e saj, pasi subjekti ka shpjeguar se shuma e mbetur nga depozita është përdorur për qëllime të aktivitetit tregtar të shtetasit F., Q., deri përpara kthimit nga Italia të subjektit dhe familjes së saj. Edhe për vitin 2011, pretendimi i subjektit se mbi shtesën e deklaruar për këtë vit në shumën 500.000 lekë duhet të përfshihet edhe gjendja cash e mbetur nga viti 2010, është i pabazuar për të njëjtën arsye mosdeklarimi, pasi referuar DIPP/2011 subjekti ka deklaruar kursime vetëm në shumën 500.000 lekë.

Pasi kontrolloi nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, analizën financiare të pasqyruar në vendim⁴⁹, trupi gjykues konstatoi se mbështetur në arsyetimin e mësipërm, Komisioni ka përlllogaritur se subjekti i rivlerësimit në fund të vitit 2009 kishte gjendje të kursimeve në *cash*, në shumën 500.000 lekë, në fund të vitit 2010 kishte gjendje të kursimeve në *cash* në shumën 1.000.000 lekë dhe në fund të vitit 2011, gjendja e kursimeve të akumuluar në *cash* ishte në shumën 1.500.000 lekë⁵⁰.

42.3. Në kuadër të shqyrtimit të shkakut të ankimit, trupi gjykues vëren se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me kursimet në *cash* për vitin 2009, janë analizuar më sipër në këtë vendim, prandaj për të shmangur përsëritjen në vijim, konkluzioni i arritur më sipër në vendim, se për blerjen e pasurisë “autoveturë” në vitin 2010 subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur në dispozicion vetëm shumën prej 500.000 lekësh si kursime në *cash* nga viti i mëparshëm, gjen zbatim në analizën financiare të vitit 2009.

42.4. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se gjendja e kursimeve në *cash* në fund të vitit 2010 është në shumën 4.053.536 lekë, pasi krahas kursimeve të deklaruara në këtë vit, subjekti i rivlerësimit ka pasur të drejtën e depozitës lënë në dispozicion bashkëshortëve Q., pas mbajtjes prej tyre të shumës prej 25.000 eurosh, trupi gjykues vlerësoi të drejtë qëndrimin e Komisionit, për të mos e konsideruar këtë shumë në analizën financiare të vitit 2010, në raport me të gjitha rrethanat që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ të Komisionit, si dhe duke konsideruar edhe shpjegimet e deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në Komision, të cilat janë një prej mjeteve të kërkimit të provës për efekt të këtij procesi⁵¹. Krahas faktit që në deklaratën e interesave private të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pjesën e mbetur në *cash* nga tërheqja e depozitës bankare në “Raiffeisen Bank”, trupi gjykues vëren se edhe në ankim, ashtu si edhe gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, në mënyrë të përmbledhur, se depozita në shumën 67.000 dollarë në “Raiffeisen Bank” është tërhequr nga znj. S., Q., në datën 21.12.2010, nga e cila, pasi është mbajtur shuma prej 25.000 eurosh, i është kthyer subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj shuma prej 20.000 eurosh, në shkurt 2011, pasi ata janë kthyer nga një udhëtim familjar në Itali. Edhe bashkëshortët Q., në deklaratën

⁴⁹ Faqja 50 e vendimit të Komisionit.

⁵⁰ Në zërin “Ndryshim likuiditeti”, Komisioni ka pasqyruar ndryshimin e likuiditetit në *cash* në banesë dhe likuiditetit në sistemin bankar.

⁵¹ Neni 49 i ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Komisioni ose Kolegji i Apelit ka të drejtë: [...] b) të mbledhë deklaratat nga subjekti i rivlerësimit, nga dëshmitarët, ekspertët dhe publiku [...]”.

e tyre drejtuar ILDKPKI-së në datën 28.04.2015, kanë pranuar se, pasi kanë mbajtur shumën prej 25.000 eurosh nga vlera e tërheqjes së depozitës bankare, pjesën tjetër z. Q., e ka përdorur për qëllime të aktivitetit të tij të ligjshëm në fushën e këmbimit valutor. Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.10.2021, bashkëshortët Q., kanë deklaruar se, pasi kanë mbajtur shumën prej 25.000 eurosh, pjesën tjetër e kanë disponuar derisa bashkëshortët DH., të ktheheshin nga Italia. Sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se në fund të vitit 2010 ka pasur gjendje në *cash* në shumën 4.053.536 lekë është i pambështetur në prova.

42.5. Në vijim të këtij konkluzioni, si dhe përfundimit të arritur më sipër në këtë vendim se kursimet në *cash* të disponuara në vitin 2009 janë përdorur tërësisht për blerjen e pasurisë “autoveturë”, në ndryshim nga sa ka arsyetuar Komisioni, trupi gjykues konstaton se kursimet në *cash* të subjektit të rivlerësimit, në fund të vitit 2010, janë në shumën 500.000 lekë si deklaruar në deklaratën e interesave private të këtij viti, e cila përfaqëson të gjitha kursimet e akumuluar në *cash*.

Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, në deklaratën periodike të interesave të vitit 2011 ka deklaruar se nga të ardhurat e siguruara nga puna e saj dhe e bashkëshortit, gjatë këtij viti kanë kursyer shumën 500.000 lekë, në fund të vitit 2011, gjendja e kursimeve në *cash* është në shumën e akumuluar prej 1.000.000 lekësh, e rrjedhur nga 500.000 lekë në fund të vitit 2010 dhe 500.000 lekë shtesë në vitin 2011.

Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime në *cash* për vitin 2012, për pasojë gjendja e kursimeve në *cash* mbetet e pandryshuar.

43. Në lidhje me analizën financiare për vitet 2012 dhe 2013, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni në mënyrë të padrejtë nuk ka përfshirë të ardhurat e lëna nga trashëgimia e babait të saj, përkatësisht në shumën 900.000 lekë në *cash* dhe 619.256 lekë si likuiditet bankar (depozitë bankare e kaluar në favor të tyre nga çelja e trashëgimisë së babait të saj të ndjerë).

43.1. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues konstatoi se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar dy depozita me afat në “Raiffeisen Bank”, përkatësisht në shumën 536.587 lekë në emër të vajzës M., DH., dhe 536.587 lekë në emër të vajzës S., DH., të cilat janë çelur më datë 30.03.2012, në shumat fillestare prej 450.000 lekësh dhe kanë arritur në shumat e deklaruara për efekt të shtimit nga interesat vjetore bankare. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shumat fillestare të çeljes së këtyre depozitave janë dhuruar nga i ndjeri babai i saj J., H., nga kursimet e tij në *cash* dhe nga depozita në “Raiffeisen Bank”.

43.2. Në përfundim të kontrollit të likuiditeteve bankare si më sipër, Komisioni, në vendim⁵², ka arritur në konkluzionin se: [...] duke konsideruar shpjegimet e subjektit se ka bashkëjetuar me babain e saj dhe i ka mbuluar atij shpenzimet jetike dhe nga ana tjetër, duke vlerësuar të ardhurat nga pensioni të përfituara nga babai i saj, ka pasur mundësi për krijimin e kursimeve të mundshme, të cilat janë bërë burim krijimi të depozitave të vajzave të subjektit.

⁵² Paragrafi 66.2 i vendimit të Komisionit.

Në vendim, në paragrafin e titulluar “Analiza financiare 2003-2016”⁵³, Komisioni ka arsyetuar se: *Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga trashëgimia e babait të subjektit në vitin 2013 likuiditete bankare në shumën rreth 619.265 lekë, këto të ardhura janë konsideruar në analizën financiare përfundimtare. Trupi gjykues i vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit se, duke qenë fëmijë i vetëm, ka pasur nën përgjegjësinë e saj financiare babain dhe se shpenzimet për të janë mbuluar nga subjekti i rivlerësimit. Për rrjedhojë, është e besueshme që gjendja cash e akumuluar nga babai i subjektit në shumën rreth 900.000 lekë dhe në likuiditete bankare, të jetë disponuar nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj pas vdekjes së babait të saj dhe lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë.*

43.3. Trupi gjykues, pasi kontrolloi rezultatet e analizës financiare përfundimtare të Komisionit për vitin 2012, duke i krahasuar ato me rezultatet e analizës paraprake të përgatitur në përfundim të hetimit administrativ, dhe me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për shumën 900.000 lekë trashëguar në *cash* nga i ndjeri babai i saj, konstatoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë marrë në konsideratë nga Komisioni⁵⁴.

Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit referuar analizës financiare të vitit 2013, trupi gjykues konstatoi se në analizën përfundimtare të Komisionit nuk është shtuar shuma 619.265 lekë në vitin 2013⁵⁵, si e ardhur nga trashëgimia e babait të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues vëren se korrektimi i analizës financiare të Komisionit për vitin 2013, me shtimin e vlerës 619.265 lekë në zërin “*Të ardhura nga trashëgimia e prindërve të subjektit*” (*Raiffeisen Bank*), thellon balancën pozitive në rezultatin e këtij viti. Për pasojë, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim nuk është relevant për zgjidhjen e çështjes.

43.4. Në përfundim, bazuar në arsyetimin e mësipërm, si dhe duke mbajtur në konsideratë konkluzionet e arritura lidhur me burimet financiare të krijimit të pasurisë “apartament në Tiranë”, balanca negative për vitin 2011 mbetet e njëjtë me atë të llogaritur nga Komisioni (-) 4.000.811 lekë, për pasojë subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues konfirmoi, gjithashtu, balancën negative të konstatuar nga vendimi i Komisionit për vitin 2012 prej (-) 351.943 lekësh. Subjekti i rivlerësimit nuk mundi të justifikojë me burime të ligjshme pasuritë e krijuara dhe përballimin e shpenzimeve të kryera, për pasojë gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 edhe për vitin 2012.

44. Në lidhje me analizën financiare të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, duke pretenduar se Komisioni ka përllogaritur në mënyrë të gabuar shpenzimet e mobilimit, në vlerën 100.000 lekë, në kundërshtim

⁵³ Paragrafi 78.2 i vendimit të Komisionit.

⁵⁴ Komisioni ka pasqyruar shumën 900.000 lekë, në analizën financiare të vitit 2012, në zërin “*Të ardhura nga trashëgimia e prindërve të subjektit (Raiffeisen Bank)*”, Komisioni ka pasqyruar shumën 900.000 lekë.

⁵⁵ Nga informacioni i përcjellë në Komision nga “*Raiffeisen Bank*” rezulton se në datën 17.01.2013 është debituar llogaria nr. {***}, në emër të z. J., H., në shumën 619.265 lekë dhe në po këtë datë, është kredituar llogaria e pagës së znj. Saemira Hila në të njëjtën vlerë, me përshkrimin: “*Trashëgimi sipas vendimit të gjykatës, datë 21.12.2012*”.

me atë që ajo ka deklaruar gjatë hetimit administrativ se këto shpenzime janë mbyllur në vitin 2013, në shumën 200.000 lekë.

44.1. Komisioni, në vendim⁵⁶, lidhur me shpenzimet e mobilimit, ka arsyetuar se: *Në lidhje me pretendimin e subjektit për mospërfshirjen në vitin 2014 të zërit “shpenzime mobilimi” për apartamentin në Tiranë, për arsye se këto shpenzime janë kryer në vitin 2013, trupi gjykues çmon se subjekti është pyetur në mënyrë të përsëritur gjatë hetimit administrativ në lidhje me shpenzimet e mobilimit, ku i është kërkuar të përcaktojë ndër vite shpenzimet e kryera për efekt të analizës financiare vjetore. Në vijim, subjekti ka deklaruar se shpenzimet për mobilimin e shtëpisë janë kryer ndër vite në vlera modeste që nuk kalojnë shumën 300.000-400.000 lekë në total, duke filluar që nga viti 2011 dhe se nuk disponon fatura. Mbi bazën e deklaramit të subjektit, trupi gjykues ka vlerësuar ndarjen e totalit të shpenzimeve të mobilimit prej 400.000 lekësh në mënyrë të barabartë për katër vite, duke filluar nga viti 2011. Për rrjedhojë, në analizën financiare përfundimtare zëri “shpenzime mobilimi apartamenti në Tiranë” nuk ka ndryshuar. Në mbështetje të këtij arsyetimi, Komisioni, në analizën financiare 2003-2016, në zërin “Shpenzime mobilimi”, ka përlllogaritur vlerën prej 100.000 lekësh, për secilin vit të periudhës 2011-2014.*

44.2. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se, në lidhje me mobilimin e apartamentit në Tiranë, subjekti i rivlerësimit në pyetësorin standard ka deklaruar se: *Shpenzimet për mobilimin e shtëpisë tonë janë kryer ndër vite në vlera modeste që nuk i kalojnë 300.000-400.000 lekë në total, pasur parasysh edhe faktin që një pjesë e mobilieve ishin të blera nga prindërit e mi. Për blerjet e kryera nga ne të dy si bashkëshortë, nuk disponojmë fatura tatimore, për shkak të kohës së gjatë të kaluar. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur subjekti i rivlerësimit edhe në përgjigjen e kërkesës së drejtuar nga Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 2, në të cilin, ndër të tjera, i është kërkuar të deklarojë shpenzimet e mobilimit të kryera për çdo vit kalendarik.*

44.3. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se në kushtet kur deri në plotësimin e deklaratës së interesave private për vitin 2012, deklarimi i shpenzimeve nën vlerën 500.000 lekë apo nën vlerën 300.000 lekë prej vitit 2014, përfshirë edhe shpenzimet e mobilimit, nuk ka qenë detyrim ligjor për zyrtarët deklarues, në pamundësi për ta konfirmuar me deklaratat ndër vite, vlera e tyre do të duhet të përfshihet në analizën financiare, sipas deklarimeve dhe shpjegimeve të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se Komisioni duhet të kishte përlllogaritur në analizën financiare vlerën 200.000 lekë, në zërin “Shpenzime mobilimi”, ndërsa në analizën e vitit 2014 nuk duhet të kishte përlllogaritur këtë lloj shpenzimi.

44.4. Nga korrektimi i analizës financiare të Komisionit të vitit 2014, duke mos përfshirë në të shpenzimet e mobilimit, balanca negative nga vlera (-) 175.865 lekë, që ishte në analizën e Komisionit, reduktohet në vlerën (-) 75.865 lekë e, për pasojë, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Balanca në analizën financiare të vitit 2013 vazhdon të mbetet në vlera pozitive, edhe pse zëri “Shpenzime mobilimi” ndryshoi nga vlera 100.000 lekë në vlerën 200.000 lekë.

⁵⁶ Paragrafi 78.1 i vendimit të Komisionit.

45. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit për sa i përket konkluzioneve të Komisionit në lidhje me huan dhënë kunatit të saj në vitin 2015, në shumën 10.000 euro, duke i analizuar ato në mënyrë integrale në raport me rrethanat e faktit që kanë rezultuar nga hetimi administrativ.

45.1. Komisioni ka verifikuar se burimet e deklaruara janë përdorur për krijimin e shumës së dhënë hua dhe në përfundim të hetimit administrativ, në vendim⁵⁷, ka arritur në konkluzionin se: *[...] subjekti nuk ka pasur mundësi për të dhënë huan në shumën prej 10.000 eurosh, për arsye të pamjaftueshmërisë financiare në vitin 2011 në shumën (-) 4.000.811 lekë dhe në vitin 2014 në shumën (-) 175.865 lekë. Subjekti ka pasur detyrimin të depozitojë dokumentacionin e kërkuar sipas ligjit me depozitim të deklarimit të pasurisë së rivlerësimit, bazuar në pikën 6 të udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, "Për mënyrën e deklarimit të pasurive". Trupi gjykues vlerëson se, edhe nëse do të provohej nga subjekti fakti i blerjes së shtëpisë nga shtetasi E., DH., përsëri ky fakt nuk do të ndikonte në vendimmarrjen ndaj subjektit të rivlerësimit.*

45.2. Në kundërshtim të konkluzionit si më sipër, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në ankim se rrethanat e deklaruara prej saj lidhur me dhënien e huas dhe qëllimin e përdorimit nga z. E., DH., edhe pse janë vërtetuar nga Komisioni, përsëri nuk kanë ndikuar në formimin e besueshmërinë të subjektit të rivlerësimit. Shuma e huas është siguruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, me burime krejtësisht të ligjshme që janë të ardhurat nga puna e secilit, të cilat janë kursyer në *cash*. Kjo shumë i është dhënë dorazi z. E., DH., dhe vjehrrës znj. N., DH., (të cilët janë në një përbërje familjare), në Shqipëri, në kohën që ata kanë ardhur nga Italia. Të vepruarit në këtë mënyrë nuk mund të vëre në dyshim këtë deklaram, në kushtet kur të vepruarit në këtë mënyrë është ligjshme i lejuar dhe mund të konfirmohet nga hyrje-daljet e tyre në/nga territori i Republikës së Shqipërisë në vitin 2015, si dhe në kushtet kur individët janë në lidhje të afërt gjaku (vëllezër) mes tyre. Sipas subjektit të rivlerësimit, një provë tjetër që duhet të merrej në konsideratë nga Komisioni, në favor të besueshmërisë së deklaramëve të saj lidhur me huan si më sipër, është fakti që kjo hua është kthyer pjesërisht nga z. E., DH., nëpërmjet bankës, si edhe deklarata e tij me vetëpërgjegjësi për marrjen e kësaj huaje vënë në dispozicion organeve të rivlerësimit, fakte të cilat lidhen me njëri-tjetrin dhe hedhin poshtë çdo dyshim mbi vërtetësinë e huasë. Dakordësia e palëve për të mos lidhur një kontratë me shkrim është çmuar nga subjektet e kësaj marrëdhënie (bashkëshortëve DH., dhe z. E., DH.), të cilët asnjëherë nuk kanë vënë në diskutim ekzistencën dhe provueshmërinë e detyrimit me njëri-tjetrin, për shkak të marrëdhënieve të posaçme që ekzistojnë midis tyre.

45.3. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit si më sipër, trupi gjykues konstatoi se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar: *Shuma 10.000 euro, e kursyer nga të dy bashkëshortët, të cilën ia kemi dhënë hua kunatit (vëllait të bashkëshortit E. LL. DH.), me qëllim blerjen e një shtëpie banimi prej tij në {***}, {***}, Itali, ku ai jeton prej vitesh dhe si shtetas italian aktualisht.*

⁵⁷ Paragrafi 69 i vendimit të Komisionit.

Në deklaratën e interesave private të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Të gjitha kursimet në cash, ndër vite, në total prej 10.000 eurosh, ia kemi dhënë hua kunatit E., DH., me adresë në {***}, {***}, Itali. Nuk kemi nënshkruar kontratë për shkak të mirëbesimit nga marrëdhënia e posaçme e gjinisë (kunati).*

Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka paraqitur një deklaratë të thjeshtë të z. E., DH., lëshuar më datë 24.12.2016, në të cilën ai konfirmon marrjen e huas nga bashkëshortët DH., në vitin 2015, në shumën 10.000 euro, me qëllim blerjen e një shtëpie banimi në {***}, {***}, Itali.

Gjatë hetimit administrativ në Komision, në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka vijuar me paraqitjen e dokumentacionit për të provuar qëllimin e dhënies së huas kunatit të saj, z. E., DH., për blerjen prej tij të një shtëpie banimi në {***}, {***}, Itali, dokumentacioni i cili është pasqyruar në mënyrë të detajuar në vendimin objekt shqyrtimi.

Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se dokumentacionin për blerjen e shtëpisë nga z. E., DH., në Itali, nuk ka mundur ta paraqesë në formën e kërkuar ligjore, pasi për shkak të përhapjes së virusit Covid-19, ishte ngadalësuar veprimtaria e autoriteteve zyrtare italiane në marrëdhëniet me publikun dhe, për këtë arsye, me gjithë përpjekjet, kunati i saj kishte mundur të siguronte vetëm një kopje të njehsuar me origjinalin të kontratës së shitblerjes së pasurisë, por jo të pajisura me vulën Apostille.

45.4. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, të parashtruara në ankim, fillimisht, trupi gjykues vëren se ato janë orientuar kryesisht në drejtim të vërtetimit të ekzistencës së marrëdhënies së huas dhe qëllimit të dhënies së saj, pretendime të cilat rezultojnë se u referohen gjetjeve fillestare të Komisionit në rezultatet e hetimit administrativ, por që janë tejkaluar në vendim, pasi Komisioni nuk e ka vënë në dyshim ekzistencën e kësaj marrëdhënieje huaje. Komisioni konkluzionin e tij e ka mbështetur në kontrollin dhe verifikimin e burimeve financiare të krijimit të shumës së dhënë hua, ashtu siç ato janë deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe, për këtë arsye, ka nënvizuar se nuk e ka çmuar të domosdoshëm paraqitjen nga subjekti i rivlerësimit të dokumentacionit justifikues ligjor, edhe pse ajo ka qenë e detyruar ta paraqiste atë në formën e kërkuar nga ligji, që në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, në mbështetje të parashikimit të pikës 6 të udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016”. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me ekzistencën e marrëdhënies së huas dhe qëllimit të dhënies së saj, nuk janë relevante për zgjidhjen e shkakut të ankimit.

45.5. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se shuma e dhënë hua është siguruar me burime krejtësisht të ligjshme që janë të ardhurat nga puna e saj dhe e personit të lidhur, të cilat janë kursyer në *cash*, pretendim ky që kundërshton konkluzionin e arritur nga Komisioni në vendim, se subjekti nuk ka pasur mundësi për të dhënë huan në shumën prej 10.000 eurosh, për arsye të pamjaftueshmërisë financiare në vitin 2011 në shumën (-) 4.000.811 lekë dhe në vitin 2014 në shumën (-) 175.865 lekë, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si

burim të krijimit të shumës 10.000 euro dhënë hua kunatit z. E., DH., kursimet në *cash* të krijuara ndër vite. Trupi gjykues, në konsideratë të konkluzioneve të arritura më sipër në këtë vendim, lidhur me kursimet në *cash* të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, referuar edhe rezultateve negative të analizës financiare për vitet 2011 dhe 2014, në të cilat subjekti i rivlerësimit ka deklaruar krijimin e kursimeve në *cash*, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, në fund të vitit 2014, nuk kishte mundësi që të dispononte shumën prej 10.000 eurosh, nga burime të ligjshme financiare, për pasojë e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit në vendim se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi për të dhënë huan në shumën prej 10.000 eurosh, në vitin 2015. Pavarësisht nga sa më sipër, trupi gjykues gjen me vend të nënvizojë faktin se konkluzionin e mësipërm Komisioni nuk e ka renditur në konkluzionet për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimin tërësor të çështjes. Ky konkluzion nuk ka ndikuar as në rezultatin e analizës financiare të vitit 2015, i cili rezulton me balancë pozitive të situatës financiare të subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me huan e dhënë kunatit të saj, në shumën 10.000 euro, në vitin 2015, nuk kanë ndikim në zgjidhjen e çështjes, për sa kohë Komisioni, në vendim, edhe pse ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk kishte burime të ligjshme financiare të mjaftueshme për të dhënë hua në shumën 10.000 euro, nuk e ka ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore në kuptim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

46. Në përmbledhje të arsyetimit dhe konkluzioneve të arritura më sipër në këtë vendim, në analizë të situatës faktike dhe ligjore, trupi gjykues konstatoi se balanca negative e përlllogaritur nga Komisioni, për kursimet në *cash*, investimet dhe për shpenzimet e kryera për periudhën 2003-2016, duke pranuar disa nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit për zëra të caktuar, reduktohet nga (-) 5.921.489 lekë në (-) 4.428.619 lekë.
Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të çështjes, si dhe në konsideratë të jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, vlerësoi se pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për kursimet në *cash*, investimet dhe për shpenzimet e kryera për periudhën 2003-2016, në vlerë totale prej (-) 4.428.619 lekësh, megjithëse rezulton në vlerë më të ulët sesa ajo e konstatuar nga Komisioni, e bën të pamundur zbatimin e parimit të proporcionalitetit.
47. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
48. Megjithëse disa prej shkaqeve të ankimit, të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit e të analizuara nga trupi gjykues i Kolegjit, rezultuan të bazuara, ato u vlerësuan si të pamjaftueshme për të ndryshuar vendimin e Komisionit.
49. Në përfundim, bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Saemira Hila, gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për pasojë vendimi nr. 473,

datë 05.11.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e saj nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 473, datë 05.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Saemira Hila.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 12.11.2024.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi-kundër

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare **Ina Rama**, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues për sa i takon çështjes që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Saemira Hila, kundër vendimit nr. 473, datë 05.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Duke qenë se kam konkluduar se ajo ka arritur një nivel të besueshëm lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, kam votuar për prishjen e vendimit objekt gjykimi dhe urdhërimin e Komisionit të vijojë me hetimin për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, për arsytet e mëposhtme.
2. Kam qenë dakord me qëndrimin e shumicës së trupit gjykues, për disa nga konkluzionet e arritura në mënyrë të ndryshme nga Komisioni, të cilat do të përdoren në arsyetimin e mëposhtëm si konkluzione, duke iu bashkuar arsyetimit që ka bërë shumica lidhur me to. Ndërsa do të arsyetohet në vijim, për qëndrime të ndryshme nga shumica e trupit gjykues, të cilat edhe kanë ndikuar në votën time *kundër*.

Lidhur me pasurinë “Apartament të ndodhur në {}”, Tiranë***

3. Analiza e kryer në vijim mbështet si fillim në një konkluzion të arritur edhe prej shumicës së trupit gjykues, se subjekti i rivlerësimit kishte krijuar me burime të ligjshme depozitën bankare në “Raiffeisen Bank”, në shumën 67.000 dollarë, e cila është deklaruar prej subjektit se ka shërbyer si një prej burimeve të krijimit të pasurisë “Apartament”, në vitin 2010 dhe 2011.
4. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, por edhe atë periodike të vitit 2010 ka deklaruar se kjo depozitë ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë, kontrolli i mëtejshëm mbi këtë pasuri u fokusua në mënyrën e përdorimit të këtyre fondeve të ligjshme, të cilat zotëroheshin prej subjektit dhe personit të lidhur, para krijimit të pasurisë “Apartament”.
5. Në këtë drejtim, kam ndarë një qëndrim të ndryshëm për sa i përket analizës dhe konkluzionit të shumicës lidhur me pagesën e kështit të parë dhe të dytë të kësaj pasurie, respektivisht prej 25.000 euro dhe 20.000 euro, qëndrim i cili ka përcaktuar edhe qëndrimin e shumicës së trupit gjykues, se subjekti gjendet në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm.
6. ***Lidhur me pagesën e kështit të parë prej 25.000 euro***, që rezulton se është paguar ditën e nënshkrimit të kontratës paraprake të shitjes për këtë pasuri, me shoqërinë “{***}” ShPK, kam ndarë qëndrim të ndryshëm nga shumica për sa i përket faktit se, në thelb, subjekti ka përdorur kursimet e saj dhe të personit të lidhur për të paguar këtë shumë, ashtu si edhe për kështin e dytë prej 20.000 euro, dhe se ajo arrin të krijojë besueshmëri për faktet e shpjeguara prej saj që lidhen me mënyrën e pagesës së kësaj shume. Ndërsa shumica ka arritur në konkluzionin se subjekti nuk krijoi besueshmëri për sa ajo ka deklaruar, në të kundërt, pakica ka arritur në konkluzionin se subjekti ka sjellë mjaftueshëm informacion që rezulton nga burime dokumentare, për të krijuar bindjen se versioni i saj i fakteve të çon në përfundimin se paratë e kursyera gjatë gjithë jetës kanë shërbyer për të financuar të vetmen pasuri të paluajtshme të subjektit dhe të personit të lidhur, për

sa kohë që asnjë investim tjetër nuk rezulton të jetë bërë prej familjes së subjektit, as i deklaruar dhe as i dyshuar, në asnjë formë.

7. Subjekti ka deklaruar në deklaratën vetting si burime financiare për krijimin e pasurisë “Apartament me sipërfaqe 112,1 m²”: i) *kredi bankare dhe hipotekë e datës 18.02.2011, në Raiffeisen Bank; shuma 5.000.000 lekë; ii) të ardhurat e fituara nga shitja e apartamentit të trashëguar nga prindërit, privatizuar me ligjin nr. 7652/1991; iii) të ardhurat e kursyera nga puna e secilit bashkëshort në vitet paraardhëse.*
8. Ndërsa, në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2010, ajo ka bërë dy deklarime në rubrika të ndryshme lidhur me këtë pasuri, duke ekspozuar për organet e kontrollit, në këtë rast ILDKPKI-në, lidhjen e kontratës paraprake të shitjes, çmimin e kontraktuar për fitimin e pasurisë, si edhe burimet e përdorura për këtë qëllim. Së pari, në rubrikën “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme e të luajtshme”, subjekti ka deklaruar: *depozita bankare (\$) në Raiffeisen Bank, dega Lushnjë është tërhequr për t’u përdorur e gjitha për blerjen e një apartamenti të ndodhur në zonën kadastrale {***}, nr. pasurie {***}. Ndërsa në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar: *Me kontratën paraprake të shitjes (kreditimi), datë 17.12.2010, unë dhe bashkëshorti - blerës dhe shoqëria {***} ShPK - shitëse, kemi shprehur vullnetin për blerjen e një apartamenti të ndodhur në ZK {***} {***}, Tiranë. Çmimi i shitjes është 82.500 euro, nga të cilat 25.000 euro i kemi paguar shitësit. Diferenca prej 57.500 euro do të paguhej në momentin e lëvrimit të një kredie bankare në Raiffeisen Bank, dega Lushnjë. Kjo kredi është miratuar në muajin shkurt 2011 dhe do të jetë objekt verifikimi i punës tuaj për vitin pasardhës. E gjithë depozita jonë bankare e deklaruar më parë ka shkuar për llogari të blerjes së këtij apartamenti.**
9. Në këtë mënyrë, subjekti ka deklaruar në mënyrë shteruese krijimin e pasurisë, si edhe burimet e krijimit të saj, të cilat janë depozita bankare në “Raiffeisen Bank”, e krijuar prej bashkëshortëve gjatë gjithë jetës, si edhe kredia bankare, e cila është lëvruar po prej kësaj banke, në vitin 2011. Të njëjtat burime deklaroi subjekti për krijimin e kësaj pasurie edhe në deklaratën vetting, edhe gjatë hetimit administrativ në Komision, por edhe në pretendimet e ngritura në ankim. Në këtë drejtim, konstatohet një koherencë e plotë në drejtim të burimeve të përdorura për krijimin e pasurisë.
10. Mosdetajimi i çdo veprimi juridik që është integruar në transaksionin e fitimit të pasurisë dhe mënyrës së likuidimit të saj, nuk përbën në vlerësimin e pakicës, një detyrim ligjor të subjektit, aq më tepër në vitet e deklarimit 2010 – 2011. Ligji nr. 9043/2003 synonte që subjektet deklaruese të ekspozonin për organet e kontrollit, ndryshimet e pasurive dhe interesave privatë, dhe jo domosdoshmërisht çdo veprim financiar të kryer në funksion të këtyre ndryshimeve. Procesi i kontrollit që legjitimohej të kryente ILDKPKI-ja mundësonte verifikimin e deklarimeve të subjekteve deklaruese, nëpërmjet dokumentacionit të servitur prej tyre. Në këtë mënyrë, deklarimet e subjektit për të dy burimet e përdorura për krijimin e kësaj pasurie do t’i nënshtrohen *ipso lege* kontrollit të ekzistencës së tyre dhe ligjshmërisë, krahas verifikimit të përdorimit të tyre si burime për krijimin e pasurisë objekt kontrolli.

11. Rezulton se Komisioni nuk ka konstatuar problematika me burimin e dytë të deklaruar, si kredi e përfituar nga “Raiffeisen Bank”, ndërsa ka konkluduar se subjekti është me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e depozitës prej 67.000 USD, të deklaruar prej subjektit si të krijuar në vite dhe të përdorur për financimin e pasurisë. Nga kontrolli i ushtruar në Kolegj lidhur me depozitën, siç është arsyetuar gjerësisht në vendimin e shumicës, me të cilin jam dakordësuar për këtë pjesë, rezulton se subjekti dhe bashkëshorti kishin pasur burime të ligjshme për të financuar krijimin e kësaj depozite, gjatë gjithë viteve të deklarimit. E gjithë shuma prej 67.000 USD, sipas shumicës, ndonëse rezultoi të ishte pasuri e ligjshme e subjektit të rivlerësimit, nuk u vlerësua se ishte përdorur për krijimin e pasurisë së deklaruar, edhe pse nuk u evidentua asnjë investim tjetër ku mund të ishin përdorur kursimet e jetës, për më tepër në një vlerë të konsiderueshme financiare.
12. Në këtë drejtim, sipas analizës së fakteve të rezultuara nga hetimi, kam deduktuar se këto të ardhura të ligjshme janë përdorur prej subjektit për financimin e apartamentit, ***si për këstin e parë, në datën 17.12.2010, ashtu edhe për këstin e dytë, të paguar në datën 11.02.2011.***
13. Së pari, nga aktet rezulton se depozita prej 67.000 USD është tërhequr nga “Raiffeisen Bank” në datën 21.12.2010, për llogari të prokurës së posaçme të lëshuar nga subjekti i rivlerësimit për shtetasen S. Q., në datën 17.12.2010. Ky element, tërheqja e depozitës pas ditës së pagimit të këstit të parë, prej 25.000 euro, në datën 17.12.2010, e ka çuar shumicën në konkluzionin se subjekti nuk e dispononte këtë shumë në ditën e pagimit të këstit dhe e ka konsideruar atë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për këtë financim. Subjekti në këtë drejtim ka shpejtuar se pagimi në datën 17.12.2010, për shoqërinë “{***}” ShPK, është bërë prej bashkëshortit të znj. S. Q., z. F. Q., i cili e shoqëronte subjektin në bisedimet me shoqërinë për blerjen e apartamentit, pasi edhe ai, së bashku me motrën e tij, do të blinin një apartament tek i njëjti objekt i ndërtuar prej së njëjtës shoqëri. Kjo shumë e parapaguar prej këtij shtetasi, i cili zotëronte shuma monetare në dispozicion për shkak të aktivitetit në fushën e këmbimit valutor, i është kthyer atij potencialisht brenda së njëjtës ditë, nëpërmjet nënshkrimit të prokurës së posaçme në emër të bashkëshortes së tij, për tërheqjen e të gjithë depozitës prej 67.000 USD në “Raiffeisen Bank”. Ky veprim, sipas asaj që shpjegon subjekti, është kryer për shkak të faktit se ajo do të udhëtonte për në Itali në datën 19.12.2010, dhe kjo e pamundësonte të ishte prezente për kryerjen e veprimeve me bankën dhe kthimin e shumës së parapaguar nga z. Q.
14. Shpjegimet e subjektit si më sipër janë konfirmuar nga të dhënat e një sërë akteve të hetimit administrativ, të cilat, në vlerësimin e pakicës, janë konsideruar si të vlefshme për besueshmërinë e deklarimeve të saj dhe, mbi të gjitha, për faktin se depozita e krijuar me burime të ligjshme është përdorur siç subjekti ka deklaruar, për financimin e pasurisë “Apartament”. Në vijim do të renditen disa nga argumentet që e çuan pakicën në konkluzionin e mësipërm, të cilat janë jo vetëm qëndrime origjinare mbi të cilat mbështetet ky mendim, por edhe qëndrime kundërshtuese në drejtim të arsyetimit e argumenteve të paraqitura prej shumicës, duke qenë se konkluzioni për këtë pasuri lidhet me analizën e të dhënave dhe kalon nëpërmjet një procesi analitik të detajeve, që subjekti është përpjekur të paraqesë për t’i dhënë besueshmëri pretendimeve të saj.

15. *Së pari*, prokura e posaçme e lëshuar për znj. S. Q., mban datën 17.12.2010, e cila përkon me ditën e nënshkrimit të kontratës paraprake të shitjes dhe pagimin e këstit prej 25.000 euro, për llogari të saj. Sipas kësaj prokure, me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 17.12.2010, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti emërojnë si përfaqësuese të posaçme znj. Q., të cilën e autorizojnë: *Të paraqitet në Raiffeisen Bank, dega Lushnjë për të tërhequr të gjithë shumën e depozitës bankare me nr. llogarie {***}, të porositësit A. DH., e cila është në monedhën dollarë. Të kryejë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore dhe administrative për lëvrimin e një kredie bankare në emër të A. DH., e Saemira Hila, pranë Raiffeisen Bank. Po ashtu, përfaqësuesi jonë ka të drejtë të kryejë çdo veprim tjetër procedural të nevojshëm që nuk përmendet shprehimisht në këtë prokurë, por që ka lidhje me objektin e kësaj prokure. Së dyti*, nga përmbajtja e kësaj prokure, rezulton fillimisht se, që në këtë datë, porositësit i kanë deleguar përfaqësueses të gjitha të drejtat e tyre mbi depozitën, në funksion të tërheqjes së saj dhe përdorimit sipas nevojave, pavarësisht mospërcaktimit të çdo veprimi ligjor në aktin e përfaqësimit. Në këtë mënyrë, zotërimi i shumës prej 67.000 USD që në datën 17.12.2010, ditën e pagimit të shumës 25.000 euro, i ka kaluar znj. Q., për llogari dhe në emër të të përfaqësuarve, duke zotëruar ajo të drejtat e posedimit dhe të zotërimit të kësaj shume. Nga përmbajtja e prokurës, përveç faktit të lejimit të tërheqjes së shumës së depozitës, konstatohet edhe autorizimi për kryerjen e veprimeve për përfitim të kredisë, që do të përdorej më pas për financimin e apartamentit, delegim i cili mbështet deklaratimet/shpjegimet e subjektit për një marrëdhënie miqësore dhe të besueshme mes familjes së saj dhe familjes Q.
16. Provohet nga aktet në dosje se subjekti së bashku me bashkëshortin janë larguar për në Itali në datën 19.12.2010 dhe janë kthyer në datën 20.01.2011, duke i dhënë besueshmëri faktit se përpilimi i prokurës pikërisht në ditën e nënshkrimit të kontratës i detyrohej faktit që ajo do të largohej dhe nuk do të kishte mundësi të shlyente menjëherë parapagimin e kryer prej z. F. Q. Gjithashtu, nga konsultimi i kalendarit të vitit 2010, rezulton se data 17 dhjetor të ketë qenë ditë e premtë dhe, duke konsideruar faktin se subjekti në këtë ditë është ndodhur në Tiranë, për shkak të faktit se është nënshkruar kontrata paraprake e shitjes me shoqërinë “{***}” ShPK, duket e besueshme që ka qenë e pamundur prej saj të tërheqë vetë personalisht në këtë ditë depozitën në degën e Lushnjës të “Raiffeisen Bank”, në të cilën ajo ishte depozituar, por e vështirë edhe për shkak të ditës së shtunë që vinte më pas, ndërsa të dielën subjekti është larguar nga Shqipëria. Këto rrethana, jo vetëm justifikojnë përpilimin e prokurës për tërheqjen e parave dhe jo veprimin e drejtpërdrejtë prej subjektit në të njëjtën ditë, por edhe i japin kuptim perceptimit të saj se pagimi i këstit prej 25.000 euro ishte kryer nëpërmjet depozitës dhe jo burimeve të personave të tjerë, përderisa ajo kishte autorizuar bashkëshorten e personit që kishte mundësuar parapagimin, të tërhiqte dhe të përdorte sipas nevojës brenda objektit të prokurës, të gjithë shumën e gjendur në depozitë.
17. Nga dokumentacioni bankar rezulton se, në datën 21.12.2010, znj. S. Q., nëpërmjet prokurës së posaçme, ka tërhequr të gjithë shumën e gjendur në depozitë prej 67.000 USD. Ky fakt rezulton të jetë pohuar edhe në një deklaratë të datës 28.04.2015, drejtuar ILDKPKI-së, prej bashkëshortëve F., dhe S. Q., të cilët kanë deklaruar, qoftë faktin e parapagimit prej tyre të shumës prej 25.000 euro, si edhe të tërheqjes së të gjithë depozitës sipas prokurës së posaçme. Ata kanë shpjeguar në

këtë deklaratë gjithashtu se, pasi kanë marrë shumën prej 25.000 euro, e kanë përdorur për qëllime të aktivitetit të tyre të ligjshëm, këmbimit valutor, pjesën tjetër të shumës deri në kthimin e bashkëshortëve H. – DH., nga Italia, kohë kur u kanë kthyer atyre diferencën e konvertuar në shumën 20.000 euro. Në këtë kuptim, *së pari* konstatohet se këto rrethana nuk janë deklaruar për herë të parë nga subjekti në një fazë të avancuar të procesit të saj të rivlerësimit, sepse ato i janë servirur për kontroll ILDKPKI-së që në prill të vitit 2015, në mbështetje të përgjigjes *se do të paraqesë dokumentacion për të treguar mënyrën e shlyerjes së detyrimit ndaj shoqërisë*, relativisht larg miratimit të reformës në drejtësi, duke ekspozuar në këtë formë detajet e mënyrës së pagimit të shumës 25.000 euro, e cila mbetet sërish në perceptimin subjektiv të subjektit si një shumë që vjen nga depozita në pronësi të saj dhe e bashkëshortit, dhe jo nga huazimi i familjes Q. Subjekti, megjithëse e ka ditur plotësisht këtë situatë faktike, të shpjeguar prej saj në ILDKPKI që në vitin 2015, sërish ka zgjedhur të deklarojë në mënyrë të njëjtë në deklaratën e pasurisë *vetting*, por jo sepse kjo rrethanë nuk ekzistonte apo ishte shfaqur për të mbuluar ndonjë mungesë burimesh, por sepse duket që subjekti ka pasur të njëjtin perceptim për burimin e krijimit të pasurisë.

18. Në mbështetje të shpjegimeve se z. Q. ka parapaguar shumën prej 25.000 euro, në ditën e lidhjes së kontratës, vjen fakti i rezultuar nga të dhënat e kontratave të sipërmarrjes, se personat e përfshirë në transaksion kanë qenë së bashku në Tiranë atë ditë, për të negociuar/lidhur kontratat respektive paraprake të shitjes. Këto kontrata të lidhura mes subjektit e bashkëshortit dhe familjes Q., me shoqërinë “{***}” ShPK, rezultojnë të jenë përpiluar në një rend kronologjik pothuajse njëra pas tjetrës. Kontrata paraprake e shitjes, e lidhur mes subjektit dhe shoqërisë mban nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2010, ndërsa ajo e lidhur mes familjes Q., dhe shoqërisë, për blerjen e një apartamenti në njëjtën godinë, mban nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 17.12.2010, rrethana që provojnë deklaratimet se subjekti dhe personi i lidhur së bashku me bashkëshortët Q., kanë qenë bashkërisht dhe njëkohësisht në datën 17.12.2010, për lidhjen e kontratës paraprake të shitjes dhe, për pasojë, justifikon veprimin e pagimit të shumës prej 25.000 euro me fondet e z. F. Q. Mungesa e deklaratimit të këtij veprimi në deklaratën periodike, por edhe në atë *vetting*, justifikohet në kontekstin e situatës atipike, marrëdhënien miqësore dhe, mbi të gjitha, autorizimin për zotërimin e të gjithë depozitës, përfshi edhe shumën e parapaguar, të dhënë brenda së njëjtës datë.
19. Edhe nëse do të pranohet se midis subjektit dhe z. Q., ka pasur një marrëdhënie huaje, do të duhej të analizoheshin elementet e saj sipas Kodit Civil, në këndvështrim të nenit 1050 të tij, në të cilin një element i rëndësishëm është afati i kthimit të shumës së dhënë hua. Pikërisht ky element, duket se është i pamatshëm, deri inekzistent në rastin konkret, duke qenë se veprimi i huazimit të shumës dhe kthimit të saj janë kryer brenda së njëjtës datë. Tërheqja e shumës efektivisht, në datën 21.12.2010, pas katër ditësh nga përdorimi i saj, ka qenë një zgjedhje e znj. Q., por për sa i përket vullnetit të subjektit, edhe si huamarrëse, ajo shumë është kthyer që në datën 17.12.2010, kur është përpiluar prokura e posaçme me autorizimin për tërheqjen e të gjithë depozitës dhe përdorimin e saj. Në këtë kontekst, duket e vështirë, edhe në kuptim të dispozitave civile, të përcaktosh se kjo marrëdhënie e vendosur mes këtyre subjekteve do të duhej të trajtohej si një kontratë huaje, e cila më pas do të duhej të deklarohet në kuadër të deklaratimit të pasurisë dhe të kualifikohet më tej si

një burim për krijimin e pasurisë, duke iu nënshtruar rregullave të kontrollit, sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

20. Pavarësisht analizës së mësipërme dhe trajtimit të kësaj marrëdhënie si një moment atipik, që vështirë se gjen rregullim të posaçëm brenda parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, edhe nëse do të kontrollohej si një marrëdhënie e tillë, pakica vlerëson se z. Q., duket se kishte mundësi të parapaguante, nëpërmjet likuiditeteve të ligjshme/vlerave monetare të disponuara prej tij, për shkak të natyrës së aktivitetit që ai kryen. Rezulton se z. F. Q., është një nga ortakët e shoqërisë “{***}” ShPK, e cila kryen aktivitet në fushën e këmbimit valutor. Sipas të dhënave bankare dhe të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit, kjo shoqëri kryen veprimtari të ligjshme në këtë fushë prej vitesh dhe disponon/qarkullon shuma monetare në vlera të larta, të cilat mund të përballonin pagimin e përkohshëm të këtij kësti. Në vlerësimin tim, kjo analizë nuk do të duhej të bëhej sipas cilësimit të z. Q., si person tjetër i lidhur, për shkak se, sipas analizës së bërë më lart, ai nuk e gëzon këtë cilësi, por kjo situatë duhej vlerësuar në drejtim të besueshmërisë së deklarimeve/shpjegimeve të subjektit për rrethanat e faktit. Në këtë kontekst, duket e besueshme që kjo ndihmë fare e përkohshme të jepet nga individë, për të cilët zotërimi i parave është objekti i veprimtarisë së tyre tregtare, ata “tregtojnë vlera monetare” dhe duket se janë personat më të përshtatshëm për t’u ofruar drejt një ndihme të tillë miqësore. Situata do të ishte krejt e ndryshme, nëse në këtë pozicion do të ishin individë, të cilët identifikohen si pa burime të ardhurash dhe në vështirësi ekonomike. Në këtë këndvështrim kam vlerësuar se ndërhyrja e tyre, nëpërmjet këtij veprimi ndihmës financiar, është krejt i arsyeshëm dhe i besueshëm.
21. Në përmbledhje të sa më sipër, kam vlerësuar se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të përdorimit të depozitës prej 67.000 USD, për pagimin e këstit të parë të apartamentit, janë bindëse dhe, për pasojë, ajo ka pasur burime të ligjshme për justifikimin e tij.
22. **Lidhur me *këstin e dytë***, në vlerën prej 20.000 euro, të paguar prej subjektit në datën 11.02.2011, kam mbajtur gjithashtu një qëndrim të ndryshëm nga shumica e trupit gjykues, e cila ka arritur në konkluzionin se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme për pagimin e tij. Edhe në këtë analizë janë përdorur të njëjtat argumente dhe kundërgargumente në raport me analizën e shumicës, dhe që derivojnë në thelb nga qëndrimi i mbajtur më lart rreth besueshmërisë së subjektit për përdorimin e depozitës si një burim për krijimin e pasurisë “Apartament”.
23. Në drejtim të pagesës së këtij kësti në vitin 2011, subjekti ka përsëritur të njëjtin deklaratim të bërë në deklaratën periodike të vitit 2010, në rubrikën e ndryshimeve të pasurisë dhe interesave privatë, të cituar më lart, duke potencuar se ka përdorur të gjithë depozitën për pagimin e apartamentit. Krahas këtij deklaratimi të përsëritur literalisht, subjekti ka deklaruar edhe marrjen e kredisë të disbursuar në datën 09.03.2011, për financimin e apartamentit, duke potencuar në mënyrë përfundimtare se burimet e krijimit të pasurisë janë depozita dhe kredia bankare. Në këto kushte, ky deklaratim i subjektit lexohet në vijimësi të deklaratimeve të mëparshme, se ajo ka paguar shumën prej 20.000 euro si këst i dytë i pasurisë “Apartament”, duke përdorur sërish depozitën bankare prej 67.000 USD, të deklaruar edhe si burim për këstin e parë të tij.

24. Subjekti ka shpjeguar se pagesa e këtij kësti përfaqësonte diferencën e mbetur nga depozita, e cila e konvertuar ishte në vlerën 45.000 euro, nga të cilat 25.000 euro paguar në vitin 2010 dhe 20.000 euro paguar në vitin 2011. Të njëjtin shpjegim kanë mbështetur edhe bashkëshortët Q., nëpërmjet deklarimit të tyre në deklaratën e datës 29.04.2015, të dorëzuar në ILDKPKI dhe në deklaratën noteriale nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 29.10.2021, të hartuar gjatë procesit të rivlerësimit.
25. Në vlerësimin e pakicës, mungesa e ndonjë dokumentacioni për kthimin e kësaj shume subjektit, nga znj. S. Q., e cila e kishte tërhequr prej bankës në datën 21.12.2010 deri në shkurt të vitit 2011, nuk e bën të pabesueshëm deklarimin e subjektit, përderisa provohet tërheqja e shumës në bankë prej znj. Q., nëpërmjet prokurës së posaçme, ndërsa marrëdhënia e afërt nuk i detyronte palët të hartonin ndonjë dokument, aq më tepër kur prokura nuk zhvishte ligjërisht subjektin dhe bashkëshortin, as nga zotërimi i sendeve, parave në këtë rast, dhe as nga posedimi i tyre. Diferenca e mbetur prej 20.000 euro ishte një shumë në pronësi të subjektit dhe që nuk i kishte kaluar përfaqësueses në asnjë mënyrë, përderisa veprimet autorizoheshin të kryheshin për llogari dhe në emër të të përfaqësuarve. Në këtë kuptim, nuk nevojitej në kuptim të ligjit ndonjë akt dokumentar, që të provonte se prokura i kishte krijuar pasojat e saj të prezumuara për shkak të ligjit, përndryshe e kundërta do të duhej të provohej.
26. Gjithashtu, në këtë këndvështrim, mungesa e deklarimit të subjektit në deklaratën periodike të vitit 2010, se zotëronte pjesën e mbetur të depozitës, prej 20.000 euro, të cilën e përdori më pas në shkurt të vitit 2011, për pagesën e këstit të dytë, nuk duket se përcakton besueshmërinë e deklarimeve të saj dhe as leximin integral të deklarimeve. Subjekti ka deklaruar paraprakisht, që në deklaratën periodike të vitit 2010, të dorëzuar në mars të vitit 2011, kohë kur ishte kryer pagesa edhe e këstit të dytë të apartamentit, se e gjithë depozita ka shërbyer për pagimin e apartamentit, duke përcaktuar destinacionin e plotë të saj. Të njëjtin deklarim ka kryer subjekti edhe në deklaratën periodike të vitit 2011, se e gjithë depozita ka shkuar për pagimin e kësteve të apartamentit. Në këtë mënyrë, ndonëse subjekti nuk i ka copëzuar deklarimet dhe nuk i ka vendosur ato në një rend saktësisht të sugjeruar prej ligjvënësit, ajo e ka ekspozuar plotësisht këtë burim dhe qëllimin e përdorimit të tij. Rregullat për deklarimin periodik kanë shërbyer në procesin e rivlerësimit, jo për të kontrolluar saktësinë e plotësimit të deklaratave periodike, si një qëllim në vetvete, por në funksion të provimit të deklarimeve që subjektet kanë bërë në deklaratën *vetting*. Në këtë optikë, pakica ka vlerësuar se subjekti ka dhënë mjaftueshëm informacion, në koherencë të plotë dhe të mbështetur në dokumentacion, i cili krijon bindjen për vërtetësinë e deklarimeve të saj.
27. Duke ndjekur këtë logjikë, është arritur në konkluzionin se subjekti ka pasur burime të ligjshme për të paguar këstin e dytë të apartamentit, në shumën prej 20.000 euro.
28. Në vlerësimin e pakicës, qëndrimi i shumicës për mosnjohjen si burim të krijimit të kësaj pasurie të depozitës prej 67.000 USD, vetëm për shkak të interpretimit të deklarimeve të subjektit sipas versionit të lexuar prej saj [shumicës], duke lënë pa një përgjigje logjike pyetjen se për *çfarë destinacioni u përdorën kursimet e jetës së familjes*, nëse jo për pasurinë e vetme të krijuar prej tyre, konfirmon, *obiter dictum*, drejtësinë e konkluzioneve të mësipërme.

29. Lidhur me *analizën financiare të viteve 2003 – 2016*, rezulton se diferenca negative, e konfirmuar nga shumica dhe që i takon vitit 2011, përcaktohet nga mosnjohja e përdorimit të depozitës për financimin e pasurisë “Apartament” dhe madje e dublon atë. Për pasojë, ajo nuk konsiderohet e drejtë prej pakicës për shkak të arsytimit të mësipërm.
30. Në vijim të konkluzioneve të mësipërme, pas këshillimit me Njësinë e Shërbimit Ligjor në Kolegj, rezulton se balancat negative të subjektit të rivlerësimit mbeten: (i) ajo e krijuar për financimin e pasurisë “Automjet”, tip “Daimler Chrysler ML 270” në vitin 2010, në vlerën prej (-) 733.279 lekë; (ii) ajo e konstatuar në vitin 2011, prej (-) 426.661 lekë; (iii) ajo e konstatuar vitin 2012, prej (-) 351.943 lekë; (iv) ajo e konstatuar në vitin 2014, prej (-) 75.865 lekë.
31. Balanca negative, në total prej 1.587.748 lekë, e deduktuar në kushtet e mësipërme, referuar edhe rrethanave të arsyetuara gjerësisht në vendimin e shumicës, vlerësohet prej pakicës se gjendet në kushtet e thirrjes për zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, në kuptim të nenit 4, pika 5 dhe nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, kjo situatë faktike nuk vlerësohet se përbën një bazë të mjaftueshme për të konkluduar se subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e ligjit.
32. Për pasojë, subjekti do të duhej t’i nënshtrohej edhe kontrollit të dy kritereve të tjera, figurës dhe aftësive profesionale, për të parë nëse kjo balancë negative mund të ndërthurej ose jo me elemente të tjera që burojnë nga këto kritere, të cilat do të duhej të përcaktonin në mënyrë definitive nëse ndaj subjektit do të zbatohet ose jo masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.
33. Për të gjitha sa arsyetuar më lart, kam votuar për prishjen e vendimit të Komisionit dhe urdhërimin e tij për vijimin e procesit të rivlerësimit edhe për dy kriteret e tjera.

GJYQTARE

Ina RAMA

nënshkrimi